

INTERVISTË ME MARK BASKIN

Prishtinë | Data: 28 dhe 29 shkurt, 2020

Kohëzgjatja: 178 minuta

Të pranishëm:

1. Mark Baskin (I intervistuari)
2. Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
3. Chester Eng (Mbajtësi i shënimeve)
4. Renea Begolli (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

[Kjo pjesë e intervistës është realizuar më 28 shkurt, 2020]

Erëmirë Krasniqi: Atëherë, Mark, a mund të na prezantoheni dhe ndoshta filloni prej kujtimeve më të hershme, çka ju kujtohet?

Mark Baskin: Pra, unë quhem Mark Baskin. Jam lindur dhe jam rritur në Detroit, Michigan, në SHBA dhe ndër kujtimet e mia të para është koha kur jetoja me gjyshen time, e cila erdhi nga Rusia rreth vitit 1910. Dhe gjyshi im ka vdekur para se të lindja unë. Por që të dy ishin aktiv në të ashtuquajturën *Jevrejski Bund*, apo *bunda hebreje*¹. E pastaj në Shtetet e Bashkuara, ata ishin në *Arbeiter Ring*, që është “Rrethi i Punëtorëve”.

E *bunda*, qëllimi i tyre ishte... ata donin autonomi kulturore dhe autonomi brenda Partisë Socialdemokrate Ruse. Eh, në vitin 1903, kur Partia u nda në Menshevik dhe Bolshevik, ata anuan nga Menshevikët. Dhe, meqenëse ai ishte aktiv në revolucionin e vitit 1905, gjyshi im ishte në Siberi, dhe u arratis, erdhi dhe u martua... në fakt, ata nuk ishin martuar kurrë. Gjyshërit e mi ishin martuar nëpërmjet ligjit zakonor (qesh), dhe më pas u bënë shumë aktivë këtu [në bundën hebreje].

Dhe besoj se... këtë e kam mësuar shumë kohë pasi ata vdiqën, rreth 30 vjet më parë, ata ishin anëtarë të Partisë Komuniste Amerikane. Dhe kur isha fëmijë... pra, çdo mëngjes, gjyshja ime e merrte gazetën e mëngjesit në gjuhën jidish, *Freiheit*, që do të thotë, pra, [në përkthim] liria, e cila ishte gazeta e Partisë Komuniste në gjuhën jidish, e unë kurrë nuk kam ditur asnjë prej këtyre gjërave.

Dhe kështu ajo që mbaj mend si fëmijë është që... sepse prindërit e mi ishin liberalë të denjë të FDR² *New Deal*³, të cilët besonin se FDR duhet të kishte qenë president përgjithmonë. Por babai im kishte para në *stock market* [bursë], dhe gjyshja ime zemërohej me të për një lloj ndërmarrësie kapitaliste

¹ Grup hebrejsh sekularë socialistë aktiv në Perandorinë Ruse në fund të shekullit XIX-të dhe XX-të që përpiquej të bashkonte punëtorët hebre në një parti të bashkuar socialiste.

² Franklin Delano Roosevelt, Presidenti i 32-të i Shteteve të Bashkuara.

³ Agjenda e gjerë e brendshme e miratuar nga Franklin Delano Roosevelt në Shtetet e Bashkuara mes 1933 dhe 1839 në lidhje me Depresionin e Madh.

dhe gjëra të ngjashme. Kështu që, më kujtohet paksa ajo, por, domethënë, ishte një familje e dashur dhe gjithçka tjetër, por kishte edhe gjëra të tilla. Pra, Bubbe, siç e quanim ne, Bubbe ishte një... ajo ndikoi shumë tek unë kur unë isha vërtet i ri.

Domethënë, këto ishin ndër kujtimet e mia të para. Pra, jam rritur në Oak Park [Michigan] në vitet e '50-ta dhe '60-ta. U bëra, duke pasur parasysh atë lloj prapavije politike... ishte shumë politike. Mbaj mend që gjyshja ime e kishte një lloj... rrisht i thoshin *kruzhok*. *Kruzhok*, i cili është një rreth leximi... dhe ata [të moshuarit] vinin herë pas here në shtëpinë tonë, të gjithë ata të moshuar që vinin dhe flisnin jidish në shtëpinë tonë.

Erëmirë Krasniqi: A i lexonin nga afër tekstet, apo çfarë bënin?

Mark Baskin: Ata i lexonin këto tekste, të cilat ishin të gjitha jidish, pra, nga të gjitha ato qarqe të jidish socialistëve. Pra, si e kishte emrin, Sholem Aleichem, i cili i shkroi tregimet që çuan në filmin *Fiddler on the Roof* [Fyelltar në çati]... u morën nga këto histori të Sholem Aleichem, të cilat ishin disa lloj tregimesh të krahut të majtë e të tjera, e të tjera. Ata bisedonin gjatë për gjëra të ndryshme, dhe më kujtohet që shkoja në këto takime. Ata i mbanin disa koncerte. Gjyshi im këndonte në kor, kështu që ne shkonim në disa koncerte kori, të cilat ishin... edhe kur erdha për herë të parë në Jugosllavi në vitet 1970, kishte ende shumë kore. Ishte një nga mënyrat që mblidhte njerëzit këtu. Dhe...

Erëmirë Krasniqi: A ta kanë transmetuar gjuhën ty?

Mark Baskin: Jo, jidish ishte gjuha që flisnin prindërit e mi kur nuk donin që unë t'i kuptoja. Vëllai im kuptonte ca. Unë *spreche a bisl yiddish* (qesh)[flas pak jidish], por jo shumë, sepse, domethënë, jidish është si gjermanishtja dhe hebraishtja etj., etj., etj. Dhe kështu nuk e di edhe aq. Ata donin që unë ta mësoja.

Dhe kanë qenë disa... tezja ime e folte rrjedhshëm. Ajo shkoi deri në *eydish shule*, siç i thonë, *eydish shule*, deri në shkollën e mesme. Dhe prindërit e mi kishin disa miq që e flisnin goxha rrjedhshëm. Por unë nuk arrita ta flas kurrë. Dhe... dhe...

Erëmirë Krasniqi: Si ka qenë jeta familjare? E përmendët që kishit vëllezë dhe motra?

Mark Baskin: E kam një vëlla të vetëm.

Erëmirë Krasniqi: Ah.

Mark Baskin: Ai është vëllau i madh. Dhe, në familjen tonë, dyshoj që ne e dinim që do të vazhdonim studimet universitare që nga koha kur ishim ende në barkun e nënës sime (qesh). Dhe ishim, pra, një familje tipike amerikane e viteve '50 dhe '60, domethënë, mjaft modeste. Ne jetonim në një lloj rrethine të klasës së mesme dhe prindërit e mi ishin shumë aktivë. Madje, kur kanë qenë të rinj kanë qenë edhe aktivistë. Dhe...

Erëmirë Krasniqi: Çfarë po ndodhte politikisht? A mund të na tregoni?

Mark Baskin: Epo, patjetër që Lëvizja për të Drejtat Civile⁴ ishte ngjarja më e madhe. Por unë, midis historive që kam dëgjuar, ka qenë... të qenit në Detroit, organizimi i punës dhe krijimi i *United Auto Workers*⁵, ose *UAW*, ishte me rëndësi të veçantë. Dhe një mik i ngushtë i prindërve të mi u vra në një demonstratë në, duhet të ketë qenë në 1937, '38, e cila u quajt Beteja e Mbikalimit, në të cilën Henry Ford⁶ punësoi gangsterë për t'i ndarë demonstruesit, për të kontrolluar punëtorët. Dhe e di që tezja ime kishte dashur të shkonte në demonstratë, e pastaj... dhe Zadie nuk donte ta linte (qesh), dhe më pas aty vdiq shoku ynë. Dhe unë dhe djali që vdiq, në fakt ia njoh vëllaun dhe djemtë e tij, ata tani kanë vdekur, por e kam njohur edhe familjen e tyre, si pjesë e këtij komuniteti të cilit ne ende i përkasim. Dhe kështu politikisht ajo që po ndodhte ishte... mbaj mend se kujtimi im i parë politik ka qenë John F. Kennedy, zgjedhjet e vitit 1960.

Erëmirë Krasniqi: Sa vjeç ishe në atë kohë?

Mark Baskin: Isha tetë vjeç. Pra, këto i mbaj mend paksa. Mbaj mend që mendova se më pëlqente si dukej Nixon, dhe i tregova nënës sime dhe ajo u tmerrua (qesh). Pra... dhe, natyrisht, më vonë e kuptova pse ajo ishte e tmerruar. Edhe pse kur e krahasoj, eh po, Nixon duket mirë në krahasim me disa presidentë, në fakt (qesh), pra... domethënë...

Por më kujtohen gjërat rreth Lëvizjes për të Drejtat Civile dhe, prapë, tezja që fliste jidish, ajo shkoi në marsh, marshi i famshëm në Washington në vitin 1963, ku Martin Luther King [Jr.] e dha fjalimin e tij: / *Have a Dream* [Kam një ëndërr]. Të gjitha llojet e punës... ajo ishte aktiviste e të drejtave të punës gjatë gjithë jetës së saj. Ajo... akti i saj i fundit ishte se ishte në... disa vjet para se të vdiste, ajo shkoi në Konventën [Nacional Demokratike] të vitit 2008 ku foli Obama, pra, ku Obama u nominua, dhe e pyeta, "Si ishte? Dhe ajo më tha, "Më pëlqeu më shumë fjalimi i Michelle [Obama]", (qesh), tha ajo. Kjo ishte përgjigjja e saj.

Erëmirë Krasniqi: A ka qenë kjo aleancë e zakonshme në atë kohë, që komuniteti hebre të bashkohej me komunitetin e njerëzve të zi.

Mark Baskin: Po.

Erëmirë Krasniqi: Në rregull.

Mark Baskin: Hebrenjtë ishin, komuniteti hebre, eh po, jo i gjithë komuniteti hebre, por në thelb, që nga... në fakt, unë e kam mbajtur një fjalim në serbisht për këtë në Beograd rreth dhjetë apo pesëmbëdhjetë vjet më parë, rreth interesave të hebrenjëve në zgjedhje, kështu që kam hulumtuar, që nga vitet 1920, hebrenjtë kanë votuar rreth 65 ose më shumë përqind për demokratët, 65 deri në 70 përqind për demokratët. Dhe, domethënë, është e gjithë kjo trashëgimi e përbashkët, pra ideja se ne dikur ishim skllëvër në tokën e Egjiptit, se kjo... hebrenjtë, kudo që kanë qenë, me përjashtim të

⁴ Lëvizja shoqërore dhe politike e Afriko-amerikanëve për t'i dhënë fund diskriminimit racor, segregimit, heqjes së të drejtave në Shtetet e Bashkuara mes viteve 1954 dhe 1968.

⁵ Unioni Amerikan i punës i themeluar dhe me seli në Detroit i njohur për sigurimin e pagave dhe pensioneve të larta për punëtorët në industrinë e automobilave.

⁶ Themeluesi dhe udhëheqësi i Kompanisë Ford Motor.

Izraelit që nga viti 1948⁷, ne kemi qenë pakica, në mënyrë që ne gjithmonë të ndërmarrim hapa që... ne besojmë në... unë jam rritur me mendimin se të dobëtin ia vlen të mbështesësh.

Kështu që, gjëja e parë që bëra ishte që shkova dhe morra pjesë në demonstrata për punëtorët e fermave, punëtorët hispanikë të fermave që po bashkoheshin në sindikata në vitet 1960, Cesar Chavez⁸ [bën me gisht nga Chester Eng]. Për vite me radhë, nuk kam ngrënë rrush. Ne bojkotuem rrushin (qesh) se po vjelnim rrush, dhe ishte... Mund t'ju them që ishte sakrificë sepse unë e dua rrushin (qesh). Dhe më kujtohet që i ndihmova të ndërtonin shtëpi në Michigan, sepse kishte punëtorë hispanikë në të gjithë vendin. Kështu që...

Po, dhe kështu u bëra aktivist, dhe më pas lufta në Vietnam, pra atëherë isha ndër studentët udhëheqës në shkollën time të mesme. Gjithashtu, që, disi... për fuqizimin e studentëve, më shumë të drejta studentore, që të mund të dilnim, të mund të dilnim nga ndërtesa për drekë, të mund të bënim të gjitha këto lloj gjërash. Dhe, në të njëjtën kohë, i njëjti grup njerëzish që ne... Më kujtohet, në vitin 1969, ne bëmë një marrëveshje me drejtorin, që studentët të mos shkonin në shkollë dhe të shkonin në një demonstratë të madhe që po zhvillohej në qendër të Detroitit, pra, qysh herët kam qenë aktiv kundër luftës.

Erëmirë Krasniqi: A ka qenë Oak Park afër?

Mark Baskin: Oak Park ishte mu aty {vizaton një vijë horizontale me dorën e djathtë}.

Erëmirë Krasniqi: A mund të na tregoni më shumë për atë qytezë? Si ishte?

Mark Baskin: Oak Park... nuk po më besohet që po më kujtohet kjo. Nuk e di sa njerëz janë aty tash, por i kishte 37,000 njerëz. Ishte një lloj... domethënë, ishte në periferi. Kufizohej me Detroit. Unë isha disa kilometra në veri të saj. Ka qenë ndoshta... ka qenë... ne e quanim Izraeli i vogël.

Ka qenë (qesh)... ka qenë një... pra, kishte dy komunitete të mëdha hebreje... jo aq... Oak Park dhe Southfield. Dhe Southfield ishte pak më e pasur, kështu që ne e quanim atë "Geto e Artë" (qesh). Ne hebrenjtë e bëmë. Por Oak Park ishte, thoshim në jidishten tonë të rreme, *Oak Park*-u ynë, e quanim ne (qeshë). Dhe kështu sistemi shkollor... shkolla në të cilën kam shkuar unë ishte 70 përqind hebrenjë. Dhe...

Erëmirë Krasniqi: A mund të na e shpjegosh pse kaq shumë familje hebreje u shpërngulën në Oak Park?

Mark Baskin: Sepse kishte diskriminim ndaj hebrenjve. Kishte arsye pozitive dhe negative. Pozitivisht, ka pasur diskriminime... negativisht, ka pasur diskriminime kundër hebrenjve. Ka pasur vende në zonën e Detroitit ku ata nuk u shisnin hebrenjve sepse ne ishim hebrenj. Sepse... dhe nëse shikoni disa nga Ku Klux Klan, fashistët e krahut të djathtë, kuazi-fashistët, sido që t'i quani... ata pothuajse... ata i përçmonin hebrenjtë më shumë sesa afrikano-amerikanët.

⁷ Viti i deklaratës së themelimit të Shtetit të Izraelit.

⁸ Aktivisti meksiko-amerikan për të drejta civile dhe udhëheqësi i lëvizjes së punës i cili organizoi greva ndërmjet punëtorëve të fermave në vitet e '60-ta.

Dhe këto demonstrata që u zhvilluan në Charlottesville në 2017⁹, mendoj. Këta demonstrues nazistë, nazistë amerikanë po bërtisnin, duke e bërë “Sieg Heil” {ngre krahun e djathtë dhe e mban dorën drejt}, po thonin, “Hebrenjtë nuk do të na zëvendësojnë, hebrenjtë nuk do të na zëvendësojnë”. Një ish-udhëheqës i Klanit i quajtur David Duke, i cili ka kandiduar disa herë për Kongres, ka një podcast ku ai shpenzon më shumë kohë duke poshtëruar hebrenjtë sesa afrikano-amerikanët.

Dhe kështu ekziston një lloj ideje se hebrenjtë, kudo që kanë qenë... dhe kjo nuk është vetëm për Shtetet e Bashkuara, është gjithkund. Hebrenjtë kanë qenë gjithmonë në një lloj pozicioni i të të qenit pakicë ndërmjetësuese. Domethënë, në Evropën Lindore, ne na përzunë... Hebrenjtë kanë qenë gjithmonë këshilltarë të gjykatës në Spanjë, në Egjipt, dhe më pas na dëbuan. Dhe më pas, kur na dëbuan nga Spanja, erdhëm në Ballkan. Pra është, domethënë, komuniteti hebre që është në Prizren dhe që ka ardhur këtu, dhe çfarë është, ka një komunitet shumë më të madh hebre në Sarajevë. Në Sarajevë, 20 përqind e popullsisë në vitin 1940 ishin hebrenj.

Dhe kështu në... sidoqoftë, pra ekzistonte ai lloj antisemitizmi. Dhe, në të njëjtën mënyrë, ti je po ashtu në komunitetin tënd, je i detyruar të jetosh në një geto ose *shtetl* në jidish. Domethënë, dhe kështu ti... njerëzit thjesht zhvendoseshin për të qenë me komunitetet e tyre. Dhe, pra, nëse shikoni tani, në kohën e Shteteve të Bashkuara, hebrenjtë janë shpërndarë. Ata nuk janë më gjithkund.

Në lagjen e vogël ku jetoja... ne e kemi shitur shtëpinë rreth dhjetë vite më parë... ajo është bërë disi si Parku Borough¹⁰ i Detroit, pra goxha ortodoks, shumë hebrenj. Ata nuk ngasin makinën në fundjavë. Thjesht shkojnë në sinagogë, domethënë ata me *payos* të gjatë {shtron gishtat përgjatë mollëzave}, pra, basetat¹¹ e gjata dhe {vë dorën mbi kokë për të pasqyruar një *yarmulke*}¹². Ata i veshin ca lloj pallto të gjata të zeza. Dhe ne talleshin me ta. Dhe ata talleshin me ne. Pra, kalojmë mirë.

Erëmirë Krasniqi: Si ishte shkolla me 70 përqind hebrenj?

Mark Baskin: Ne ishim të gjithë... në atë kohë, të gjithë ishim hebrenj liberalë, domethënë, kështu që ishte në rregull. Pra, ishte në rregull. Siç po i tregoja dikujt dje, thashë, “Kishte dy lloje hebrenjsh: kishte biznesmenë dhe rabinë. Biznesmenët u bënë të gjithë të pasur dhe rabinët {ngrenë duart lart}”. Epo, unë jam rabin në atë kuptim (qesh). Jo, dua të them, domethënë ka pasur... unë kam shkuar në shkollë me... për shembull, kanë qenë disa njerëz vërtetë të rëndësishëm që kanë shkuar në shkollën time. Pothuajse çdokush mund ta thotë këtë. Jeffrey Sachs, ekonomisti, ishte disa vite më i ri se unë. Motra e tij e madhe ka qenë një nga shoqet e mia më të ngushta. Ajo ka qenë korrespondente për revistën “Time” për shumë vite.

Don Was, i cili tani është drejtor i Blue Note Records. Ai ishte një... ai prodhoi The Rolling Stones. Ai ka fituar shumë çmime *Grammy*. Don ishte një shoku im i mirë në shkollë të mesme. Dhe kishte edhe të tjerë që janë ndoshta më pak të famshëm. Don është si Hollywood i vërtetë, pra është i njohur,

⁹ Tubimet neo-naziste dhe supremaciste të të bardhëve që u zhvilluan në një qytet në Virginia qendrore, një shtet në regjionin mes-atlantik të Shteteve të Bashkuara, më 11 dhe 12 gusht të vitit 2017.

¹⁰ Lagjja në jugperëndim të Brooklyn, në New York City, ku ndodhet një prej komuniteteve më të mëdha hebraike ortodokse jashtë Izraelit.

¹¹ Kaçurrela të gjata anash kokës që disa burra hebrenjë ortodoksë i mbajnë bazuar në një interpretim të një urdhëri në Teurat që ndalon prerjen e “qosheve” të kokës.

¹² Kësula që burrat hebrenjë ortodoksë e veshin në publik dhe të tjerë burra hebrenjë e veshin gjatë lutjeve.

shoqërohet me Leonard Cohen... ose shoqërohej me Leonard Cohen dhe atë lloj njerëzish, ndërsa, dhe, Jeff është Jeff, pra, dhe ai është nga ato qarqe, Jeff.

Pra të shkuarit në shkollë ishte në rregull. Mendoj, domethënë ne... pra çfarë nënkuptonte sistemi im shkollor është se zyrtarisht ne nuk shkuam në shkollë në Yom Kippur dhe Rosh Hashanah. Rosh Hashanah është Viti i Ri, Viti i Ri hebraik. Zakonisht është në vjeshtë, dikur në shtator. Dhe Yom Kippur, që është dita e madhe e shenjtë, e cila është disi e ngjashme me Ramazanin, por është vetëm një ditë në të cilën ti agjëron dhe është dita kur ti shlyen të gjitha mëkatet. Ishin ditë që nuk i kam festuar kurrë sepse vij nga një familje e majtë dhe nuk i kemi festuar kurrë, por ne nuk... pra, për ne, ishte ditë pushimi nga shkolla (qesh).

Erëmirë Krasniqi: A ishin edhe ata ateistë, prindërit e tu?

Mark Baskin: Oh po.

Erëmirë Krasniqi: (qesh)

Mark Baskin: Oh po, jo, jo, dua të them, Zoti është... e din, të gjithë ato gjërat Marksiste mbi Zotin. I dini, apo jo? Mendoj, apo jo? Dhe më kujtohet që u pata thënë prindërve të mi kur isha rreth njëmbëdhjetë vjeç, sepse në moshën trembëdhjetë vjeçare, një fëmijë hebre, ose një burrë hebre... Tani, në fakt janë djemtë dhe vajzat që kalojnë nëpër një ritual të quajtur *bar mitzvah*¹³, që është një ritual i maturimit, dhe unë nuk kisha *bar mitzvah*. Unë kam shkuar në një lloj shkolle laike të së dielës, ku, domethënë [nxënësit vinin] nga familje të ngjashme me familjen time. Por të gjithë shokët e mi shkonin në shkollën hebraike tre ditë në javë, ku mësonin hebraisht dhe mësonin lutjet që do të thonin në *bar mitzvah* të tyre, sepse në *bar mitzvah* tënde, ajo që bën është... keni qenë ndonjëherë në një *bar mitzvah*? {bën me gisht nga Erëmirë}

Erëmirë Krasniqi: Jo.

Mark Baskin: Duhesh [të shkosh]. Nëse ke ndonjë shok hebre në Shtetet e Bashkuara kur të kenë fëmijë, duhesh, sepse është një...

Chester Eng: Është një lloj eksperience.

Mark Baskin: Është, në fakt, tani është si të shkosh në një martesë këtu në shumë mënyra, domethënë. Është thjesht tejet e tepruar {shtrin krahët anash për të formuar një gjysmërreth}. Kur isha fëmijë, nuk ishte aspak e tepruar. Dhe, pra, por gjëja kryesore është që ti si një djalë i ri e drejton shërbimin, dhe e lexon një pjesë të Tevratit dhe më pas lexon gjëra të tjera, dhe ti e drejton shërbimin, dhe familja jote vjen, dhe, domethënë...

Erëmirë Krasniqi: A jeni ndjerë i veçuar?

Mark Baskin: Eh, po, po. Pra i kam pyetur prindërit e mi... i kam pyetur prindërit e mi, dhe... nga dy gjërat që mbaj mend politikisht... nuk duhet të vazhdojmë, mendoj. Njëra ishte, pyeta prindërit e mi,

¹³ Ritual fetar hebraik dhe festë familjare që kremton moshën madhore fetare të një djali në ditëlindjen e tij të 13-të.

“A mund të kem një *bar mitzvah*?” Sepse dy ose tre miqtë e mi më të ngushtë tashmë kishin pasur një *bar mitzvah*. Dhe pastaj ata më shpjeguan se ne nuk besojmë në këtë, nuk është kjo ajo që ishte... kjo ishte si Trotsky¹⁴ meqë ra fjala. Dua të them, më vonë studiova historinë ruse dhe Trotsky ishte një hebre që u rrit jashtë komunitetit të të bardhëve. Ai nuk u rrit... pra që ai u diskriminua nga rusët sepse ishte hebre, dhe ai u diskriminua nga hebrenjtë sepse nuk ishte... sepse ishte jashtë [hebrenjëve]. Pra kështu disi u ndjeva. Kjo është ajo që shkencëtarët politikë e quanin “tjetërsim i dyfishtë”, ose diçka e tillë.

Dhe pastaj unë, hera tjetër ishte... mbaj mend që erdha pas darke një natë, i thashë nënës sime, i thashë, “E di, nënë, po të mos kishte komunistë në botë, gjithçka do të ishte vërtetë e mrekullueshme”. Dhe ajo vetëm më tha, në jidish, tha, “*Az och un vey*”, që do të thotë, pra, {godet me shuplakë ballin}. Ajo tha, “Mark, e din, Bubbe është komunist” (qesh). Dhe...

Erëmirë Krasniqi: Si erdhe me atë fjali?

Mark Baskin: Oh, sepse mësuesi im, për shkak të gjërave që po mësonim në shkollë. Ne po mësonim, domethënë ky ishte viti 1960, ishte Lufta e Ftohtë, pra gjëra antikomuniste, ne i urrenim komunistët, prandaj e thashë atë. Dua të them, kur je tetë vjeç, domethënë nëse nuk je gjeni, nuk vjen vërtetë me idetë tua. Dhe kështu këto ishin dy gjëra që më kujtohen vërtetë. Dhe e pyeta nënën, që kishte *dementia* në fund të jetës së saj, nëse e mbante mend atë shkëmbim dhe ajo nuk e mbante në mend (qesh), por unë e mbaj mend shumë qartë.

Erëmirë Krasniqi: A mund të flisni ndoshta për atë lloj klimë në SHBA në ato vite, pra e gjithë... edhe shkolla, arsimi, po predikonin kundër komunizmit? Sepse ishte një diskutim mjaft polarizues.

Mark Baskin: Eh, po, jo, dua të them, prapë, ne ishim në një lloj shkolle mjaft të veçantë {pie ujë}. Domethënë, ne të gjithë e kemi thënë Betimin tonë të Besnikërisë ndaj flamurit, bla, bla, bla. Dhe besoj se kemi thënë, “Një komb nën Zotin”. Kjo nuk ishte problem. Unë shkoja në një shkollë hebreje.

Pra, kështu ishte Amerika atëherë. Ne ishim duke u integruar në... ne ishim integruar në Amerikë. Ne ishim thjesht liberalë. Ajo, si hebrenj, ne këndonim këngët e Krishtlindjeve çdo Krishtlindje. Janë këngë të bukura. Nuk e kisha problem. Unë ende nuk e kam problem të këndoje këngët e Krishtlindjeve. Për mua, nuk më duket se ofendon identitetin tim, që më duhet ta këndoje këtë lloj muzike të krishterë, pra, “*Silent Night*”, “*Good King Wenceslas*”, domethënë të gjitha ato këngë {bën me gisht nga Chester Eng}. Dhe kështu...

Pra, por politikisht, kishte gjëra, dhe unë... prindërit e mi më thonin se kishte... se ata kishin miq që kishin vuajtur, domethënë gjatë periudhës së McCarthy-t¹⁵. Dhe më vonë takova njerëz që kishin

¹⁴ Leon Trotsky ishte teoristi dhe revolucionari marksist sovjetik i cili ndihmoi në organizimin e Revolucionit të Tetorit të vitit 1917 në Rusi dhe më pas u bë udhëheqës i Partisë Komuniste Sovjetike.

¹⁵ Epoka e frikës së përhapur nga ndikimi komunist në institucionet dhe nga spiunazhi sovjetik në Shtetet e Bashkuara nga fundi i viteve të '40-ta deri në vitet e '50-ta, gjatë së cilës senatori i Wisconsin Joseph McCarthy u bë i njohur duke pretenduar se komunizmi kishte infiltruar qeverinë e SHBA-së, botën akademike dhe industrinë e filmit.

[vuajtur], dhe kështu ndodhi. Por, domethënë kur je tetë vjeç kjo nuk të afekton, apo edhe në moshën dhjetë vjeç nuk të afekton.

Mbaj mend që shkova në shkollë në tetor 1962 gjatë krizës së raketave Kubane, duke menduar, “Mund të na bombardojnë” (qesh). Pra, domethënë, ka pasur... pra ne ishim amerikanë të mirë. Dhe çështja me të majtën në vitet ‘60... kur mendon për... nëse nuk ishte vërtetë i majtë komunist, çështja me të majtën ishte, ideja është që amerikanët siguruan një sistem absolutisht të mrekullueshëm për t’i dhënë të drejta të gjithëve dhe ne vetëm duhet të kuptonim se ato të drejta u përkasin të gjithëve. Pra, kjo nënkuptonte afrikano-amerikanë, kjo nënkuptonte... nuk kishte probleme me hispanikët në atë kohë, ose me myslimanët, ose e din... ishim shumë më homogjenë. Ne ishim ende të shumëllojshëm, por ishim shumë më homogjenë në atë kohë. Dhe kështu...

Erëmirë Krasniqi: Çfarë ndodhi më pas? Për shembull...

Mark Baskin: Po, vazhdoni.

Erëmirë Krasniqi: Jeta gjatë shkollës së mesme. Si keni dalur nga Oak Park?

Mark Baskin: Epo, isha pjesë e një kundërkulture të vërtetë. Braktisa atë kulturën konvencionale. Fillova, pra, të dëgjoja muzikë *rock & roll* dhe *jazz* dhe gjëra të tjera të ndryshme, të cilat jo të gjitha ishin plotësisht njëqind përqind legale në atë kohë (qesh). Dhe...

Erëmirë Krasniqi: Po, çfarë po ndodhte në kulturë? Kush ishte i famshëm në atë kohë (qesh)? Ne mund t’i dijmë.

Mark Baskin: Pra, unë shkoja në një... domethënë, prindërit e mi donin që unë dhe vëllai im të ishim muzikantë, muzikantë klasikë.

Erëmirë Krasniqi: Oh.

Mark Baskin: Vëllau im ishte muzikant klasik.

Erëmirë Krasniqi: Ju, a është në familje muzika?

Mark Baskin: Jo.

Erëmirë Krasniqi: Në rregull.

Mark Baskin: Jo veçanërisht, por ata donin që ne... dhe kështu ne kishim, unë merrja mësimë muzike që kur isha shumë i ri. Unë... por nuk më pëlqente të ushtroja (qesh) dhe... kështu, domethënë, shakaja është “Si mund të arrish në Carnegie Hall?¹⁶ E drejtë, ushtroni”, e dini. Kështu bëri vëllai im, dhe ai është oboisti kryesor i Simfonisë së Montrealit. Dhe pra unë nuk e bëra, dhe disi kisha një rrugë shumë më të gjatë për t’u bërë akademik. Dhe të bëhesha akademik ishte në rregull, për sa u përkiste prindërve të mi. Ata ishin shumë, ata ishin të kënaqur me këtë. Ata menduan se ndryshe mund të kisha vdekur, kështu që ishin të lumtur që mbijetova dhe ia dola. Pra, ju e dini, në atë kohë...

¹⁶ Salla e shquar e koncerteve në Midtown Manhattan në qytetin e New York.

Erëmirë Krasniqi: Çfarë instrumenti keni luajtur?

Mark Baskin: Kam luajtur, fillimisht, kam marrë mësim pianoje, dhe më pas i kam rënë borisë franceze.

Erëmirë Krasniqi: Ah, në rregull.

Mark Baskin: Po, boria është instrument i vështirë. Dhe thjesht nuk më ka pëlqyer. Dhe thjesht nuk më pëlqente të ushtraja. Nuk e kisha *Sitzfleisch*¹⁷, siç themi ne në jidish, që të ulesha dhe ta bëja. Do të preferoja të dilja dhe të luaja bejsboll ose futboll ose diçka tjetër. Por, në atë kohë... pra, e dini, kur unë u rrita... gjithashtu, *West Side Story*¹⁸, domethënë, shfaqja që u mor nga Romeo dhe Zhulieta rreth Kapuletëve kundër... {bën me gisht nga intervistuesit}

Erëmirë Krasniqi: Montagëve.

Chester Eng: Montagët.

Mark Baskin:... Montagët, e cila është gjithashtu një lloj gjëje etnike në njëfarë mënyre. Dhe në *West Side Story*, ishin portorikanët kundër të bardhëve, e që të bardhët ishin... ndoshta irlandezët. Por më pas në kulturë, më kujtohen Beatles, Rolling Stones, Jefferson Plane. Le të mendohem, Grateful Dead¹⁹. Po mendoj, unë njihja njerëz që thjesht përdornin vazhdimisht LSD dhe pinin duhan, dhe udhëtonin me Grateful Dead dhe thjesht shkonin në 30, 40 ose 50 koncerte të tyre në vit. Dhe ishte vërtetë një lloj kulti. Kjo ishte gjithashtu epoka e Manson²⁰. Ishte një film vitin e kaluar që ishte, ishte vërtetë film i mirë. Fëmijëve të mi nuk u pëlqeu, por ishte një film i mirë rreth *Once Upon a Time in Hollywood*, i cili e kapi [në film] shumë bukur atë epokë. Pra... dhe pastaj, kështu, atëherë kur fillova universitetin, kalova një ose dy vjet shumë i lumtur që nuk jetoja më në shtëpi. Dhe pastaj u bëra, u bëmë, iu bashkova një lëvizjeje radikale.

Erëmirë Krasniqi: Në cilin universitet keni studiuar?

Mark Baskin: Kam studiuar në një universitet që njerëzit në Kosovë e njohin mjaft mirë në fakt, në Universitetin e Oakland. Ka shumë njerëz që... kam takuar disa njerëz në Fakultetin Filozofik dhe në Fakultetin e Inxhinierisë që kishin bërë, domethënë... nuk e di, ata kishin bursa studimi atje dhe gjëra të tilla.

Por ishte, nuk doja të vazhdoja studimet dhe u thashë prindërve të mi, u thashë, “Nuk dua të vazhdoj studimet”, dhe ata më thanë, “Në rregull, mund të fillosh ta paguash qiranë”. Dhe unë thashë, “Në rregull, kolexhi është ide e mirë” (qeshë). Kështu që, unë vazhdoja studimet. Dhe unë nuk isha student

¹⁷ Term në gjermanisht që fjalë për fjalë ka kuptimin “mish i ulur” e që përdoret për të nënkuptuar aftësinë për të qëndruar ulur për një kohë të gjatë në mënyrë që të kryesh punë

¹⁸ Komedi muzikore e konceptuar nga Jerome Robbins në vitin 1957.

¹⁹ Një grup rock amerikan i formuar në vitin 1965 në Palo Alto, California.

²⁰ Charles Milles Manson ishte një kriminel dhe muzikant amerikan që udhëhoqi familjen Manson, një kult me qendër në Kaliforni, në fund të viteve 1960. Disa nga anëtarët kryen një seri prej nëntë vrasjesh në katër vende në korrik dhe gusht 1969.

shumë i mirë në shkollë të mesme, kështu që shkova... dhe munda të pranohesha në [Universitetin e] Oakland dhe shkova. Dhe pastaj unë, domethënë rashë në një grup dhe u bëmë, morëm në kontroll qeverinë studentore dhe kishim një gazetë radikale dhe bënim thirrje për revolucion një kohë. Fakulteti hyri në grevë, kështu që ne morëm në kontroll konviktet dhe gjithë këto. Dhe ishte...

Erëmirë Krasniqi: Cilat ishin kërkesat tuaja? Rreth çka po organizoheshit?

Mark Baskin: Ne donim fuqi studentore. As nuk e mbaj mend. Me të vërtetë, as që e mbaj mend. Fuqia studentore. Krejt çka mbaj mend është se ne... unë isha vërtetë i apasionuar pas xhazit në atë kohë, kështu që dëgjoni *bebop* në vend të Led Zeppelin (qesh) kur ishim në grevë. Dhe kështu... dhe pastaj, kur kjo mori fund, kur ajo...

Erëmirë Krasniqi: Çfarë po studioje? A mund të na tregoni?

Mark Baskin: Më pas shkova, nuk po studioja asgjë në atë kohë. Po mendoj...

Erëmirë Krasniqi: Çfarë lloj lëndësh?

Mark Baskin: Oh, po, në atë kohë, po studioja psikologji, por nuk më pëlqente psikologjia, kështu që më pas studiova histori. Dhe pastaj fillova të studioja. Dhe gjyshja ime ishte mjaft e vjetër në atë kohë, por... dhe ajo tashmë ishte plakur. Nuk mund të flisja vërtetë me të, por isha shumë i interesuar për revolucionaren dhe përpiqesha të isha revolucionar e kësi gjërash. Kështu që, unë fillova të studioja historinë revolucionare ruse, dhe më pas profesori im të cilin vërtetë, i cili ishte mentori im si student, në fakt ishte një historian mesjetar. Kështu që, u ktheva dhe mora të gjithë ato kurse për një lloj historie të hershme ruse, të cilat ishin vërtetë interesante, më duhet të them. Dhe më pas, kështu u diplomova për histori.

Dhe më pas, kur u diplomova, doja të largohesha nga Shtetet e Bashkuara. Më dukej shumë shtypëse dhe kështu. Dhe unë thjesht, pra aplikova për një Fulbright më afat-shkurtë për të ardhur në Jugosllavi, sepse nuk kishe çfarë bëje në Bashkimin Sovjetik. Një tjetër mentor i imi, i cili kishte doktoraturë në histori nga [Universiteti] Indiana²¹. Ai ishte Habsburgist. Ai ishte dikush që studimet i kishte mbi Poloninë dhe shkroi një artikull të quajtur (qesh) "A flisnin sllavët gjermanisht në Kongresin e Parë Pansllav?" Dhe doli që ata folën [gjermanisht] sepse ishte gjuha brenda monarkisë Habsburge që e flisnin të gjithë.

Erëmirë Krasniqi: Pra kjo ishte çka ndodhi?

Mark Baskin: Po, po, pra të gjithë sllavët, e dini, të gjithë polakët, çekët, sllovakët... të gjithë këta që ishin duke zhvilluar kulturat e tyre në atë kohë, në vend të kroatëve, serbëve, e krejt atyre.

[Rrëfimi vazhdon në pjesën e dytë]

Pjesa e Dytë

²¹ Indiana University Bloomington, një universitet i madh kërkimor në rajonin e mesëm perëndimor të Shteteve të Bashkuara.

Erëmirë Krasniqi: A ishit në gjendje të aplikoni për Fulbright në Rusi në atë kohë?

Mark Baskin: Jo, pra unë aplikova për të studiuar Çështjen Kombëtare, dhe nuk ia dola ta kaloj as [fazën] e konkursit në Oakland. Unë kisha pak reputacion për shkak të... dhe, unë, domethënë... por duke hulumtuar, mësova për një program që drejtohej nga Macalester College²², ku Kofi Annan²³, Humbert Humphrey²⁴ studionin, në Saint [Paul] Minnesota, i cili mbahej në Zagreb, për të studiuar ronisht për një vit. Kështu që, unë shkova në atë program.

Dhe atje ne kishim një program për të studiuar në Leningrad, por ronishtja ime nuk ishte as afërsisht... ti duhej vërtetë ta njihje mirë ronishten. Në atë program kishte kryesisht studentë të diplomuar. Kështu që unë shkova. Në thelb ata thjesht kërkonin që të ishe mirë me shëndet për të shkuar në këtë program dhe të dije pak ronisht. U pranova. Ishte... dhe kalova një vit në Zagreb duke studiuar ronisht. Por gjithashtu, duke qenë i interesuar për histori, dëgjoja ligjerata nga historianë shumë të mëdhenj nga Fakulteti Filozofik i Zagrebit: Mirjana Gross, Jaroslav Šidak dhe Ljubo Boban, të cilët ishin të gjithë disi figura kryesore jo vetëm në Jugosllavi, por në mbarë botën, që ishin të mirënjohur. . Dhe...

Erëmirë Krasniqi: Si ishte Jugosllavia në vitet e '70?

Mark Baskin: Ishte... domethënë, ishte shumë më ndryshe sesa të studiosh jashtë vendit tash. Nuk kam folur me prindërit e mi një vit. Shkruaja dy letra në javë. Më shkruanin dy letra në javë. Unë u kërkoja prindërve të mi të raunin... e dini stripin *Doonesbury*²⁵? E kanë akoma? Në atë kohë, ishte kjo... nëna ime e veçonte *Doonesbury*-n çdo ditë dhe ma dërgonte dhe ma dërgonte diku një herë në muaj. Ata më dërgonin *Doonesbury*.

Erëmirë Krasniqi: Sa gjatë merrte për të pranuar një letër?

Mark Baskin: Një javë, dhjetë ditë. Jo shumë keq.

Erëmirë Krasniqi: Ka qenë e thjeshtë (qesh).

Mark Baskin: Domethënë, nëse doje t'i telefonoje të shtëpisë, duhej të shkoje në postë. Kushtonte shtrenjtë, kështu që nuk e bëra kurrë. Domethënë, ne thjesht shkruheshim gjatë gjithë kohës. Dhe ishte... një shtet që funksiononte mirë. Kjo ishte, domethënë, ti kthehesh pasi e kishe studiuar me shumë kujdes... Kjo ishte periudha e asaj që në kroatisht i thonë, *Hrvatska Šutnja* [Heshtja Kroate], gjithçka që ndodhi pas vitit 1971, spastrimet dhe gjithçka tjetër, mirëpo ishte qetë, pra politikisht nuk po ndodhte asgjë.

²² Një kolegji i vogël privat i arteve liberale në Saint Paul, Minnesota, në rajonin e mesëm perëndimor të Shteteve të Bashkuara.

²³ Diplomati gënjës i cili njihet si Sekretari Gjeneral i Kombeve të Bashkuara nga viti 1997 deri në vitin 2006.

²⁴ Politikan nga Minnesota i cili shërbeu si zëvendës President i Shteteve të Bashkuara dhe përfaqësoi shtetin e tij në Senatin e Shteteve të Bashkuara.

²⁵ Një strip i përditshëm komik i publikuar në vitin 1970 i njohur për trajtimin liberal politik dhe social të temave të ndryshme.

Unë mësova shumë atë vit sepse doja të vazhdoja studimet pasuniversitare dhe doja që veç ta dija rusishten. Kështu që e ushtrova shumë rusishten dhe punova shumë për ta mësuar kroatishten, ose kroatisht ose serbisht siç i thonin atje në Zagreb.

Erëmirë Krasniqi: Sa gjatë keni qëndruar?

Mark Baskin: Një vit.

Erëmirë Krasniqi: Një vit.

Mark Baskin: Më shumë si dhjetë muaj. Domethënë, erdha në shtator dhe u largova në fund të korrikut.

Erëmirë Krasniqi: Si i kalojshe ditët? Çfarë bëre? Si ishte jeta?

Mark Baskin: Haja një burek për çdo ditë. Merrja një *burek sa sirom* [flet Srb.: burek me djathë], siç i thonë, çdo ditë *me djathë* (qeshë), çdo ditë.

Erëmirë Krasniqi: Me djathë?

Mark Baskin: Me djathë, uh huh. Dhe unë, domethënë, shkoja në Fakultet. Shkoja në ligjërata. Unë kisha një të dashur. Falë saj, e ajo fliste mjaft mirë anglisht, por unë nuk e dija dy muajt e parë. Ajo fliste vetëm kroatisht me mua. Dhe ajo ishte asistent ligjeruese për Shidakun, i cili ishte profesor i rregullt, domethënë i rëndësishëm në katedër. Shidaku ishte bërë plak tashmë. Ligjërues i shkëlqyer.

Dhe... unë... pra kështu ishte Jugosllavia në atë kohë. Takova një djalë që ishte kritik i xhazit, dhe unë isha shumë i dhënë pas xhazit, dhe kështu na shkoi vërtetë mirë bashkë. Dhe pas disa javësh, ai më thotë, “Dëgjomë, unë do të shkoj në Festivalin e Xhazit në Beograd. Duhet të vish”. Dhe kështu shkova. Nuk shkova në ligjërata për një javë, dhe ata menduan se do të bëhesha një... kishte qenë një djalë një vit para meje, që domethënë përdorte Zagrebin si, pra pikënisjeje për të udhëtuar.

Dhe kështu shkova për një javë në Beograd, dhe po shoqëroheshja me të gjithë kritikët e xhazit, po shkoja në prapaskenë, po shkoja në të gjitha konferencat për shtyp. Dhe ata po intervistonin. Ata kishin muzikantë të mëdhenj. Charles Mingus ishte aty.

Erëmirë Krasniqi: Vërtetë?

Mark Baskin: Po, mendoj, ata kishin vërtetë... ishte e mrekullueshme. Dhe më pas kur shkova, ishte një pianist rus i xhazit i quajtur Igor Brila i cili ishte brilant. Një avant-garde, ai ishte fantastik. Dhe kështu shkova në të gjitha konferencat për shtyp. Dhe kritikët, domethënë ata ishin të gjithë si studentë të sociologjisë dhe kësi gjërash, dhe bënë disa pyetje të gjata për kulturën. Dhe ca muzikantë, shumica e të cilëve, domethënë ishin të artikuluar, por ata nuk mund t’i kuptonin ose diçka të ngjashme. Dhe ata ishin thjesht në një nivel tjetër. Ata nuk ishin... dhe pra po transmetohej nga televizioni jugosllav. Dhe...

Erëmirë Krasniqi: Konferenca për shtyp?

Mark Baskin: Jo konferenca për shtyp. Koncertet.

Erëmirë Krasniqi: Vërtetë?

Mark Baskin: Po, koncertet, të gjitha u transmetonin nga televizioni jugosllav. Dhe ata donin që dikush t'i intervistonte muzikantët për rreth një minutë e gjysmë kur ata ta lëshonin skenën. Dhe ata thjesht thanë, “Ne kemi nevojë për dikë që ata mund ta kuptojnë”, kështu që ata u kthyen nga unë (qeshë). Dhe pra unë i intervistova të gjithë ata xhaz muzikantë kur ata zbrisnin nga skena në Festivalin e Xhazit në Beograd në vitin 1975.

Erëmirë Krasniqi: Oh Zot!

Mark Baskin: Dhe mbaj mend... dua të tregoj një histori. Unë isha... ishte një pianist finlandez i xhazit që nuk më pëlqente, dhe kështu pyetja që i bëra... do ta them këtë... pyetjen që i bëra, e dini, unë thashë, “Disa njerëz thonë se njerëzit e bardhë me të vërtetë nuk duhet të luajnë xhaz. Çfarë mendoni ju?” (qesh) {zgjat dorën e djathtë përpara sikur të ishte duke mbajtur një mikrofon}. Dhe ai dha një përgjigje të shkëlqyer. Ai e dha. Përgjigjja që dha ishte shumë... ai dha një përgjigje të shkëlqyer.

Dhe pastaj kur Mingus u largua... dhe unë veç kisha folur me Mingus sepse Mingus ishte një nga heronjtë e mi. Dhe i thashë se sa i rëndësishëm ishte ai për mua, dhe ai thjesht u ul. Dhe ai ishte një tip me të vërtetë krejtësisht i çuditshëm, Mingus, ai thjesht po qëndronte ulur aty {imiton Mingusin që qëndronte pa lëvizur me krahët e palosur}. Pastaj, kur ai zbriti nga skena, i thashë se çfarë seti fantastik me {vizaton një rreth me gishtin tregues të djathtë}. Unë thashë {e mban dorën e djathtë sikur të ishte duke folur në mikrofon}, “Z. Mingus, cili është mesazhi juaj për popullin e Jugosllavisë?” Dhe pastaj ai shikoi dhe qeshi dhe tha, “Bëhuni të pasur!” (qesh).

Pra ishte... pra ashtu ishte Jugosllavia. Ishte disi... e dini, e di që e takova më vonë, shumë vite më vonë, regjisorin e filmit nga Beograd, Srđan Karanović, i cili ishte një regjisor i shkëlqyer. Dhe Đinđić tha, ai tha, ai thotë, “Pra, ne thjesht thonim... *hajde da napravimo sranje.*” Domethënë, “Të bëjmë ca gjëra të trenta, apo jo? T'i bëjmë së bashku.” Dhe pra ekzistonte një lloj cilësie improvizuese. Dhe pra, për aq kohë sa nuk e kërcënoje dikë në pushtet dhe kësi gjërash, kishte shumë gjëra që mund të bëje. Dhe kjo është çka zbulova.

Erëmirë Krasniqi: Dhe ju thatë që ky ishte viti 1965?

Mark Baskin: ‘75, ‘75.

Erëmirë Krasniqi: Në rregull.

Mark Baskin: Po, ‘65 do të kishte qenë pak si shumë herët për atë. ‘65 do të kishte qenë pak si shumë herët për atë.

Erëmirë Krasniqi: Doja të sigurohesha.

Mark Baskin: Po, '75.

Erëmirë Krasniqi: Mirë.

Mark Baskin: Po, kalova një kohë absolutisht fantastike. Dhe më pas kthehesha vazhdimisht. Dhe më pas vazhdova studimet e magjistraturës, dhe aty kishe mundësi për IREX. IREX ishte... ata ishin... tani, IREX i ka disa lloj projektesh, projekte zhvillimore gjithkund. Por në atë kohë, çfarë IREX bënte ishte që mirreshin me... shumicën e shkëmbimeve me shtetet komuniste, të paktën në Evropën Lindore. Dhe kështu ekzistonte një program i IREX-it për të kaluar një muaj në Bullgari (pa kupt. 8:13), për të studiuar bullgarishten. Kështu që shkova, dhe mendova se ishte një mënyrë... nuk e përballoja dot financiarisht të shkoja në Jugosllavi apo diçka të tillë, kështu që ata paguajtën për mua. Dhe unë gjithmonë kisha udhëtuar për në Zagreb, dhe e bëra atë për një vit. Dhe pastaj u ktheva dhe e bëra...

Erëmirë Krasniqi: Çfarë po studioje në nivelin master?

Mark Baskin: Pra unë e fillova me një program ndërdisiplinar Sovjetik-Evropiano-Lindor. Dhe doja të vazhdoja me histori, por kishte shumë pak vende pune për historianë. Tregu i punës në departamente të historisë ka qenë keq prej rreth... diku prej vitit 1960, besoj, domethënë.

Erëmirë Krasniqi: Paska qenë situatë e keqe.

Mark Baskin: Dhe kështu përcjellja një lëndë nga një politolog, dhe ai më tha, "Ti duhesh, domethënë të studiosh Shkenca politike". Dhe kështu zgjodha Shkenca politike, dhe pra më pas atë e bëra. Dhe më pas disi u getoizova. Kjo ishte disi komuniste sepse ne... metodat tona e këto gjëra ishin ndryshe, sepse në Universitetin e Michigan, një shkollë tejet pozitiviste dhe kuantitative, domethënë dhe pra kjo... shumë hulumtime me bazë në anketime. Departamenti i Michiganit është një departament i shkëlqyer, por është i njohur për studimet e tij të elektoratit, që bëhet me anketa e gjëra të ngjashme. Nuk mund të bëje diçka të tillë në Evropën Lindore ose në Bashkimin Sovjetik, kështu që unë thjesht...

Dhe kështu fillova të studioj Çështjen Kombëtare, çështjet që përkojnë me Çështjen Kombëtare. Dhe qasja ime nuk shikonte se si kombësia ndikon në sjellje, por se si shteti i jep formë kombësisë. Dhe kështu më pas e shkruajta një ese të gjatë duke parë dhe krahasuar maqedonët me myslimanët në atë kohë, musliman, më vonë Boshnjakët. Dhe argumenti im ishte që... në fakt, në Jugosllavinë socialiste, e cila është qartë jo-nacionaliste, ata ndihmuan në formësimin e, për arsye shumë racionale, të kombësive. Dhe, në shumë mënyra, ata e bënë. Në Maqedoni, qartë. Dhe me myslimanë po ashtu, sepse myslimanët nuk... kur ata ishin... në '53-tën, ata nuk u deklaruan si jugosllavë, serbë, apo kroatë. Ata thanë se ishin "Tjerë". Dhe më pas ishte... me kalimin e kohës, e dini, atyre iu lejua të deklaroheshin si musliman, dhe pastaj kishte një elitë që doli në sipërfaqe, e të tjera, e të tjera.

Dhe pra më pas mentori im më tha... eh po, kjo duhet të ketë qenë në vitin 1979... ai më tha, "E pse nuk po e studjon Kosovën?"

Erëmirë Krasniqi: Vërtetë?

Mark Baskin: Po, ai më tha, "Pse nuk e shikon..." ai tha, "E tërë kjo është vërtetë interesante. Pse nuk po e bën Kosovën rast studimi?" Kështu që e shkrova një ese...

Erëmirë Krasniqi: A e dije se ku ishte [Kosova]?

Mark Baskin: Po, po, patjetër, e dija. Jo, jo, dua të them, unë veç kisha qenë në Jugosllavi.

Erëmirë Krasniqi: Në rregull, a po udhëtoje gjatë kohës sa ishte këtu? Po mendoj, e përmende Beogradin, por a po udhëtoni përreth?

Mark Baskin: Në të '75-tën, shkova në Bosnje. Kam kaluar kohë në Slloveni, patjetër. Nuk arrita të shkoj në Maqedoni. Nuk arrita të shkoj aq shumë poshtë. Dhe Beograd. Dhe më pas [kalova] kohë në bregdet. Dhe, patjetër, por, po, po, ishte bukur. Por Korçula më pëlqen më shumë se Dubrovniku. Në fakt, ishte shumë më mirë, në shumë mënyra. Dhe, po, nuk kam shkuar në Istria. Veç në të '82-tën kur u ktheva të bëja hulumtimet e doktoraturës kalova pak kohë aty. Dhe atëherë shkova gjithkund. Dhe më duhet të them, kam shkuar në çdo republikë dhe provincë autonome në Jugosllavi, por pasi e shkrova tezën time.

Pra e shkrova një tezë rreth... sepse, e dini, kur po punoja, teza ime e baqellorit ishte rreth zhvillimit të nacionalizmit kroat deri në vitin 1848. Kështu që, shkrova rreth lëvizjes ilire dhe gjëra të tilla. Dhe pastaj ishte një artikull... kush e ka shkruar? Nuk më kujtohet personi, një vëllim i redaktuar nga Peter Sugar nga Universiteti i Washingtonit mbi Çështjen Kombëtare në Evropën Lindore. Dhe më kujtohet që kam lexuar një kapitull mbi Jugosllavinë, dhe ishte gjithëpërfshirës. Përfshiu gjithçka. Dhe kështu...

Pra e shkrova... përfundova duke e shkruajtur... ai më tha... ishte ndoshta në të '80-tën ose '81-tën, sepse atëherë e pata shkruar një tekst rreth demonstratave në vitin 1981. Dhe më pas ishte më vonë... ishte artikulli im i parë i publikuar në një revistë, i cili u publikua në një revistë të quajtur *Problems with Communism* [Problemet me Komunizmin], e publikuar në të '83-tën kur unë po bëja kërkimet e doktoraturës.

Erëmirë Krasniqi: Do t'i kthehem asaj. Pasi që është temë me rëndësi.

Mark Baskin: Po, dhe kështu unë...

Erëmirë Krasniqi: Pra, më trego për Kosovën kur mentori juaj ju tha...

Mark Baskin: Pra, unë, e dini, dhe kështu çka unë bëra në atë kohë, e dini, kjo ishte para internetit, kështu që ekzistonin tri mënyra, burime të informacionit nëse doje diçka mbi ngjarjet aktuale, sepse... njëra ishin gazetat jugosllave, dhe jugosllave, ne u abonam në të gjitha në Michigan. Por ato vini gjashtë javë, tetë javë me vonesë. E dini, pra për të lexuar, nuk e di nëse e kishim "Rilindjen", pra, por e kishim, domethënë, "NIN"²⁶. Dhe e kishim VUS²⁷ në atë kohë, besoj. S'e besoj... ajo ka qenë para "Danas"²⁸ besoj ndoshta "Danas"... por ajo [VUS] ka qenë javorja e Zagrebit. Dhe pastaj, patjetër,

²⁶ *Nedeljne informativne novine*, në përkthim "Gazeta informative javore," një revistë lajmesh e Beogradit.

²⁷ *Vjesnik u srijedu*, edicioni i shumë-lexuar i së mërkurës *Vjesnik* (Lajmi), një gazetë e përditshme shtetërore e botuar në Zagreb.

²⁸ Serbisht për "sot", një e përditshme e pavarur e majtë e botuar në Beograd duke filluar nga viti 1997.

“Politika”²⁹ dhe “Borba”.³⁰ “Borba” ka qenë burim i mirë, por shumë, e dini {mbledh dorën në formë grushti}... me perspektivë të qartë, do të kisha thënë. Ndonëse më pak nacionaliste se “Politika”, kur e mendoj prapë.

Dhe më pas ishte kjo... ishte një diçka që quhej *FBIS - Federal Broadcast Information Service*³¹. Dhe ato vinin brenda vetëm katër apo pesë ditëve, dhe këto ishin përkthime të shtypit që bëheshin nga qeveria e Shteteve të Bashkuara të cilat u shpërndaheshin më pas të gjithëve. Dhe ne i merrnim ato. Ishin mjaft të lira, tepër [të shtrenjta] për një student të doktoraturës, por mentori im i blinte. Dhe i merrnim në bibliotekë po ashtu. Dhe mendoj që edhe qendra ruse i mbante, kështu që i kisha tre burime të ndryshme për t’i marrë ato. Pra aty e zbulojë çka po ndodhte. Pra ato ishin burimet e informacionit. Dhe..

Erëmirë Krasniqi: Si ishte...

Mark Baskin: Dhe Michigan ishte një vend i shkëlqyer për këtë sepse aty ishte një antropolog i cili kishte bërë punën e tij hulumtuese në Bosnje, kishte bërë punë në terren në Bosnje, dhe gruaja e tij ishte një folkloriste që kishte punuar në Bosnje në të ‘60-at në një zonë afër Bugojnos. Dhe historiani mesjetar i cili ishte... u bëra vërtetë i mirë... John Fine, gruaja e tij ishte nga Svetozarevo, ose tash Jagodina. Por ajo përfundoi në Brandeis³² si studente e baqellorit. Dhe Gena, por Gena kishte shumë kontakte në... pra ekzistonte një lloj komuniteti i madh i interesuar në Ballkan, relativisht, në Michigan. Për të bërë çfarë bëra unë, i vetmi vend tjetër ku do të doja më tepër të... mund të kishte qenë... do të kishte qenë Berkeley³³. Por më vonë, duke biseduar me njerëz që studiuuan në Berkeley, u gëzova që kam shkuar në Michigan. Po mendoj, në Michigan, të gjithë shkonin mirë, profesorët të gjithë shkonin goxha mirë. Dhe...

Domethënë, disi... keni qenë, e dini, ka gjithmonë vende ku zënkat akademike janë të shpeshta në Shtetet e Bashkuara të cilat janë të pabaza e gjëra të tilla. Ekzistonte diçka e tillë mes të themi njerëzve të Gjuhës dhe letërsisë dhe studjuesve të Shkencave shoqërore. Por përbrenda Historisë dhe... dhe ata nuk përfshinin studentët pasuniversitarë në asnjë prej konflikteve, dhe kështu për mua ishte si të isha në parajsë (qesh) në shumë mënyra.

Erëmirë Krasniqi: Si paraqitej Kosova në atë kohë në lajmet në të cilat ju kishit qasje?

Mark Baskin: Mund të jua dërgoj artikullin nëse dëshironi.

Erëmirë Krasniqi: Dua të them, vetëm...

Mark Baskin: Kosova shihej si... ekzistonte një problem me integrimin e Kosovës në Jugosllavi në çdo nivel: ekonomik, shoqëror, dhe kulturor, dhe politik. Dhe, unë, në artikullin që shkrova, mund ta shihje ngritjen e një... klase të mesme të etnisë shqiptare pas amandamenteve të ‘68-ës. Dhe mund ta shihje

²⁹ Gazeta e përditshme më e vjetër serbe, e botuar në Beograd.

³⁰ Në përkthim “përleshje”, ishte gazetë serbe e cila poashtu kishte qenë gazetë zyrtare e Partisë Komuniste të Jugosllavisë.

³¹ Shërbimi Federal i Informacionit dhe Transmetimit.

³² Një universitet kërkimor në Boston.

³³ Kampusi më i mirënjohur dhe më prestigjioz në sistemin e Universitetit të Kalifornisë.

rrijten e pranisë së etnisë shqiptare që punonte në sektorin shoqëror, rritjen në përqindjen e anëtarëve të partisë për etninë shqiptare. Dhe, domethënë, edhe sot, kur takon njerëz të brezave më të vjetër, të gjithë e flasin serbishten mjaft rrjedhshëm, e të tjera, e të tjera. Dhe kështu ata ishin pjesë e sistemit dhe pjesë e regjimit në shumë aspekte.

Dhe, në Kosovë, njësoj si në Kroaci, ndonëse situatë më ekstreme, kishte shumë kundërshtime, dhe kishte njerëz, kështu që ka shumë të burgosur politikë dhe gjëra të tilla. Gjëra të tilla. Por, po mendoj, në përgjithësi, e shihnin si, domethënë përqindja e lartë e lindjeve ishte problem, domethënë. Dhe pa marrë parasysh se sa shumë investime shkonin në Kosovë prej këtyre fondeve federale dhe se sa shumë rritje kishte, rritja për kokë banori nuk ishte aq e madhe për shkak të përqindjes së lartë të lindjeve. Dhe pra, në shumë mënyra nuk shihej si plotësisht e integruar.

Dhe unë nuk e kuptova se sa e pasaktë ishte kjo, apo se si ishte pasaktë, deri kur erdha këtu për herë të parë në vitin '99... hera e parë që kalova kohë në Kosovë ishtë në vitin '99... sepse çfarë zbulova ishte se, unë kisha shokë që studionin në Zagreb... i takon gjithë ata njerëz që shkojnë për të studiuar në Sarajevë dhe në Beograd dhe në Shkup. Dhe kështu që në shumë mënyra Kosova ishte pjesë e sistemit jugosllav. Dhe kjo... po mendoj, është diçka që, patjetër, nëse ishte i fshatit, domethënë nuk ishte domosdoshmërisht [pjesë e sistemit jugosllav]. Ishte... ishte një lloj sistemi dual në atë kuptim, por njerëzit që ishin të qytetit, njerëzit... dhe që...

Po mendoj, në rastin e shokut tim Bashkimit, besoj dy shokët e mi të cilët shkuan për të studiuar Shkenca politike në Zagreb, nuk mendoj që ishin... prindërit e tyre ishin njerëz familjarë, megjithëse njëri ishte vëllau i Orhan Nevzatit. Nuk e di nëse e njihni Orhanin. Orhan Nervzati ishte... ai ishte në Komitetin Qëndror me Mikasićin në fundin e viteve të '60-a, dhe ai ishte shfajësuar bashkë me Mikasićin. Dhe më pas më vonë Orhani... besoj që jeton në Beograd tash, por ai është nga Prizreni.

Erëmirë Krasniqi: A keni takuar shqiptarë sa ishit në Zagreb? Të profilit të...

Mark Baskin: Në vitin '89-të kam takuar.

Erëmirë Krasniqi: Në '89-tën.

Mark Baskin: E kam takur Vevin. Ishte një djalë që kishte shnëdrruar një restorant kinez në grill restorant argjentinas, dhe ajo ishte hera e parë që provova verë të Kosovës. Ata kishin Orvj... ata kishin verë unë po e pija, sepse ishte verë e shkëlqyer dhe ishte e lirë. Domethënë, edhe gjatë periudhës së komunizmit, ishte gjithashtu më pak e shtrenjtë se, domethënë, Graš, Graševina, e dini, ato verërat kroate, dhe kështu ishte mjaft e mirë. Sidoqoftë, po mendoj, këta njerëz ishin... kishte shumë mënyra në të cilat ishin, por, domethënë, ishin... patjetër, në fund, nuk funksionoi, sidomos pasi Tito vdiq, dhe gjithë ato gjëra.

Erëmirë Krasniqi: Për t'u kthyer tek artikulli i '81-tës, sa e vështirë ishte të shkruaje diçka rreth të '81-tës sepse jo shumë informacion ishte i disponueshëm?

Mark Baskin: Oh, do të surprizoheshe.

Erëmirë Krasniqi: Në rregull.

Mark Baskin: Kishte shumë. Vërtetë, në shtyp gjithçka ishte aty. Do t'ju tregoj. Po mendoj, do jua dërgoj artikullin.

Erëmirë Krasniqi: Sepse sot mezi gjen një foto të protestuesve. Ishte e kontrolluar në atë mënyrë...

Mark Baskin: Artikulli im nuk ka qenë rreth njerëzve. Ka qenë... pyetja që po parashtroja në artikull, dhe revista ka qenë një që publikohej nga Departamenti i Shtetit, megjithëse ishte revistë akademike. Titulli ka qenë "A mund regjimi të rivendos një lloj rendi legjitim?" Dhe pra po kërkonte se cilat janë pritjet për Kosovën. Dhe kështu... dhe ishte e lehtë të mësoje për demonstratat, e dini, "Trepča, Trepča Radi, Beograd Gradi" [Trepça punon, Beogradi ndërton], domethënë, asi lloj gjërash. Dhe ishte e lehtë t'i gjeje ato lloj gjërash, dhe më pas lexoje gjëra që e dënonin nacionalizmin, por më pas gjeje informata rreth çfarë po ndodhte në të vërtetë.

Që kur, me sa duket kur... mendoj se ishte *Partizan*³⁴ ose *Zvezda*³⁵, erdhën dhe luajtën me ekipin e futbollit të Prishtinës, dhe të gjithë po bërtisnin "EHO, EHO". Pra, e dini, dhe ata po e dënonin krejt atë, por më pas e sheh që ajo ndodh vërtet. Kështu që ajo ishte... po mendoj, pra ajo ishte çka ishte... unë nuk isha duke bërë... domethënë, punën që ajo... antropologia norvegjeze në... afër Pejës. A e dini për çfarë po flas? Robert Elsie³⁶ publikoi një libër. Është i shkëlqyer.

[Rrëfimi vazhdon në pjesën e tretë]

Pjesa e Tretë

Erëmirë Krasniqi: Pra, po flisim për Berit Backer, apo jo?

Mark Baskin: Thjesht po them që çka bëja unë nuk ishte e njëjtë me gjërat që bënte ajo. Ajo shkoi dhe jetoi atje dhe e bëri këtë, dhe unë nuk po flisja për mënyrën se si njerëzit jetonin. Unë vërtetë po shikoja nëse regjimi mund të organizohej dhe të rivendoste rend, dhe përfundova disi (ndalet) pozitiv në mënyrë pesimiste (qesh). Epo, unë nuk... po mendoj, kur e shikon, kur e shikoj prapë... kur e shikon, nuk funksionoi shumë mire, dhe duhej... do të ishte mirë të kishte ca histori që e hulumtojnë rolin e udheheqësve që ishin të etnisë serbe, për shembull, edhe pas vitit 1974 këtu, sepse njerëzit më kanë treguar gjëra prej që jam kthyer. Ata thanë, "Eh po, e dini, po, çdo gjë ishte duke ndryshuar, por kishte ende serbë. Ne gjithmonë dukeshim... serbët ishin gjithmonë në krye". Dhe nuk e di nëse ajo ishte e vërtetë ose jo. Të njëjtën e dëgjova edhe në Kroaci. Dhe do të ishte vërtetë interesante të shihje, edhe para vitit 1981, dhe më pas sidomos në mes të '81-tës dhe '90-ës, të shihje se si gjërat rrodhën.

Erëmirë Krasniqi: Çfarë qëndrimi kishte SHBA-ja ndaj Jugosllavisë? A e përfshinte [edhe Jugosllavinë] në pikëpamjen që kishte për Evropën Lindore si komuniste?

Mark Baskin: Varet se me kë flet.

³⁴ Klubi Partizan i futbollit nga Beogradi.

³⁵ Serbisht për "yll", duke iu referuar klubit të futbollit të Beogradit Ylli i Kuq.

³⁶ Një dijetar kanadez i cili ka specializuar në studime shqiptare.

Erëmirë Krasniqi: Apo sa e çliruar ishte nga ai mendim i përgjithshëm?

Mark Baskin: E dini, nëse flisnit me këdo që dinte diçka, [Jugosllavia] nuk ishte pjesë e bllokut sovjetik. Në perceptimin e përgjithshëm e të përhapur, ishte shtet komunist dhe goxha i tmerrshëm. Dhe kishte shumë refugjatë pas Luftës së Dytë Botërore, të llojit anti-komunist, dhe pra ishin shumë anti-jugosllav. Dhe...

Erëmirë Krasniqi: A gjente vend në... ai perceptim, a gjeti vend në akademi? Këtë po them. A ishte...

Mark Baskin: Oh, në akademi, jo. Në akademi, Jugosllavia ishte disi super dhe interesant, po mendoj, në shumë nivele. Po mendoj, që kishte... ne e pamë, dhe besoj që kishte vërtetë përpjekje. Për shembull, Vllaznim-Bashkimi nuk ishte thjesht slogan, por ishte një përpjekje reale për të gjetur një mënyrë në të cilën njerëzit mund të kishin sete të shumta të identiteteve, e të tjera, e të tjera.

Branko Horvat³⁷ ishte nominuar për çmimin Nobel për punën e tij në vetqeverisje. Njerëz si Tea Petrin, studentja e tij, dhe Aleš Vahčić, burri i saj, ishin në Cornell³⁸. Mendoj që Tea e përfundoi doktoraturën në Cornell kur Branko ishte aty. Ekzistonte një përpjekje reale për ta bërë atë *The Praxis School* [Shkollën Praktike]. Po mendoj, Jugosllavia shihej si një lloj mënyre e tretë që ndoshta mund të funksiononte. Dhe, në fund, nuk funksionoi për llojlloj arsyesh vërtetë të këqija.

Dhe kur domethënë... unë kam shokë, e dini, të cilët kishin lidhje me njerëzit e *Praxis*, domethënë, disa si Rudi Supek dhe ai grup nga Zagrebi. Dhe, po mendoj, kritika e tyre... madje edhe kritika që nuk vinte nga *Praxis*, mentori im në Zagreb në vitin 1983 ka qenë Josip Županov, sociolog, dhe kur e lexon kritikën e tij për Jugosllavinë, ka qenë përçmuese, po mendoj, dhe mjaft e saktë, dhe, domethënë, e drejtpërdrejtë. Nuk ishte e sentimentale apo nacionaliste ose diçka e tillë, madje as pro demokracisë. Ai thjesht po thoshte që nuk funksionon. Dhe njerëzit e *Praxis* dëshironin që pastaj të krijonin një lloj gjëje më të mirë disi komuniste socialiste.

Pra, por filozofikisht, i takon këta persona perëndimorë që ligjëronin në departamentet e filozofisë. Për një verë, kalova kohë me një djalë nga Universiteti i Illinois. Dhe kjo ishte në të '83-tën, ai po më thoshte, ai thotë, "Të gjithë këta persona ishin vërtetë filozofë të mirë njësoj si Mihailo Marković dhe këtyre iu pëlqente ky fakt". Ai thotë, "Por krejt çfarë bëjnë është se flasin për nacionalizmin", (qesh). Ai thotë, "Por kur i bën të flasin për, disi, filozofi Marksiste, janë shumë të mirë". Dhe kështu jugosllavët ishin... Jugosllavia shihej si ky... por mund t'ia dilte... kur e shikoj prapë, mund t'ia dilte të ekzistonte mes këtyre dy sistemeve, dhe Tito me në mënyrë brilante i vuri kundër njëri-tjetrit dhe siguroi një sasi të caktuar hapësire. Ekonomikisht nuk u organizua kurrë plotësisht, por...

Pra kështu e shihnin njerëzit. Vetqeverisja ishte diçka interesante. Përpjekja për të krijuar një komunitet të vërtetë, një shtet, e të tjera, e të tjera ishte një mënyrë e të shikuarit. Në të njëjtën kohë, kishte njerëz, sidomos të llojit [që merreshin me] letërsi... një djalë Ante Kadić i cili ligjëronte në

³⁷ Branko Horvat (1928-2003). Ishte ekonomist dhe politikan kroat i cili një kohë të gjatë ka punuar në Institutin e shkencave ekonomike të ish Jugosllavisë. Ishte botues i revistës *Economic Analysis and Workers' Self-Management* - Analiza ekonomike dhe vetqeverisja e punëtorëve, dhe bashkëpunor i revistës *Praxis*, ku ai shkruante punime nga këndvështrimi ekonomik. Ai ishte anëtar i Institutit ekonomik në Zagreb.

³⁸ Universiteti kërkimor privat në Ithaca, New York.

Indiana, i cili ishte një nationalist kroat, por ishte djalë i mirë, por urrente... po mendoj, e din, fliste për shpëtimin e kroatëve, e të tjera, e të tjera, por, domethënë... dhe ia lexova materialet dhe thashë, “Zot!” Dhe më pas e takova në, domethënë, në disa konferenca për Studime sllavike, ai është njeri i lezetshëm, domethënë. Dhe më pas unë kisha një... një shoku im i cili ishte profesor në Universitetin e Zagrebit, në Shkenca politike, anëtar i Partisë, ai më vonë u bë... ai ishte Ambasador nën... nga Kroacia. Por shkoi në Indiana në vitet e ‘80-ta, dhe e njihte Kadićin... dhe, domethënë, dhe Grego ishte anëtar i Partisë dhe Kadić ishte... ai thotë, “Aaahhh, Kadić është djalë i mirë, e din”.

Pra ekzistonte kjo ndjenjë se jugosllavët, ata, ekzistonte, domethënë një ironi e nëkuptuar, dhe që kishte një ndjenjë që kishte një jetë të mirë. Dhe kush ishte personi? Redaktori i “Republikës”³⁹ për një kohë të gjatë. Kur vinte në SHBA, komuniteti jugosllav thoshte, “Ai do të jetë duke kontrabanduar kajmak”, (qesh). Domethënë, kesi lloj gjërash. Sepse atje, çfarë të mungon? Më mungon bureku, më mungon kajmaku, domethënë. Dhe kështu kjo ishte çka ti, në të njëjtën kohë... pra Jugosllavia shihej si ky vend super.

Unë mund të... dhe një ndër arsyt pse zgjodha të studioj në Jugosllavi në vend të Bashkimit Sovjetik është se ti mund të... çdo gjë mund të ishte në rregull ditën para se të fluturoje në Moskë, mund të të thonin që nuk ke vizë. Mund të të refuzonin për çfarëdo arsye. Mund të shfaqesha... apo u shfaq, u shfaq në Beograd, mendoj, në të ‘78-ën ose të ‘79-tën. Nuk kisha vizë. 20 minuta më vonë, isha brenda [Beogradit]. Ishte e thjeshtë. Dhe ishte shtet komunist, domethënë. Kështu që ishte vend vërtetë interesant në atë aspekt.

Erëmirë Krasniqi: Kur u ktheve në të ‘83-tën, a ishte për doktoraturë?

Mark Baskin: Po, vitet ‘82-‘83. Dhe përfundova duke mos e trajtuar Çështjen Kombëtare, sepse do të kishte qenë tepër rrezik. Përfundova... teza ime e doktoraturës ka qenë për kthimin dhe integrimin e punëtorëve migrantë, punëtorët migrantë jugosllav, *Gastarbeiter*⁴⁰.

Erëmirë Krasniqi: Po, po, kishte një...

Mark Baskin: Pesë përqind e popullatës ishin duke jetuar jashtë, 14 përqind e fuqisë punëtore.

Erëmirë Krasniqi: E cila filloi në të ‘60-tat apo?

Mark Baskin: Filloi pas reformës ekonomike në vitin 1965. Ajo ishte marrëveshja që Tito e bëri me FMN [Fondi Monetar Ndërkombëtar]. Domethënë, që ata kishin për të dhënë... kishin për t’i hapur kufijtë dhe për të provuar ta heqin qafe këtë përdorim joefikas të punëtorëve, të punës. Dhe më pas kishte...

Erëmirë Krasniqi: A ia vlente?

Mark Baskin: Po, esencialisht atyre u lejohej të udhëtonin. Dhe nuk trajtoheshin mirë, e din, jashtë vendit e tjerë. Krijoi shumë probleme në fund.

Erëmirë Krasniqi: Po, ata kryesisht ishin në Gjermani dhe Zvicër, apo?

³⁹ Revista kroate për art, letërsi dhe shoqëri.

⁴⁰ Fjalë në gjermanisht që fjalë për fjalë ka kuptimin “punëtorët mysafirë”.

Mark Baskin: Ishin edhe në Francë. Ishin gjithkrah.

Erëmirë Krasniqi: Okej.

Mark Baskin: Ishte një komunitet i madh edhe në... ishte një komunitet i madh jugosllav edhe në Australi. Nuk më duket se kishin shkuar të punojnë përkohsisht. Por ishte një... ishte një zinxhir i migrameve. Andaj, njerëzit iknin dhe unë i analizoja problemet e politikave, e din, si po e trajtojnë këtë si problem i politikave. Por, e dini, shkonin në Gjermani, dhe një person shkonte, dhe ata i merrnin me veti familjet e tyre. Aty ekzistonte njëfarë ideje e rotacionit me gjermanët, që ti vije për gjashtë muaj, i bëje ca para, shkoje në shtëpi, por nuk ndodhi ashtu, sepse nuk kishte investime të njëmendta në vendlindje, dhe njerëzit merrnin paratë që kishin kursyer, dhe nuk kishte treg kapitalist për të investuar. Pra e tëra që bënin ishte të ndërtonin shtëpi të mëdha (qesh) dhe gjëra të ngjashme.

Erëmirë Krasniqi: Prej nga ishin kryesisht? Nga cilat shtete të Jugosllavisë federale?

Mark Baskin: Ishin nga vende të ndryshme, por kryesisht përqindja më e madhe ishte kroate, më e madhja. Dhe... por kishte shumë njerëz nga Serbia po ashtu, shumë, një numër i madh. Ishte... Kosova, për ta Zvicra ishte vendi ku shkonin. Njerëzit shkonin në shtete të ndryshme. E din, çdokush shkoi në Gjermani sepse Gjermania është e madhe, por kishte njerëz që shkonin në Skandinavi po ashtu, njerëz që shkonin në Francë, e kështu...

Erëmirë Krasniqi: Cili ishte përfundimi i juaj? A kishte ndonjë? Sa i përket tezës suaj?

Mark Baskin: Pra, teza ime ishte, prapë, ishte një tezë shumë tipike e politikave publike për Michigan. Përfundimi im ishte që procesi i bërjes së politikave në një shtet komunist nuk është dhe aq ndryshe prej proceseve të bërjes së politikave në një vend jo-komunist, dhe është shumë jo-racional në mënyra të njëjta, edhe pse perceptimi nga jashtë është që është një proces shumë nën kontroll. Pra, ky ishte përfundimi i. Dhe nuk ishte... nuk isha duke analizuar... po ashtu... thashë... po ashtu e bëra një përfundim rreth bërjes së politikave në Jugosllavi, që pohonte se për të është shumë me rëndësi përmbajtja simbolike sesa ajo praktike.

Dhe unë përfundova duke cituar ca nga puna e Clifford Geertz në kapitullin konkludues për... dhe ai ka bërë një histori të Balit të shekullit të XIX-të, ku ai flet për... ai shpenzon shumë kohë duke folur për atë se si ata mbledhin, si prodhojnë, si mbledhin taksat, dhe në fund e përmbledh me një festival shumë të madh çdo vjet. Ata i shpenzojnë të gjithë paratë e tyre në këtë festival të madh, dhe ai thotë se është një deklaram për... është një deklaram për veten e tyre për atë se çfarë ata janë. Dhe mendoj se shumë gjëra rreth politikbërjes Jugosllave është kështu. Dhe akoma mendoj se shumë rreth politikbërjes në këtë regjion është kështu. Por kështu është gjithkund tjetër gjithashtu, kështu që... Pra ky ishte përfundimi im, jo veçanërisht... dhe pastaj u ktheva në vitin '89.

Erëmirë Krasniqi: Si ashtu?

Mark Baskin: Sepse doja...

Erëmirë Krasniqi: Ishte një kohë e vështirë për t'u kthyer, vërtetë.

Mark Baskin: Oh, ishte argëtuese.

Erëmirë Krasniqi: (Qeshë). Vërtetë?

Mark Baskin: Eh po, po, në vitet '82-'83, e din, unë drejtova një ekip bejsbolli në Zagreb. Isha në një shfaqje. Ishte... Jugosllavia ishte një vend që ishte totalisht i hapur, kupton? Pastaj në vitin '89, aplikova sepse një nga gjërat... një nga skemat ishte se ata mendonin se ndoshta biznesi i vogël, *mala privreda*, siç thoshin në kroatisht, apo jo?... Dhe se ideja ishte që njerëzit mund të kthehen dhe ata mund të investojnë, ndoshta të krijojnë disa tregje kapitaliste, e të tjera. Kështu që, u ktheva për të shndërruar temën time, të cilën e mbrojta në vitin '86, në libër. Dhe pastaj u ktheva dhe, e din, si themi ne në Kroatisht, "*Puknuo je film*"⁴¹ a din. Gjithçka shkoi për drejt.

Kështu që, unë thjesht fillova të... fillova të bëja gjëra tjera sa isha atje, dhe unë nuk... Bëra një mori gjërash për atë, por pastaj përfundova duke e ndjekur lëvizjet e demokratizimit. Shkoja në mbledhjet e UJDI-së (Shoqata Jugosllave për iniciativën demokratike) në Zagreb, ku Branko Horvat vinte dhe kërkonte falje. A din, aty po ndodhnin disa gjëra të mahnitshme deri kur...

Erëmirë Krasniqi: Mund të futeni më në detaje? Çfarë po ndodhte? Si e gjetët veten në ato klube?

Mark Baskin: Pra unë isha në Fakultetin për Shkenca Politike, dhe unë isha me, në atë kohë... ne tani jemi gjenerata më e vjetër... por në atë kohë, ata ishin gjenerate e mesme e anëtarëve të fakultetit. Dhe pothuajse të gjithë ata ishin progresivë. Ishin gjithë këta djem që kaluan shumë kohë jashtë duke studiuar në Gjermani, në SHBA, dhe kështu. Dhe ata të gjithë ishin të lidhur [për partinë], por ata gjithashtu ishin... Zaku nuk ishte... a e keni takuar ndonjëherë Zakušakun? Ai është një... sidoqoftë, më duket se ju nuk e dini. Sidoqoftë, Zaku, nuk mendoj, se ishte anëtarë i partisë, por Grego dhe të tjerët ishin.

Dhe... pra ata... kjo UJDI-ja në Zagreb ishte një përpjekje që në një mënyrë të sillnin... dhe e di se ishte edhe këtu. Unë njoh Vetonin [Surroi] dhe [Shkëlzenin](#) [Maliqi] dhe të tjerë po e bënin këtu. Ajo... ishte një përpjekje të bashkonin gjeneratën që kishte qenë në burg në vitet e 1970-ta me gjeneratën që ishin akoma aty për të bërë një lloj pajtimi, për të krijuar një lloj bashkësie më të gjerë kombëtare rreth një sërë parimesh që bazoheshin në një lloj qeverisjeje demokratike, sepse lloji i... të gjitha eksperimentet e shumta të Jugosllavisë thjesht nuk funksionuan, dhe kështu që... ishte e qartë se, sidomos, e din, në vitin '88, qeveria e parë jekomuniste erdhi në pushtet në Poloni.

E din, qeveria e Mazowieckit, dhe pastaj kishte disa fryma ndryshimi që po vinin. Dhe pastaj ishin Sllovenët. Dhe Koratët... ishte sa isha aty, në fakt. Zgjedhjet brendapartiake, kush do të ishte... Račan⁴² fitoi, dhe ai ishte në garë me një burrë të quajtur Ivo Deužić. Ai nuk ishte i keq me sa duket. Por Račani ishte reformisti. Po mendoj, ai ishte njeriu që tha, "Po, ne duhet të kemi zgjedhje", dhe gjithë këto gjëra. Dhe pra kishte një lëvizje... ishte afër, që komunizmi kishte pushuar së funksionuari. Muri i Berlinit ra, e din, gjithë këto gjëra. Dhe kështu që... ndërsa Jugosllavia duhet të jetë e para. Dhe...

⁴¹ Kro.: përkthimi bukfal, filmi më është prerë, një shprehje që përdoret për të përshkruar kur gjërat shkojnë keq, të paplanifikuara, jo sipas një skenari.

⁴² Ivica Račan, që më vonë u bë kryeministri i Kroacisë

Erëmirë Krasniqi: Dhe do të mundte, sidomos nën dritën e atyre zhvillimeve të reja, apo jo?

Mark Baskin: Pra ishte e gjitha ajo. Dhe pastaj, kolegët e mi në Fakultetin e Shkencave Politike, për shkak se ata ishin njerëz të Račanit, ata kishin shumë vetëbesim. Dhe...

Erëmirë Krasniqi: A po punonit si profesor?

Mark Baskin: Jo, unë po bëja hulumtime.

Erëmirë Krasniqi: Ah, ti ishe vetëm një hulumtues.

Mark Baskin: Unë nuk kisha një zyre apo diçka, por po mendoj, unë vetëm... unë shkoja të kaloja kohë, rrija aty, a din. dhe unë kisha një... por, në atë kohë, mentori im ishte një burrë i quajtur Ivan Šiber, i cili ishte një psikolog politik. Dhe Šiberi ishte... ai ishte një akademik shumë i mirë. Dhe... dhe pra ishte një kohë emocionuese për mua. Dhe...

Erëmirë Krasniqi: A kishin ata ndonjë ide se Jugosllavia do të shuhej?

Mark Baskin: Jo, nuk kishin. Nuk kishin. Por pastaj më kujtohet, ju me siguri nuk keni ndëgjuar për Jill Irvine. Ju në fakt jeni, po harroj që ju jeni gjeneratë më e re. Më kujtohet duke shkuar për të marrë këta dy djem, dy persona që i njihja. Njëri ishte... ku shoki Evani? Nuk e di ku shkoi Evani, por Evani, ai ishte ekonomist, ai kishte një bursë katër-mujore. Une e mora atë dikur në janar apo shkurt. Dhe përderisa isha në aeroport në Zagreb, mund të shihje gjithë këta burra, gjithë këta burra nga *HDZ-ja*⁴³ duke u kthyer.

Për herë të parë, këta burra nga migrimi që ishin... kudo që kishin qenë, Australi, Evropë, dhe në njëfarë mënyre thjesht mund ta shihje se sa entuziastë ishin. Kam bërë një intervistë me Gojko Šušaukun pikërisht pas zgjedhjeve. Šušak-u më vonë u bë Ministër i Mbrojtjes nën udhëheqjen e Tuđmanit⁴⁴. Ai ishte sikur kumbari i *Hercegovcave*.⁴⁵ Dhe, a din, ata ishin të ngazëllyer për këtë. Dhe burrat në Parti, ata tingëllonin shumë sikur... mund ta shihnit këtu, pak sikur PDK-ja do thoja unë, në kuptimin që... eh po, ka të vërtetë se, a din, PDK-ja ka burra vërtetë me eksperiencë dhe të mençur, dhe gjitha këto. “Eh po, ne kemi biletën më të mirë”. Dhe ata thjesht u... a din, ata u fshinë. Dhe kështu...

Dhe pra kishte një gjë shumë ngazëlluese. Dhe në atë kohë, unë e kisha shoqe... pra një nga shoqet e mia më të vjetra ishte një grua e quajtur Dubravka Ugrešić, të cilën ju ndoshta e njihni {drejton me gisht tek Erëmirë}. Dhe Dubravka është një shoqe e imja e vjetër. Dhe Dubravka më prezantoi me një shoqe të sajën, Vesna Kesić. Mund edhe ta njihni sepse Vesna më vonë u bë një nga feministet kryesore në Zagreb. Vesna ishte ndihmësredaktorja e “Start”, që ishte “Playboy” Jugosllav. Dhe unë po bëhesha gati të shkoja në Bullgari vetëm për të vizituar shoqërinë time për natën e Vitit të Ri, dhe Vesna thotë, “Dëgjo, më thuaj, pse nuk e shkruan një artikull për ne rreth asaj se çfarë po ndodhë në Bullgari?” Dhe

⁴³ Croatian: *Hrvatska demokratska zajednica* (Unioni Kroat Demokratik).

⁴⁴ Franjo Tuđman, Presidenti i parë i Kroacisë pas pavarësisimit.

⁴⁵ Hercegovci janë Kroatë nga Bosnja.

e bëra. Pra fillova të shkruaj për “Start”. Shkrova disa artikuj për “Start” rreth disa gjërave të çuditshme që po ndodhnin në Bullgari.

Erëmirë Krasniqi: Edhe ata ishin komunistë, apo jo? Bullgaria?

Mark Baskin: Po, po.

Erëmirë Krasniqi: Çfarë po ndodhte atje?

Mark Baskin: Oh, vetëm gjërat u prishën. Dhe unë kisha njohur disa bullgarë që nga koha ime më parë atje. Prapë po them, këta njerëz që ishin fëmijët e nomenklaturës që ishin shumë kritikë ndaj sistemit.

Erëmirë Krasniqi: Vërtetë?

Mark Baskin: Po, po, oh po, ata ishin të jashtëzakonshëm. Ishte... kur kalon kohë në... ata thonin në disa revista Jugosllave, ata flisnin për “shtetet e socializmit të vërtetë,” *realni socijalizam*. Ishte... dhe unë jetova... diçka që ja vlen të përmendet... jetova për rreth një vjet në Brighton Beach, që është në zonën e Brooklyn, ku të gjithë emigrantët hebrej të sovjetik kanë ardhur. Dhe atje ishte një lloj afërsie që nuk ishte këtu, sepse Jugosllavia veçse ishte infektuar nga kapitalizmi dhe njerëzit po shkonin në drejtime të ndryshme. Mendoj që ndoshta në Kosovë ka qenë kjo afërsi për shkak të shtypjes, sidomos pas vitit 1990... por edhe më parë. Ka qenë një afërsi e një lloj kualiteti dhe lëvizjeje që nuk ka qenë në Zagreb. Po, ndoshta më shumë në Beograd sesa në Zagreb në fakt. Edhe në Bullgari ishte shumë ashtu. Dhe, mirë, ajo është një histori krejt ndryshe. Kështu që kam kaluar kohë aty.

Por, a din, unë mund të hipja në makinën time në Zagreb, të përfundoja në Sofia nëntë orë më vonë, të kaloja një kufi (qeshë). Ishte shumë e thjeshtë. E dini Beograd deri në Kragujevc dhe përtej. Dhe...

Erëmirë Krasniqi: Dhe tani janë tre [kufi] (qeshë).

Mark Baskin: Dhe pra, po, tani është e tmerrshme. Dhe pastaj...

Erëmirë Krasniqi: Si ishte të ishe i pranishëm në këtë kohë brenda kësaj gjeografie?

Mark Baskin: Eh po, mund ta shikonit në vitet ‘82-‘83, ishte akoma një periudhë shtypjes së madhe. Kështu që, ishin këto *tribina* [tribunë]. Të gjithë djemtë, Žarko Puhovski, dhe gjithë këta djem tjerë ishin tek këto *tribina*. Unë shkoja tek kjo gjë, kjo, kjo është çfarë ndodhi pasi *Praxis* ishte... këtu vinin njerëzit nga e gjithë Jugosllavia një herë në muaj tek Fakulteti i Filozofisë dhe i kishin disa diskutime intenzive. Dhe plot prej tyre të cilët u bënë një lloj udhëheqje... gjenerata më e re. Gjenerata më e vjetër ishin njerëz si... babai i Vesna Pusićit, i cili ishte njëri nga njerëzit që e mblodhi atë. Ai ka dhënë mësim tek Fakulteti Juridik në Zagreb.

Kështu që, për mua, mund të ta dërgoj... a ta kam dërguar ndonjëherë këtë, Chester? Është një ditar të cilin e kam shkruar në revistën “Danas”. Çdo javë, ata kishin ditarin e një personi të famshëm ose të shquar. Dhe kur u ktheva menjëherë pas luftës [së Kroacisë], ata më thanë të shkruaja një ditar, dhe unë e bëra. Dhe e publikova, dikur rreth marsit të vitit 1992. Dhe më kujtohet njëri nga paragrafet, e thashë këtu, “Në Jugosllavi, jeta ishte më *aktuell* sesa në Shtetet e Bashkuara.” Në Shtetet e

Bashkuara, ne kemi... si e përmblihte Susan?... është një anonimitet i bazuar në treg apo diçka e tillë, a din, ku gjithkush është i shqetësuar vetëm me jetët e tyre personale. Dhe ndërsa, në Jugosllavi ishte një përpjekje e vërtetë përgjatë fundit të viteve '80 për të ndërtuar një komunitet që ishte gjithëpërfshirës dhe me kuptim, dhe dështoi (qeshë). Dështoi, por kishte një përpjekje për këtë. Por, a din, kishte përpjekje.

Dhe kishte njerëz... dhe Dubravka ishte njëra nga... kishte njerëz që... kishte prej këtyre grupeve pan-jugosllave. Njerëz të cilët vinin nga Shkupi. Kurrë nuk kam takuar ndonjë nga Kosova, edhe pse ka mundur të ketë aty. Njerëz vinin nga Shkupi. Dobrica Ćosić vinte. Njerëz nga Sllovenia vinin. A din, kishte nga Bosnja të cilët ishin të pranishëm aty. Pra, kishte një angazhim të vërtetë për të krijuar diçka.

Erëmirë Krasniqi: Sa gjatë qëndrove? Nga viti '89 deri kur?

Mark Baskin: Një vit.

Erëmirë Krasniqi: Një vit. Dhe pastaj u ktheve në SHBA?

Mark Baskin: Dhe pastaj po jipja mësim. Në të njëjtën kohë, unë isha duke dhënë mësim në një shkollë të vogël të arteve liberale, shkollë e arteve liberale të nivelit të dytë dhe të tretë në periferi të New York-ut, Manhattanville College, ku studentët e mi ishin më të shqetësuar për jetën e tyre shoqërore sesa për studimet e tyre, për ta përmbledhur... pak sikur në UAK [Universiteti Amerikan i Kosovës] në një farë mënyre (qeshë). Dhe pastaj e takova dikë, a din, që kishte një lidhje në OKB, dhe ai tha... pikërisht në kohën kur OKB-ja po zhvillonte misionin e tyre të parë... duhet të kishte qenë fundi i vitit 1991, fillimi i vitit 1992... dhe ai tha... a din, unë flas kroatisht... dhe ai tha, "Eh po, duhet të shkosh të punosh për ne, shok". Dhe kështu, rreth një vjet më vonë... e mora [punën]... mora rrugë dhe fillova punën për OKB-në. Dhe pastaj punova në Kroaci dhe Bosnje dhe më pas erdha në Kosovë. Dhe...

Erëmirë Krasniqi: Pra ti shkove në Kroaci para luftës për të vëzhguar se çfarë po ndodhte? Ose cili ishte roli i këtij misioni të OKB-së?

Mark Baskin: Ishte një mision i quajtur UNPROFOR, Forca Mbrojtëse e OKB-së. Dhe shoku im (qeshë), një akademik nga Zagrebi, ai tha, "Kë po e mbron?" (qeshë). Dhe unë thashë, "Mbrojtje me forcë. E dini, ne duhet të sigurohemi që jemi të mbrojtur". Ia shpjegova të gjithën, ai tha, "Kjo është fantastike". Kështu që, ai gjithmonë iu thoshte studentëve se UNPROFOR është duke mbrojtur veten (qeshë). Kjo është e vërtetë.

Për shkak se, e dini, duhet të lexosh mandatet me shumë kujdes. Ne kishim një mandat të bëjmë gjëra të caktuara. Kështu që, unë isha një oficer i çështjeve civile, dhe shkova... unë doja të shkoja në Bosnje sepse të gjithë Amerikanët e duan Bosnjën.

Erëmirë Krasniqi: Si? Si ashtu?

Mark Baskin: Eh po... çfarë më ka thënë John Fine, historiani mesjetar që është shumë i vjetër tani... historian i madh... ai tha kur e takova për herë të parë, para udhëtimit tim të parë në Jugosllavi, ai tha, "E dini, ju ndoshta duhet të shkoni në Sarajevë, sepse në shumë mënyra është vendi më kozmopolit në

Jugosllavi”. Sepse është vendi ku... ende, edhe tani, ju e dini, shtetet e Gjirit dhe gjithçka tjetër. Dhe e gjithë kjo është bërë {bashkon duart}. A shkon ndonjëherë në Sarajevë {drejton gishtin tek Erëmirë}?

Erëmirë Krasniqi: Jo, është shumë e komplikuar.

Mark Baskin: Po, po, e drejtë, e kuptoj, e drejtë, e drejtë.

Erëmirë Krasniqi: Së pari, duhet të shkosh në Maqedoni për të marrë një viza. Pastaj duhet të udhëtosh shumë gjatë.

Mark Baskin: E di, e di. Fluturon përmes Vienës. Është e komplikuar.

Erëmirë Krasniqi: Po, po, po, është e komplikuar.

Mark Baskin: Pra është më pak se tani sesa ishte më parë, por me të vërtetë ishte... është pak si Prizreni, më kujton pak Bosnjën në një sens që...

Erëmirë Krasniqi: Një lloj karakteri Amerikan, apo?

Mark Baskin: Jo, jo, jo për shkak të Amerikës. Unë po them që amerikanët që shkojnë, ne thjesht e duam Bosnjën sepse... dhe narrativa boshnjake ishte një rrëfim kaq i mrekullueshëm, që është se ne e kemi këtë komunitet, veçanërisht në Sarajevë. Ne kishim një komunitet të serbëve, kroatëve dhe myslimanëve. Të gjithë jemi marrë vesh. Dhe është e vërtetë që kishte një... ju ishit një Sarajli⁴⁶. Ju nuk ishit çfarëdo tjetër. A din, njerëz si Karadžići⁴⁷ dhe Krajišnik⁴⁸ dhe këta burra, dua të them, ishin *sejlaç*⁴⁹. Dua të them, ata ishin... me të vërtetë ishin. Dhe pastaj shikoni djemtë që... dhe një nga tragjeditë e mëdha të Jugosllavisë ishte se, në fund të regjimit, liberalët brenda partisë ishin të gjithë shumë të mirë. Dua të them, ata ishin të gjithë të hapur, të gatshëm, duke dashur të ishin shumëpartiakë dhe të kishin demokraci dhe të gjitha këto lloj gjërash. Por megjithatë ata nuk ishin... ata nuk kishin më fuqi për ta bërë këtë, dhe kjo ishte ironia apo ndoshta tragjedia e madhe. Dhe kështu...

Erëmirë Krasniqi: A ishte multikulturalizmi që mbizitoëronte në Bosnie ajo çfarë i tërhiqte Amerikanët?

Mark Baskin: Po, eh po, të gjithë ne... kjo, a din... unë thjesht... më pëlqente të shkoja... gjithmonë e kam dashur Bosnjën, a din. Ishte thjesht... ishte vërtetë turke në këtë kuptim, a din, *Başçaršija* [Bashçarshi]. Dhe unë shkoja... a din, shkoja... disa nga miqtë e mi të ngushtë... një djalë që më çonte në fshatin ku ata ndërjuan vikendicën e tyre jashtë Sarajevës. Dhe familja që ndihmuan në ndërtimin e saj, ishin disa myslimanë tradicionalë që ende kishin të veshura dimija. A din, kur shkoni në shtëpinë e tyre, ata menjëherë pastrojnë dhomën e ndejës, vendosin atë tavolinën e vogël dhe më pas nxjerrin të gjithë ushqimin që kanë. Të detyrojnë të pish raki. A din, është thjeshtë një mikpritje e mahnitshme. Është thjeshtë një lloj... është shumë simpatike. Ti e di dhe...

⁴⁶ Term boshnjak për një person nga Sarajeva.

⁴⁷ Radovan Karadžić, presidenti i Republikës Srpska gjatë luftës së Bosnjës.

⁴⁸ Momčilo Krajišnik, udhëheqësi politik serb i Bosnjës, i cili ka bashkëthemeluar paritinë nacionaliste Partia Demokratike Serbe.

⁴⁹ Term ofendues për fshatarët.

Erëmirë Krasniqi: Pra ti shkove për një mision gjithashtu?

Mark Baskin: Eh po, doja të shkoja në Bosnje, por në vend të kësaj, në urtësinë e tij, misioni më vendosi në Petrinja, që është në jug të Zagrebit. Dhe unë isha atje për një vit. Pastaj shkova në selinë qendrore në Zagreb duke punuar për misionin duke bërë analiza politike dhe gjëra të ndryshme dhe një mori gjërash të disa...

Erëmirë Krasniqi: Kjo është para luftës?

Mark Baskin: Jo, ky është viti '93, nga viti '93. Para luftës, kam qenë aty në vitin '92 dhe kam shkruar... kam qenë aty në '92 gjithsej nja dy muaj apo gjashtë javë apo diçka. Dhe pastaj aplikova për t'u bërë oficer i çështjeve civile të OKB-së. Dhe unë... a din, kur e mora punën, ishte në prill të '93-shit, dhe shkova, në fund shkova në Petrinjë, dhe aty qëndrova rreth tetë-nëntë muaj. Kam ngritur një zyrë të çështjeve civile. Dhe shumë gjëra që bëmë atje... a din, lufta nuk kishte mbaruar. Dua të them se ekzistonte ky plan i Vance⁵⁰, por ishte e vështirë t'i detyrosh ta zbatonin atë. Ne nuk kishim një... ne kishim një autoritet të Kapitullit VI, domethënë ishim atje duke punuar me bashkëpunimin e palëve, kështu që nuk mund t'i detyronim. Në Kosovë ne kishim mandatin e kapitullit VII deri në vitin 2008. OKB-ja e bëri, pra ne ishim qeveri. Ne mund t'ju themi se çfarë të bëni. Nuk mund t'i tregonim askujt se çfarë të bënte. Dhe kështu ne po përpiqeshim të... kështu që unë...

Erëmirë Krasniqi: Si ishte? Si ishte të ktheheshe në Zagreb në ato kushte?

Mark Baskin: Eh po, në fakt, unë jetoja në rajon, por shkoja në Zagreb. Ishte e vështirë sepse në vitin '92... sidomos në vitin '92 dhe '93 kishte ende shirit në dritare. Dua të them, pasojat e luftimeve ishin ende aty. Të gjithë miqtë e mi kishin kaluar vërtetë shumë ndryshime të mëdha. Lufta atje vërtetë e bëri këtë. Dhe...

Erëmirë Krasniqi: A kishte jetë shoqërore?

Mark Baskin: Po, po, deri në vitin '93, gjithçka po kthehej në normalitet. Ata po po e rindërtonin vendin dhe gjithë këto lloj gjërash. Tuđmani po rivendoste autoritetin e tij dhe të gjithë po bënin shumë para në qeveri, dhe gjëra të tilla. Dhe... por atje kishte një unitet, edhe sikur të ishte disi socialdemokrat dhe nuk të pëlqente shumë HDZ-ja.

Erëmirë Krasniqi: A ishte HDZ-ja në pushtet që nga atëherë?

Mark Baskin: HDZ-ja ishte në pushtet nga viti 1990 deri ne 2000.

Erëmirë Krasniqi: Okej.

Mark Baskin: Po, eh po.

Erëmirë Krasniqi: Kjo është një kohë e gjatë në pushtet.

⁵⁰ Një plan paqeje i negociuar nga ish-sekretari amerikan i shtetit, Cyrus Vance, i cili po shërbente si i dërguar i posaçëm i OKB-së, në nëntor 1991.

Mark Baskin: Eh po, ata i shkruanin rregullat dhe gjithçka. Sapo erdhën në pushtet, ata ridefinuan rregullat zgjedhore që ishin më të favorshme për ta. Dhe... por ishte e përzier, a din. Kishte... sepse... si në Osijek, aty ishin liberalët, mbulonin qytetin e Osijekut, kështu që kishte konflikte të tilla. Por gjendja shoqërore ishte në rregull. Dhe më duhet të them që ishte shumë interesante.

Erëmirë Krasniqi: Sa ishte ndryshe nga më parë? Dua të them, ishte krejtësisht ndryshe, por si e përjetuat këtë?

Mark Baskin: Për mua ishte më shumë një periudhë vazhdimësie. Mirë. Unë kam qenë aty nga viti '75-6 për një vit. '82, '83, '89, '90, tani është '93. Në thelb, nga viti '93 deri në '97 kam qenë në Kroaci, dhe shumë nga ajo kohë në Zagreb. Dhe kishte vazhdimësi. Ka miq që kam pasur që i kam parë akoma. Kishte shumë ndryshime që po ndodhnin. Njerëzit që ishin të jashtëm më parë tani ishin të brendshëm, akademikë, ishin aktivë politikisht. Në pozicionin tim zyrtar në vende të ndryshme që punoja me OKB-në, kisha një lloj autoriteti formal... jo autoritet, por kisha një vend formal. Kështu që jam marrë rreth dy vjet, jam marrë me çështjen e personave të zhdukur për shembull. Kështu që, unë kisha të gjitha këto marrëdhënie me atë.

Kur isha në Vukovar në vitet 1996-97, organizova zhvarrosjen e viktimave të krimeve të para të mëdha të luftës... Ovčara... 200 trupa u zhvarrosën. Dhe kështu po merresha me ato çështje. Dhe duke u marrë me një çështje të tillë. Unë kam të bëj me njerëz që ishin shumë të afërt me Tudmanin, njerëzit e tij në zyrën e tij dhe zëvendëskryeministrat dhe të gjithë këta. Kështu po bëja... kisha një pozitë që nuk e kisha pasur më parë. Më parë, unë isha një akademik i rëndomtë. A din, "Kush është ky djalë?" A din, unë prita nëntë muaj për të marrë lejen për të bërë disa intervista në vitin 1982. Tani, a din, isha duke punuar për OKB-në. Mund të shkoja në fshatra pa problem, sepse kështu bëra. Dhe kështu në këtë kuptim ishte disi mirë. Por kështu, a din, unë isha më i vjetër dhe isha në një pozicion tjetër, kështu që në shumë aspekte ishte kështu.

Por, ndryshe nga kushdo tjetër, ose ndryshe nga 99 përqind e njerëzve të tjerë që punojnë për OKB-në, unë kisha një histori në Kroaci, kisha një histori në Ballkan dhe kështu kisha shumë simpati për njerëzit në Kroaci, por shumë nga kolegët e mi nuk kishin (qeshë). Dhe, a din, sepse në Kroaci... në Kosovë, sot është pak e ngjashme, ju thjesht dëshironi që OKB-ja të largohet. Unë isha në darkë mbrëmë në një vend me dikë që është këshilltar politik i një prej liderëve, dhe OKB-ja po zhvillonte një lloj ngjarjeje atje, dhe e di që nuk pashë persona të OKB-së përreth, dhe u thashë përshëndetje në fillim, a din. Dhe ai thotë, "Shpresojmë që po festojmë largimin e tyre," tha ai, a din. Dhe në shumë aspekte, ky njeri ishte me... ai nuk ishte armiqësor apo asgjë. Domethënë, ai i njuh edhe disa prej tyre. Por ky është qëllimi.

Dhe... nga pikëpamja kroate, në vitin 1992, OKB-ja hyri për të marrë UNPA-të, Zonat e Mbrojtura të OKB-së dhe për t'i riintegruar ato në Kroaci. Kjo duhet të kishte marrë një vit apo më shumë. Dhe pastaj Serbët mund të kishin qëndruar, të largoheshin ose të bënin çfarë donin të bënin, dhe atëherë do të ishte e gjithë Kroacia. Në vend të kësaj, serbët filluan menjëherë ngritjen e këtij projekti të ndërtimit të një shteti, a din, Republika e Krahinës Serbe. Dhe ata gjetën të gjitha mënyrat për të pretenduar se po vazhdonin të ishin atje dhe po e bënin shumë të vështirë dhe kështu...

Dhe kështu kroatët me një fjalë filluan t'i thonë OKB-së, "Çfarë drejtin po bëni ju djema? Po mendoj, ju lutem". Dhe unë kam miq që janë të tillë. Kisha edhe miq kudo. Dua të them, isha mik me Milorad

Pupovac, të cilin e njoha, i cili tani është politikani kryesor serb në Kroaci. Ai kishte një lloj tjetër... ai po përpjeqej t'i bashkonte të gjithë. Dhe kështu e gjitha kjo po ndodhë.

Dhe kështu, në njëfarë kuptimi, deri kur u bë Dayton⁵¹, duke qenë në Zagreb, apo duke qenë në... Unë po e mendoj këtë tani... ishte sikur të isha në Jugosllavi më parë. Kishte... ishte si një lëvizje rreth përpjekjes për të ndërtuar diçka. Nuk ishte normale. Nuk ishte diçka që ishte e ndotur nga lloji i kapitalizmit individualist, a din, sepse kishte një qëllim më të gjerë publik që ishte domethënës. Pra, kjo ishte. Dhe kështu kjo ishte.

Erëmirë Krasniqi: Çfarë ndodhi me jetën tuaj personale? A jeni martuar ndërkohë?

Mark Baskin: Po, u martova.

Erëmirë Krasniqi: Pastaj do të kthehemi në Kosovë.

Mark Baskin: Unë... ishte një grua që e kisha takuar përpara se të shkoja të punoja për OKB-në, me të cilën u martova në vitin 1995. Në fakt, u ktheva dhe... u ktheva, dhe u martuam dhe bëmë fëmijën tonë të parë pothuajse në të njëjtën kohë kur u martuam... pasi u martuam zyrtarisht. Dhe kjo ishte pak para... disa ditë përpara Operacionit “Flash”, kur kroatët morën përsëri Sektorin Perëndimor.

Erëmirë Krasniqi: *Oluja*?⁵²

Mark Baskin: Jo, para *Oluja*. *Oluja* ishte në gusht. Kjo ishte në maj.

Erëmirë Krasniqi: Dhe si quhej fillimisht kjo? “Flash”.

Mark Baskin: *Bljesak* në Kroatisht.

Erëmirë Krasniqi: Okej.

Mark Baskin: *Bljesak*, mendoj. Dhe unë isha në... Suzanna sapo kishte... Rebecca sapo kishte lindur, Rebecca e cila kaloi një verë këtu disa vjet më parë (qeshë) në programin tonë veror [në UAK]. Dhe mbaj mend që mora në telefon Mark Thompson-in duke thënë, “Çfarë po ndodh?” Ai tha... po shkante... ishte interesante. Dhe kështu... dhe më pas ata u kthyen, dhe në prag të Operacionit “Oluja”, më paralajmëruan... po udhëheqja... po drejtoja, në atë kohë, Njësinë e Analizës dhe Vlerësimit të Misionit dhe një nga gratë që punonte me ne ishte Tone Bringa, e cila ishte një antropologe nga Norvegjia, e cila kishte shkruar një libër të mrekullueshëm për Bosnjën. Dhe ajo ishte e fejuar... nuk e di nëse ishte fejuar ende... me ambasadorin amerikan, Peter Galbraith, në atë kohë. Dhe Tone më tha rreth dy javë para Operacionit “Flash”, ajo thotë, “Ndoshta Suzanna duhet të shkojë në shtëpi” (qeshë).

Erëmirë Krasniqi: Gruaja juaj?

Mark Baskin: Po, dhe Rebecca. Sepse, kupton, kush e dinte se çfarë do të ndodhte?

⁵¹ Marrëveshja e Dayton-it që i dha fund Luftës së Bosnjës në fund të vitit 1995.

⁵² *Operacija Oluja* - Operacioni Stuhija, ishte beteja e fundit e madhe gjatë luftës kroate për pavarësi.

Erëmirë Krasniqi: Sepse ato erdhën me ju.

Mark Baskin: Po, ato erdhën. Po, dhe kjo i kufizoi pak zgjedhjet e mia si person i OKB-së, sepse ishim në Zagreb dhe më pas pata një mundësi të shkoja në Beograd, por nuk doja të shkoja në Beograd. Kështu që, unë shkova të punoja për Misionin në Sllavoninë Lindore dhe u transferuam në Osijek për një vit. Dhe do të kisha dashur të kisha shkuar në Bosnje në atë kohë, por gjërat ishin vërtetë të vështira vetëm nga pikëpamja e jetës së përditshme. Kështu që, prita rreth një vit apo më shumë, dhe më pas erdhi një mundësi dhe zbrita atje.

Më duhej... zbrita për të vizituar, a din, për të takuar njerëz... ata ishin miqtë e mi që i kisha njohur më parë nga misioni. Dhe shkova në dyqan për t'u siguruar që kishte Pampersa (qeshë) në dyqan. Ky ishte një moment kyç që duhej të kishim: A janë të disponueshëm Pampersat? Sepse kur ato nuk ishin të disponueshme në Zagreb, ne thjeshtë shkonim në Metro⁵³ në Graz [Austri] dhe i merrnim. Ishte e thjeshtë. Por nga Sarajeva, nuk ishte një rrugë dy orëshe. Ishte shumë më e gjatë. Kështu që, ne u transferuam në Sarajevë për një dy vjet.

[Rrëfimi vazhdon në pjesën e katërt]

Pjesa e Katërt

[Kjo pjesë e intervistës është realizuar më 29 shkurt, 2020]

Mark Baskin: Po, pra, po, ishte ndryshe në vende të ndryshme. Dua të them, kur unë jetoja në Petrinjë, për shembull... kjo ishte në të ashtuquajturën Republika e Krahinës Serbe... dhe njerëzit atje ishin... ata ishin 95 për qind serbë. Kishin mbetur disa kroatë në fshatrat e rajonit dhe unë shkoja t'i vizitoja. Dhe ata jetuan disi jo... ata jetuan mjaft mjerueshëm. Por edhe serbët atje jetuan mjaft keq. Nuk kishte asnjë lloj jete publike. Dhe, sa herë që shkoja në Zagreb, herë pas here pyesja fqinjët, "Çfarë doni? Keni nevojë për ndonjë gjë?" Gjë që i tronditi. A din, unë bija gjëra në të zezën, dhe ata gjithmonë kërkonin Vegeta (qeshë)... ishte gjëja që u mungonte gjithmonë, kështu që unë bija në të zezën sasi të mëdha të Vegetës dhe lloje të ndryshme të ketchupit për pizza dhe gjëra të tilla, sepse njerëzit ishin duke jetuar me ato lloj gjërash. Dhe pra ishte e vështirë gjatë luftës. Por më pas shkova në Zagreb. Dhe kështu, në Zagreb, unë vetëm po jetoja në Zagreb. Dhe kishte... të gjithë ishin normalë shumicën e kohës.

Erëmirë Krasniqi: A mund të na tregoni ndoshta më shumë se si njerëzit filluan të ndaheshin, si u bë më e qartë, më e mprehtë ndarja ndërmjet etnive? A mundeni...

Mark Baskin: Oh, ishte thjeshtë... dua të them, lufta e përcaktoi etninë si të vetmen lloj gjëje [që kishte rëndësi]. Dhe të gjithë e dinin se cilët ishin kroatët në këtë sektor. Sepse, a din, këto fshatra të vogla ku të gjithë i njihnin të gjithë. Të gjithë e dinin se kush ishin. 30 vjet, 20 vjet më parë, të gjithë mirëkuptoheshin pak a shumë, dhe të gjithë e dinin se kush ishin. Dhe, nëse ishit kroat në sektorin... atë që ne e quanim sektori në Republikën e Krahinës Serbe, atëherë ishte shumë e vështirë për ty. Dhe

⁵³ Një dyqan gjerman me shumicë.

një nga gjërat që bëra si oficer i OKB-së ishte që do të merrnim kërkesa nga Kryqi i Kuq Kroat se filani është i sëmurë dhe ka nevojë për trajtim mjekësor që mund të ofrohet vetëm në Kroaci.

Kështu që unë... unë bëra disa nga këto, dhe më pas një nga njerëzit e mi që punonte me mua, i bëri ato, sepse unë i bëja disa evakuime mjekësore, dhe kishte shumë gjëra burokratike dhe miratime që duheshin nënshkruar dhe gjitha këto. Dhe pastaj ti shkoje në shtëpinë e tyre dhe i nxirrje jashtë. Dhe, a din, së pari duhet ta bësh një vizitë, dhe, a din, do të ishte... Më kujtohet se shkova në një shtëpi ku dritaret ndoshta nuk ishin hapur për 20 vjet. Dhe ka një {i mban duart afër fytyrës}. Dhe kështu ata na hapën dritaret, që të kishte ajër të pastër. Dhe ata kërkuan falje për *propuh*⁵⁴ siç themi ne në Zagreb. Si i thonë këtu?

Erëmirë Krasniqi: Promajë.

Mark Baskin: Por në kroatisht, është *propuh* (qeshë). Ata kërkuan falje për *popuh*. Dhe përkthyesi im tha, “Oh, jo, jo, jo, ne duam *propuh*” (qeshë). E mbaj mend vërtetë qartë këtë. Dhe kështu, a din, ata jetuan shumë keq dhe ata... njerëzit e zakonshëm jetuan keq. Ishte ky dominim. Është një film “Cold Mountain”, për të cilin mendoj se shkuan një ose dy çmime Oscar për aktrim.

Chester Eng: Po, ishte në vitin 2003.

Mark Baskin: Ky është një film për Jugun [Amerikën Jugore] dhe Luftën Civile [Amerikane] gjatë Luftës Civile që thjesht tregon mënyrën në të cilën këto lloj grupesh lokale kontrollonin këto qytete, i terrorizuan ato dhe ishte disi e tillë. Kështu që, a din, ku gjërat me të vërtetë... vendi ku isha, Goražde, në 1994. Dhe është një lloj rasti i njohur. Ka një roman të mrekullueshëm grafik, ose libër grafik, i shkruar për Goražde nga Sacco. Nuk e mbaj mend emrin e tij. Dhe kjo ndodhi menjëherë pas rrethimit për rreth një muaj apo më shumë, dhe më pas në të cilin serbët po përpiqeshin të... sepse Goražde është pikërisht në lumin Drina... dhe serbët donin... interesat e tyre strategjike ishin ta bënin atë një vend serb dhe boshnjakët po rezistonin, efektivisht pak a shumë.

Dhe, në fund, pati një marrëveshje që u ndërpre, dhe më pas hyra me një grup prej... nuk e di... ky ishte Sérgio, a din, de Mello⁵⁵ dhe gjenerali Soubirou, i cili ishte gjenerali francez që ishte në krye të Sektorit të Sarajevës, dhe një grup të tërë oficerësh të çështjeve civile dhe djem të tjerë ushtarakë, policë e të tjerë. Dhe ne hymë dhe unë përfundova duke qëndruar atje për një muaj duke udhëhequr negociatat. Dhe është një marrëveshje shumë e ndërlikuar që, nuk e di, do të më duheshin dhjetë minuta për ta përshkruar, kështu që nuk do ta bëj.

Por ju po pyesnit për njerëzit, dhe njerëzit kishin jetuar për... a din, ata kishin qenë përreth dy muaj në bodrume dhe kështu. Dhe ju e dini se kur hymë, papritur ata ishin të lirë dhe njerëzit po largoheshin. Dhe është si të shohësh disa fotografi pas Luftës së Dytë Botërore. Ata ishin... më kujtohet shumë qartë, në mes të disa rrënojave, sepse kishte pasur bombardime dhe gjëra të tilla, ishte një grua që vishej bukur (qeshë), a din, me buzëkuq dhe gjithçka. Dhe ti pyet veten se nga e ka marrë apo nga e ka ruajtur dhe vetëm duke ecur nëpër këto gjëra. Dhe pastaj në vitrina dyqanesh, në dyqane, familjet jetonin, kishin dhi dhe sende. Dua të them, ishte vërtetë e mahnitshme në fillim, situata atje.

⁵⁴ Kroatisht: *propuh*, do të thotë rrymë ajri. Një term për një rrymë ajri të ftohtë që futet nga një dritare ose derë e hapur.

⁵⁵ Diplomati brazilian i OKB-së, i cili në atë kohë ishte drejtor i çështjeve politike për UNPROFOR-in.

Dhe kështu, a din, dhe pastaj gjëja për luftën është se, më vonë pas luftës, është sikur të takoni njerëz nga këto vende. Kështu që takova refugjatë serbë nga Goražde, a din, njerëz që u rritën në Serbi, në Užice, dikë që ishte nga Goražde, kështu që ju e dini se... është sikur të gjithë të prekeshin nga kjo tmerrësisht. Njerëzit e zakonshëm vuajtën jashtëzakonisht shumë, dhe kështu ata vareshin nga udhëheqësit dhe gjëra. Kështu që...

Erëmirë Krasniqi: Sa gjatë qëndruat?

Mark Baskin: Në Goražde, isha aty për rreth dy apo tre muaj.

Erëmirë Krasniqi: Jo, tërësisht, misioni juaj në atë rajon.

Mark Baskin: Në...

Erëmirë Krasniqi: A...

Mark Baskin: Unë punova për OKB-në që nga prilli...

Erëmirë Krasniqi: Po, po, po shkonit sa andej dhe sa kënde, apo?

Mark Baskin: Jo, jo, për mua selia ishte gjithmonë diku: Zagreb, Vukovar, Sarajevë dhe Prishtinë. Këto ishin lloji i shtabit të misionit. Këto ishin katër misionet për të cilat kam punuar, por kam kaluar kohë në... Unë isha në FYROM⁵⁶, siç e quanim ne, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, emri zyrtar në atë kohë. Unë kam qenë oficer i tavolinës së FYROM-it, kështu që do të zbrisja në... më kujtohet në vitin '94 kur ishte një kërcënim për një konflikt, kështu që shkova atje. Kishim një zyrë, kishim një mision atje dhe mbaj mend që u takuam me Arbën Xhaferin⁵⁷. Ishte një Xhaferi tjetër që udhëhoqi njërin nga partitë e tjera, dhe më pas u takova me burra nga partitë maqedonase, dhe po përpiqeshim të kuptonim... kjo ishte kur ata po përpiqeshin të themelonin Universitetin e Tetovës, i cili shihej si një gjë rrezikshmëri radikale dhe gjitha këto. Dhe kështu... dhe më kujtohet shoferët e taksive që më thanë, "Do të ketë luftë (qeshë). Do të ketë luftë." Dhe kështu... dhe sigurisht, pati një luftë në Maqedoni.

Kështu që, e kalova kohën duke shkuar në shumë vende të ndryshme. Dhe kështu, me një fjalë kam qenë i vendosur në Zagreb nga viti '93 deri në '96. Më pas kam qenë në Vukovar nga '96 deri në '97. Më pas kam qenë në Sarajevë nga viti '97 deri në '99. Dhe kam qenë në Prizren nga viti '99 deri në vitin 2000, deri në fund të vitit 2000.

Erëmirë Krasniqi: Oh, uou! Kur keni ardhur në Prizren?

Mark Baskin: Në qershor të '99-ës.

⁵⁶ Former Yugoslav Republic of Macedonia - Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë.

⁵⁷ Arbën Xhaferi (1948-2012) ishte një politikan shqiptar nga Maqedonia e Veriut. Ai lindi në qytetin e Tetovës, atëherë pjesë e Jugosllavisë. Ai ishte kryetar i Partisë Demokratike Shqiptare (PDSH) dhe ishte një avokat i të drejtave për shqiptarët në Maqedoninë e Veriut.

Erëmirë Krasniqi: Ky është bash fillimi.

Mark Baskin: Po, eh po, përmenda se Sérgio Vieira de Mello, dhe ai është zyrtari i OKB-së që u vra në Irak në 2003. Dhe Sergio kishte qenë kreu i çështjeve civile në kohët e hershme, dhe unë kam punuar shumë ngushtë me të në Gorazde. Unë isha, ai ishte atje për një javë, dhe unë isha mbajtësi i tij i shënimeve dhe gjëra të tjera. Dhe pastaj isha në telefon me të çdo ditë ndërsa po përpiqeshim t'i çonim përpara këto negociata. Dhe kështu... dhe ai e dinte që unë e kisha... mendoj se ju dërgova artikullin... një artikull që kam botuar, "*Crisis in Kosovo*" [Krizë në Kosovë]. Dhe unë... ai e dinte që e njihja Kosovën. Dhe kështu kur erdhi [në Kosovë], ai u emërua Përfaqësues Special i Përkohshëm i Sekretarit të Përgjithshëm. Ai donte të krijonte një ekip, dhe ishte një ekip i mrekullueshëm dhe ai donte që unë të isha në ekip. Dhe pra shefi im në Sarajevë nuk donte që unë të vija.

Dhe kështu... kjo është e vërtetë: Ajo më tha... Shefi i kabinetit të Kofi Annan e thirri atë në darkë dhe i tha, "Duhet ta lësh Baskin të shkojë". Kështu që, të nesërmen... unë shkova të nesërmen dhe pashë Sérgion dhe disa të tjerë. Dhe pastaj ai më dërgoi në Prizren, dhe disa nga njerëzit në atë mision, njeriu që organizoi udhëtimin tim në Prizren dhe më vonë punoi për Kouchner⁵⁸ si këshilltar politik gjatë gjithë kohës sime atje ishte një diplomat gjerman i quajtur Axel Dittmann i cili... Axel ishte së fundmi ambasadori në Serbi. Ai u largua rreth një vit më parë dhe tani është kthyer në Berlin. Dhe takova Axelin më vonë. Pra, disa nga njerëzit që erdhën përmes misionit ishin vërtetë njerëz shumë të talentuar. Axel ishte një oficer i shkëlqyeshëm politik.

Erëmirë Krasniqi: Si ishte Prizreni atëherë? Mund të na tregoni për ato ditët e para kur u vendosët?

Mark Baskin: Po, eh po, kishte raporte se Prizreni ishte shkatërruar, ose kishte pasur shumë bombardime atje. Kishte pasur në vende si Zhuri dhe Krusha e Madhe dhe Krusha e Vogël. Por bash në Prizren, në të vërtetë nuk kishte aq shumë. Gjermanët [forcat paqeruajtëse] ishin tashmë atje. Ishin të gjithë këta gazetarë që i njihja nga kohët e mëhershme, gazetarë amerikanë. Roy Gutman, i cili ishte ai që zbuloi kampet në Bosnje në vitin 1992. Roy ishte atje. Një njeri tjetër që... ata bënë një film për raportimin e tij në Afganistan, Jonathan Landay. Ai ishte atje dhe unë e njoh Jonathanin. Ai është një mik i mirë i imi.

Dhe ishte vërtetë anarkike në atë kohë. Dhe njerëzit po ktheheshin, dhe OKB-ja ose... mendoj se ishte OKB-ja që kishte njoftuar për këtë, por nuk e di... ne ishim përpjekur të krijojmë një situatë ku refugjatët nuk do të ktheheshin për një ose dy muaj. Ndërsa ne i rregullonim gjërat, e din, ndërkohë që ne u vendosëm. Ata, natyrisht, u kthyen menjëherë. Pra, ndërsa unë po hyja, ne i shihnim këto kolona të, ma merr mendja, të serbëve që po largoheshin. Kishte shqiptarë që vinin nga Kukësi dhe nga Shkupi. Dhe... dhe ditët e para ishin vërtetë shumë të vështira.

Më sollën disa njerëz nga OSBE-ja, dhe ne qëndruam... kështu që ata na vurën në kontakt dhe, e dini, na organizuan disa takime. Dhe, a din, kështu që unë përfundova duke qëndruar atje për rreth një muaj me një familje, djalin e së cilës... ti ndoshta e njeh [i drejtohet Erëmirës] djalin e tij. Shporta. Ares Shporta. Unë qëndrova në shtëpinë e Ares Shportës muajin e parë që isha atje. Dhe nëna e tij, të cilën e

⁵⁸ Bernard Kouchner (1939-) është një mjek dhe politikan, themeluesi i Médecins Sans Frontières. Përderisa ishte ministër i Shëndetësisë i Francës, Kouchner kishte bërë një deklaratë duke pranuar se studentët shqiptarë në Kosovë ishin helmuar. Pas luftës, në vitin 1999, ai u emërua Përfaqësues Special i OKB-së në Kosovë.

pashë ditë më parë, ajo tani punon në Sudan ose Somali për OKB-në. Dhe kështu është disi e mahnitshme, a din.

Dhe pastaj, a din, dhe shumë shpejt, sepse disa nga këta njerëz të OSBE-së e dinin, dhe njerëzit e dinin që ne ishim atje, kështu që takova disa figura kyçe në qytet. Njerëzit e kishës ortodokse ishin ende atje dhe më kujtohet se kisha takime me ta. Dhe gjermanët që po vendoseshin. Dhe aty ishte edhe KFOR-i holandez. Këto janë dy kontigjentet që mbaj mend. Aty ishin edhe Austriakët. Unë mendoj Zvicëranë. Ti gjithmonë mund të ndihesh i sigurtë kur ke ushtrinë Zvicërane që të mbron (qeshë). A din, ata bënë shumë punë të shkëlqyeshme për çështjet civile, mendoj në fakt. Dhe kështu...

Erëmirë Krasniqi: Ju përmendet OSBE-në sepse ata e njihnin më mirë vendin?

Mark Baskin: Ata veçse ishin aty.

Erëmirë Krasniqi: Sepse ata ishin aty, po.

Mark Baskin: Dhe ai që më solli, do të doja të ishte shef i zyrës. Dua të them, ai ishte një djalë i mrekullueshëm. Ishte një polic britanik që më solli. Por, e din, ishte mirë. Por, e din, kur ai hyri, e din, ne po ecim në rrugë me një djalë... sepse unë kisha punuar me policë. Misioni ku unë isha në Bosnje ishte një mision policie. Ajo që bëme është se kemi ndihmuar në këshillim dhe kemi ndihmuar në zhvillimin e sistemeve të trajnimit dhe të gjitha këto për policinë. Dhe kështu punova ngushtë me policinë britanike, kështu që e kaloja mirë me këta djem.

Dhe ndërsa po ecim, ai tregon me gisht një grua të re dhe thotë, “Duhet ta punësosh. Ajo është e mrekullueshme”. Kështu që e punësova dhe ajo u bë asistentja ime. Dhe tani ajo ka një pozitë mjaft të lartë brenda EUSR-së⁵⁹. Kështu që, më duhet të them, shumë nga njerëzit që i kam punësuar në vitin 1999, të gjithë... disa njerëz kanë qëndruar brenda komunitetit ndërkombëtar. Të tjerët kanë... ka një djalë me të cilin sapo u takova... unë hyra në “Soma” rreth një muaj më parë dhe ai më thotë, “Mark, nuk të kujtohet, apo jo?” Ai thotë, “Unë punoja si IT për ju”. Dhe unë them, “Oh, sa më bëhet qejfi që të shoh”. Dhe pastaj ai thotë... Unë i thashë, “Atëherë, çfarë po bën tani?” Ai thotë, “Epo, unë jam pronar i Gjirafës” (qeshë). Dhe më pas ai më tregoi historinë e tij, është një histori e mahnitshme, se si ai punoi për OKB-në për disa vite, ai kishte një mundësi ose të qëndronte në OKB dhe të shkonte në Afrikë, mendoj. Ose ai mund të kishte mbaruar një diplomë në SHBA, dhe ai zgjodhi rrugën e fundit. Dhe kjo e çoi atë... oh, kjo është e mahnitshme se çfarë ndodhë kështu që... dhe ka të gjithë këta të rinjsh të zgjuar, dhe unë u mahnita me të vërtetë, me të vërtetë i impresionuar me sa super ishin ata.

Dhe, a din, në të njëjtën kohë... kështu që unë shkova atje për... kështu që ajo që bëra ishte që shkova atje për disa ditë, rreth katër ose pesë ditë, dhe shkova dhe i raportova shtabit situatën, dhe më pas ata thanë, “Eh po, ku dëshiron të shkosh?” Dhe doja të isha administratori rajonal, por ato ishin poste politike që zotëronin qeveritë dhe nuk munda. Atëherë ata thanë, “Mund të bëhesh deputet ku të duash”, dhe unë kisha një zgjedhje të shkoja në Mitrovicë apo Prizren. Dhe zgjedha Prizrenin sepse ishte shumë bukur (qeshë). Dhe...

Erëmirë Krasniqi: Mund ta përshkruash se çfarë do të thoshte të bëheshe deputet?

⁵⁹ *European Union Special Representative* - Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian.

Mark Baskin: Kjo do të thoshte... atëherë unë isha disi personi i dytë më i... isha zyrtari i dytë më i lartë i OKB-së në rajon. Dhe në rajonin e Prizrenit kemi mbuluar Prizrenin, Suharekën, Dragashin, Rahovecin. Dhe pastaj erdhën disa nga Malisheva. Malisheva nuk ishte ende komunë, dhe më kishin thënë se kishin qenë në... në vitet e '80-ta, ishin gati të krijonin një komunë kur serbët në njëfarë mënyre erdhën dhe e morën dhe ndryshuan gjithçka. Dhe a do t'i mbështesim ata në këtë? Dhe kështu unë pastaj shkova te njerëzit me ndikim... njerëzit që i morëm për të qenë me ndikim në Rahovec, Prizren dhe Suharekë sepse do t'u kishte marrë tokë të gjithë atyre, dhe thashë, "Çfarë mendoni? Duhet ne që...? E ke bezdi?" Dhe ata thanë, "Sigurisht që jo", kështu që ne e krijuam Malishevën, dhe kështu... ose më pas u krijua.

Dhe kështu përgjegjësitë e mia atje. Dhe pastaj isha atje vetëm për muajin e parë para se të vinte Leonardi, para se të vinte administratori rajonal. Ai ishte Suedez. Dhe në këtë periudhë të hershme, unë isha i vetmi i zhvendosur nga OKB-ja, shumë herët. Ishte një person i UNHCR-së⁶⁰ i cili ishte atje për një kohë të shkurtër, dhe më pas ai u largua dhe hyri dikush tjetër. Dhe OSBE-ja ishte atje, por ata kishin vetëm disa njerëz në atë kohë sepse të gjithë ishin evakuar gjatë bombardimeve.

Dhe në atë kohë, çdo ditë në Prizren, nga katër deri në dhjetë shtëpi po digjeshin... dhe në Kala, a din, zona mbrapa liqenit, a din... zonat ku Serbët kishin jetuar më parë. Dhe kreu i ushtrisë vjen dhe më thotë, "Eh po, kjo është puna juaj. Po mendoj, këta janë civilë, që po djegin shtëpi. Nuk ka të bëjë me ushtrinë". Dhe unë i thashë, "Eh po, unë jam i vetmi që jam këtu". Dhe ata më thanë, "Eh po, kur do ta sjellësh policinë tënde këtu?" (qeshë). Dhe më është dashur ca kohë të... sepse në këto misione, ti nuk... ne nuk kemi... nuk është sikur ushtria Amerikane, a din, ti mund thjeshtë të dërgosh, mund të shkosh ne Fort Bragg⁶¹ apo diçka dhe mund të dërgosh një mijë apo dy mijë persona. Ti nuk mund thjeshtë ta bësh këtë. Ne nuk...

Erëmirë Krasniqi: Pra ti nuk ke pasur asnjë polic me ty?

Mark Baskin: Ne nuk kemi pasur. I kisha nja dy policë nga Bosnja, por misioni... por mandati... dhe kjo futet në çështje vërtetë të komplikuar të administratës publike në njëfarë mënyre: Mandati ishte tërësisht ndryshe. Mandati jonë në Kosovë, në UNMIK, ishte se ne ishim qeveria. Mandati në Bosnje ishte se ne nuk ishim qeveria. Ne këshillonim, kështu që policët nuk ishin të trajnuar të bënin atë. Ata nuk kishin... kështu që, pastaj në fund, unë kisha vetëm nja dy policë. Më kujtohet se kisha një indian, një lloj komandanti i lartë i policisë indiane, i cili, a din... nuk mund të bënte shumë. Kështu që, ne provuam të bënim diçka. E drejtë, ne provuam të bënim diçka përdërisa shtëpitë akoma po digjeshin, dhe...

Erëmirë Krasniqi: Kur u bë situata tamam e qëndrueshme? A kishit edhe orë policore, apo jo?

Mark Baskin: Ne kishim orë policore në Prizren, po. Mendoj se e kemi pasur orën policore pak a shumë përgjatë gjithë kohës sa isha atje. Un nuk jam... po mendoj, ky nuk është një detaj që mund ta kërkoj dhe ta gjej, por e kishim për një kohë të gjatë. Dhe kur filluam nga gushti-shtatori, ne mund të bënim gjërat pak më mirë. Dhe për shkak se gjermanët, a din, për t'i dalë në mbrojtje, ishte ndjenja ime, ti ke 6,000 trupa këtu, ndoshta mund të bëni diçka. "Oh, ne kemi gjëra tjera për të bërë". Dhe ata kishin, në fakt, gjëra tjera për të bërë. Ka shume gjëra që ata duhet të bënin.

⁶⁰ *United Nations High Commissioner for Refugees* - Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët

⁶¹ Një bazë e madhe e ushtrisë amerikane në Karolinën Veriore në juglindje të Shteteve të Bashkuara.

Dhe ata gjithashtu po dilnin dhe bënin punët e çështjeve civile në terren, u siguronin ushqim njerëzve, bënin atë lloj gjëje, dhe më pas ata po vendosnin dhe ndërtonin kampin e tyre, të gjitha gjërat që duhet të bësh nëse ti do të kesh një operacion efektiv. Pra, nuk është se ata thjesht ishin ulur dhe talleshin me ne. Dua të them, ata ishin... a din, ata po bënin gjërat e tyre. Dhe kështu ishte thjeshtë një kohë e vështirë.

Dhe shumë herët, ne punuam ngushtë me ushtrinë, OSBE-në, UNHCR-në. Ne kishim takime çdo ditë. A din, çfarë po ndodhë? Dhe aty kishte... ishte një situatë e vështirë. Dhe kështu, rreth tre javë pas fillimit, gjenerali gjerman thotë... kjo është pikërisht rret kohës kur erdhi Leonardi, pikërisht para se të vinte Leonardi... gjenerali gjerman më thotë, "I kam 75 njerëz në burg," sepse... policia e tij ushtarake punonin si polici, por ata në fakt nuk janë policë. Dhe ai thotë,... dhe këta nuk janë... "Kjo është diçka serioze". Po mendoj, "Ata janë arrestuar për gjëra serioze. Çfarë do të bësh me ta?" Sepse ajo me të vërtetë ishte një punë civile. Kështu që, i pyeta shoqërinë time në seli, avokatë, çfarë... "Çfarë duhet të bëjmë?" Ata po krijonin një gjyqësor emergjent në Prishtinë, dhe ata thanë, "Pse nuk krijoni një gjyqësor emergjent?"

Dhe kështu ai, një avokat i OKB-së, më tha se çfarë duhej të bëja në aspektin e gjërave dhe, me ndihmësit e mi, thirrëm të gjithë avokatët dhe të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët nga Prizreni. U takuam me ta. Dhe pastaj punuam me OSBE-në. Ata plotësuan një aplikacion. OSBE-ja, mendoj, e verifikoi. Unë gjithashtu duhej të, a din, {levizë duart sikur po nënshkruan një dokument} disa nga ne. Kjo është sikur bursat që ke marrë. Ne kryem procesin e verifikimit. Dhe pastaj ne patëm intervista dhe pastaj krijuam këtë gjyqsorin emergjent. Dhe, a din, kishte ca probleme me të, për të cilat nuk do të flas, por ishte një... unë gjithashtu e kam realizuar atë që besoj se është martesën e parë në Kosovën e pasluftës.

Erëmirë Krasniqi: Me të vërtetë?

Mark Baskin: Po, e bëra. Kjo është...

Erëmirë Krasniqi: Për kë?

Mark Baskin: Atëherë kjo ishte çfarë ndodhi.

Erëmirë Krasniqi: A ke qenë i pajisur me një pushtet të tillë?

Mark Baskin: Eh po, ne kishim një... Edita Tahiri, që atëherë ishte pjesë e presidencës së LDK-së dhe shumë me ndikim, ajo solli... ajo deshi të na prezantonte me Eqrem Kryeziun, i cili ishte kreu i LDK-së.

Erëmirë Krasniqi: Eqrem Kryeziu?

Mark Baskin: Po, Eqrem Kryeziu, i cili ishte kreu i LDK-së në Prizren. Kështu që ne u takum, dhe Eqremi ishte shumë i mirë. Kishim një takim të mirë. Edita ishte shumë e ashpër në këtë takim, duke thënë, a din, "Ju njerëz jeni qeveria. Ju duhet të vendosni rend. Ju duhet të siguroheni që njerëzit tanë janë të mbrojtur," blah, blah, blah, gjithë këto lloj gjërash. Dhe ishte shumë... ajo ishte shumë e ashpër.

Dhe pastaj, a din, në fund të takimit, ajo pastaj më merr me një anë dhe thotë... dhe unë nuk e njihja atë, edhe pse kisha dëgjuar për të... dhe pastaj ajo thotë, “Mark,” ajo thotë, “mbesa ime është e fejuar, për t’u martuar, dhe nuk ka,” (qeshë) ... “dhe nuk ka...” “nuk ka norma të vendosura për asgjë të tillë. Dhe kështu... dhe ju djema jeni qeveria, kështu që a do e realizoje martesën?” Kështu që, përsëri, bisedova me Prishtinën vetëm për t’u siguruar që gjithçka ishte në rregull, dhe doli se kjo ishte... ishte interesante.

Kështu që, ne duhej të krijojmë të gjitha këto dokumente. Ne duhej të krijojmë një, a din, çertifikatë martesë. Kështu që ata thanë se duhet ta bësh këtë, këtë dhe këtë sepse, a din, serbët morën shumë nga dokumentacioni dhe ata nuk do ta... ne gjithsesi nuk do të vazhdonim atë që kishin bërë ata. Kështu që, ne krijuam këtë dokument, dhe pastaj filluam... pra ne ishim të parët në Prizren. Ne ishim disi pionierë në krijimin e të gjitha këtyre dokumenteve të reja, duke përfshirë çertifikatat e lindjes dhe të gjitha këto lloj gjërash.

Dhe kështu më pas erdhi deri te ceremonia. Dhe kështu një nga miqtë e mi që fatkeqësisht sapo u nda nga jeta, Bashkimi, Bashkim Nevzati, sapo vdiq pak muaj më parë dhe ishte avokat. Dhe Bashkimi... unë iu drejtova Bashkimit dhe i thashë, “Dëgjo, a mund të më ndihmosh? Eja lart”. Kështu ai erdhi, dhe ne shikuam ligjin, kodin jugosllav të martesës dhe më pas hartuam diçka që bazohej në atë, por për rrethanat e reja. Dhe pastaj e bëmë. Dhe unë isha vërtetë i entuziazmuar. Mendova se do të isha në gjendje të mësoja shqip në atë kohë. Kështu i shkruam të gjitha në shqip, dhe kështu bëmë këtë shërbim martesë. Dhe, a din, Edita ishte aty, dhe unë, e të tjera, e të tjera, e të tjera.

Dhe kjo ishte në selinë tonë, e cila ishte në Bankkos-in e vjetër, pikërisht buzë lumit. Dhe ne nuk e kontrolluam të gjithë ndërtesën. Në fakt, mendoj, [Agron Shporta](#)⁶², ai kishte një zyre në atë ndërtesë që nga moti. Dhe kështu është kjo muzikë me tuba dhe, papritmas, ndërsa po drejtoj dasmën dhe po lexoj një fjalim që kam pasur në shqip, dëgjoj këngën në muzikën me tuba “*Listen to Your Heart*” [Dëgjo zemrën tënde] nga Roxette (qeshë). Më trembi plotësisht. Kështu që tani, sa herë që mendoj për... këngëtarja kryesore e Roxette sapo vdiq, më bëri të mendoj për dasmën në Prizren (qeshë).

Erëmirë Krasniqi: Pse ishte e rëndësishme të ishte legale? Dua të them, ne thjesht po pyesim këtë pasi është një pyetje shumë kulturore për ne. Nuk është se martohemi gjithmonë legalisht (qeshë). E bëjmë edhe ne...

Mark Baskin: Po, ligji i zakonshëm.

Erëmirë Krasniqi: Po.

Mark Baskin: Eh po, nuk e di. Dua të them, duhet ta pyesësh...

Erëmirë Krasniqi: Kur ndodhi kjo?

Mark Baskin: Urdhëro?

Erëmirë Krasniqi: Kur ndodhi kjo?

⁶² Poet, gazetar, përkthyes, dhe interpretues nga Prizreni.

Mark Baskin: Ishte...

Erëmirë Krasniqi: Pikërisht pas?

Mark Baskin: Duhet të jetë fillimi i korrikut.

Erëmirë Krasniqi: Oh Zot.

Mark Baskin: Fillimi apo mesi i korrikut të vitit '99.

Erëmirë Krasniqi: Okej.

Mark Baskin: Diçka ashtu. Nuk ishte shumë më vonë. Dhe, a din, mendoj... a din, mendoj se ka pasur një kuptim... erdhi nga LDK-ja, por gjithashtu erdhi nga kuptimi që, a din, ne kemi këtë qeveri të re, të cilët po punonin ngushtë me OKB-në, dhe ne duhet të vendosim diçka që është e jona, që nuk është... që nuk vjen nga një sistem i mëhershëm që ishte diskriminues dhe gjitha këto lloj gjërash, dhe kështu...

Erëmirë Krasniqi: A realizuat më shumë martesë pas asaj here?

Mark Baskin: Jo, jo, ajo është e vetmja që bëmë. Ndonëse e bëra më vonë, në shtator të vitit 2000, si, në prag të zgjedhjeve të para, ku ishin disa zgjedhje komunale në tetor të vitit 2000, Bernard Kouchner, qëllimi i tij ishte të vizitonte çdo komunë. Unë në atë kohë isha administrator komunal në Prizren, kështu që punoja me njerëzit e tij. Dhe kështu organizuam një vizitë të tërë ku ai u takua me këshillin bashkiak, bordin administrativ. Ai kishte një mbledhje në bashki. Ai eci. E çuam ta vizitonte Lidhjen e Prizrenit.

Dhe Bernard e njihte shumë mirë njeriun që kishte qenë përkthyesi im në fillim të misionit, sepse kishte disa çështje që kishin të bënin me një lloj çështjeje ligjore dhe Hasani shkonte.... dhe ai ishte përkthyesi, kështu që ai shkonte në Prishtinë me disa gjykatës nga Prizreni, dhe kështu ai e njihte Bernardin goxha mirë. Dhe Hasani ishte duke u martuar. Kështu që e organizuam, tani me këtë gjë, që... Unë thashë, "Pra, Bernard, ti mund të martosh Hasanin, sepse, a din, ti je kreu i shtetit në teori". Dhe ai e bëri (qeshë).

Erëmirë Krasniqi: Vërtetë?

Mark Baskin: Po, kështu që ne, dita shkoi. Ai i bëri këto takime me ne, e sollëm tek Lidhja e Prizrenit, ecëm përgjatë lumit, shkuam "Te Syla" për një drekë të madhe. Dhe Syla me të vërtetë e tejkaloi vetëveten me të gjithë ato tava, e tjerë, e tjerë. Dhe pastaj ne ecëm deri tek selia. Ai pati një mbledhje të bashkisë gjatë kësaj dhe shkoi në selinë tonë. Pastaj ai martoi Hasanin dhe Nazmijen, dhe ishte fantastike. Ishte shumë qesharake. Por ishte e mahntishme. Dhe Kouchner më kthehet mua pak para ceremonisë, dhe më thotë, "A mund me të vërtetë ta bëj këtë?" (qeshë). Unë thashë, "Sigurisht."

Erëmirë Krasniqi: Ju po përshkruani gjithashtu këtë moment në kohë që bëri të nevojshme... ju kërkoi të fillonit gjërat nga e para. Mund ta përshkruani?

Mark Baskin: Po.

Erëmirë Krasniqi: Sepse sapo na tregove se si e konceptove ligjin me një fjalë për të bashkuar dy persona. Por çfarë ndodh me fushat e tjera? Me një fjalë duhet të konsultoheni me ligjin e vjetër. Ligji aktual, cili ishte ligji aktual për të krijuar diçka që do t'i përshtatej kësaj shoqërie të re që ju ishit këtu për të krijuar.

Mark Baskin: Pra, në nivelet më të gjera, unë nuk jam përfshirë në këtë.

Erëmirë Krasniqi: Okej (qeshë).

Mark Baskin: Dua të them, nuk ishte ashtu. Kemi sjellë njerëz, kemi sjellur përmes avokatëve që kanë pasur përvojë në operacione ndërkombëtare apo çfarëdo. Dhe se ata po përpiqeshin... dhe po rishkruanin kodin ligjor, e tjerë. Kodi penal, dhe më pas është kodi civil. Dhe ne bëmë më të mirën e mundshme. Dhe kur shikoj mbrapa atë që bëmë në vitet '99-2000, ishte e gjitha si një improvizim momental. Ishte një zgjidhje e përkohshme, përdërisa diçka më e mirë të vijë, dua të them, diçka më e qëndrueshme mund të krijohej. Sepse asgjë realiste e qëndrueshme nuk mund të fillonte të krijohej deri në janar të vitit 2000, kur ata krijuan IPVQ-në⁶³, Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes.

Dhe kështu gjithçka që bëmë më parë ishte një lloj... dhe e bëmë. Ne bëmë disa gjëra. Dua të them, kam krijuar një Këshill Komunal në Prizren, por ka pasur disa vështirësi. Dhe një nga gjërat që bëra me ndarjen e punës mes meje dhe administratorit rajonal ishte se ai ishte njeri i lartë administrativ nga Suedia, dhe kështu ai dinte të drejtonte organizata të mëdha. Dhe unë themelova këshillat komunalë në të gjitha këto komuna: Suharekë, Rahovec, Malishevë dhe Dragash, dhe kështu që shkoja t'i vizitoja. Dhe ne do... a din, ne takuam njerëz atje, dhe shihnim se cilat janë partitë e ndryshme politike dhe të tjerët që janë njerëzit e biznesit dhe njerëzit që kishin punuar në administratë para vitit 1990. Dhe ne u përpoqëm t'i rregullonim gjërat.

Qasja ime ishte... për mua, ajo që kishte ndodhur nga periudha 1989 deri në 1999 ishte një periudhë e parregullt... unë e quaj atë si një lloj sistemi "aparteidi socialist", ose quani si të doni... por ishte... a din, kur të gjithë njerëzit etnisë shqiptarë u pushuan nga puna dhe u sollën njerëz të tjerë, mendova se ajo që duhet të bëjmë për të filluar sistemin e ri është të kthehemi në *status quo ante* dhe të kthehemi atje ku ishte më parë. Pra, ajo që ne u përpoqëm... ajo që unë u përpoqa të bëj është që të gjithë menaxherët dhe drejtorët të kthehen në "Perlonka", dhe në "Termokos" dhe në "Printeks" dhe të gjithë këto. Kombinatat e mëdha...

Erëmirë Krasniqi: A kishit, në atë kohë, një vizion për këto kombinata në pronësi shoqërore? Dua të them, si administrator, ishte pjesë e punës suaj të mendoni edhe për ekonominë?

Mark Baskin: Po. Nuk ishte... po, por ne përfunduam... me kalimin e kohës, erdhën njerëz që ishin teorikisht ekspertë në ato lloj fushash, por që herët, a din, ti ke bërë gjithçka. Dhe ne po përpiqeshim të rivendosnim, a din, ne po përpiqeshim t'i ecnim gjërat përpara. Po mendoj, ne organizuam, negociuam shitjen e verës, sepse ishte e gjithë kjo verë në këtë zonë. Leonardj, shefi im Suedez, ai solli një vreshtar Suedez. Kjo ishte njëra nga pasditet më të mira që kam kaluar, sepse ne shkuam në disa

⁶³ IPVQ - Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse ishin institucionet e krijuara gjatë kohës së protektoratit të UNMIK-ut në Kosovë 1999-2008.

vreshta ne zonën e Suharekës... ne nuk shkuam në Rahovec, sepse... oh jo, [ne shkuam në] Rahovec. Ne nuk shkuam në Gjakovë sepse nuk ishte rajoni ynë. Dhe shkuam të shijonim verë. Dhe të gjithë u dehëm vërtetë, ndërsa një nga shijuesit e verës pinte verën dhe, a din, e pështynte (qeshë).

Dhe ne përcaktuam se vera ishte mjaft e mirë dhe më pas filluam... dhe më pas kishte disa tregje tradicionale për këtë verë në Gjermani dhe vende të tjera, dhe kështu më pas pati përpjekje për të... a din, ne ishim qeveria dhe ne ishim në krye të saj. Dhe ndjenja ime ishte se njerëzit që ishin në pozita të pushtetit para vitit 1989 duhet të ktheheshin dhe më pas do të ndodhte çfarëdo që do të ndodhte. E dija gjithashtu kur bëhej fjalë për bizneset, duke parë se çfarë ndodhi në vende të tjera në Jugosllavi dhe në Evropën Lindore, se shumica e bizneseve socialiste nuk ishin shumë fitimprurëse, e tjerë. Kështu që aty do të duhej të ishte një kësi lloj tranzicioni gjithashtu. Por mendoj se njerëzit të cilët duhet të ishin të paktën aty duhet të ishin ata që kanë qenë aty më parë.

Dhe kështu që e gjithë qasja ime me qeverinë... kjo ishte gjëja ime, po mendoj. I tregova disa njerëzve që ajo ishte se çfarë po provoja të bëja, por, a din, njerëz të ndryshëm në regjione të ndryshme, ata gjetën mënyra të ndryshme për ta bërë, supozoj. Por, a din, ne provuam ta sillnim kuadron e vjetër, dhe nuk e di se sa mirë funksionoi, por ne po përpiqeshim ta bënim atë.

Erëmirë Krasniqi: Cilat ishin marrëdhëniet tuaja me qeverinë e përkohshme në vitin 2000 e në vazhdim? Disi, a kishte një...

Mark Baskin: Në fakt, ishte nga qershori i vitit '99 e këtej. A po mendoni për qeverinë e përkohshme të udhëhequr nga kryeministri [Hashim] Thaçi?

Erëmirë Krasniqi: Po, ishte si një institucion paralel disi vendor, dhe më pas ishte UNMIK-u. Rreth tij? Pra, si ndodhi...

Mark Baskin: Kjo është një nga ato tema ku nuk dua të hyj në shumë detaje.

Erëmirë Krasniqi: Okej.

Mark Baskin: Sa për të thënë, ishte e qartë në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit që mbështetej nga një gamë e plotë e qeverive të fuqishme dhe Këshilli i Sigurimit dhe të gjithë, se autoritetin e kishte OKB-ja dhe se ne duhej të krijonim një administratë të përkohshme, dhe se ne do të ndihmonim në trajnimin e tyre. Dhe kështu, kur njerëzit prezantuan veten tek ne duke thënë, "Eh po, ne jemi njerëzit në pushtet. Por faleminderit, a din, ne duam të punojmë me ju, mirëpo, në fakt, ne jemi ata". Dhe kështu ne u përpoqëm të integronim ata sa më shumë që ishte e mundur, por ishte një kohë e vështirë. Dhe nganjëherë njerëzit ishin... ishin disa të tjerë që nuk ishin, a din... kështu që ne deshëm t'i inkuadronim të gjithë.

Dhe në fillim, një nga gjërat që bëra ishte... kështu që të gjithë kishin... kishte disa parti shumë të vogla që nuk ekzistojnë më dhe emrat e të cilave nuk i mbaj mend. Disa prej tyre janë parti vërtetë radikale. Disa janë disa parti Enveriste disi. Dhe pastaj ishte... a din, LDK ishte një parti e madhe. PDK-ja nuk ka ekzistuar ende. AAK-ja nuk ka ekzistuar ende. Ramush [Haradinaj] ishte për një kohë në krye të TMK-së, apo KPC-së, në Prizren, dhe ai takohej me ne çdo javë para se të largohej dhe pastaj, a din, filloi të ndiqte karrierën e tij në politikë. Kështu që ne u përpoqëm t'i inkuadronim të gjithë. Ne do

të kishim dashur t'i kishim inkuadronim strukturat serbe, ato që mbetën, dhe kishte disa serbë që kishin mbetur, dhe për sa kohë që mbetën në Prizren, ishin edhe ata pjesë e ekipit tonë.

Në fillim, ne kishim dy ose tre nga ato që i quanim tryeza të rrumbullakëta të modeluara simbolikisht sipas asaj që kishin bërë në Poloni. Ideja është që ti të sjellësh të gjithë dhe të përpiqeni të kuptoni atë që duhet të bëni. A din, çfarë duhet të bëjmë? Dhe në fillim, i kishim të gjithë. Madje kishim edhe disa serbë, kishim njerëz të kishës ortodokse atje. Kishim... në Prizren, ishte shumë e larmishme etnikisht. Ne kishim boshnjakë dhe, a din, goranë dhe...

Erëmirë Krasniqi: Turk.

Mark Baskin: Padyshim, turk. Dhe, a din, pra...

Erëmirë Krasniqi: Ishte më e lehtë? A keni një këndvështrim krahasues për të thënë nëse ishte më e lehtë se në vende të tjera të sillnit këta njerëz në të njëjtën tryezë?

Mark Baskin: Eh po, çfarë ndodhi është se me kalimin e kohës disa nga njerëzit u larguan. Dua të them, njerëzit e kishës ortodokse u larguan, për shembull. Dhe kështu ata nuk ishin më aty, por turqit mbetën. Dhe ka pasur, dhe a din, ka pasur dy parti kundërshtarë boshnjake në atë kohë, dhe kjo ishte para se të krijoheshin Vakrat, por kishte edhe disa njerëz të tjerë. Dhe kështu, për sa kohë që isha atje, u përpoqa të sillja, ta mbaja atë sa më të larmishëm etnikisht dhe të sigurohesha që njerëzit që kanë pasur, të sigurohesha që Prizreni të mbetet Prizren (buzëqesh). A din, dhe unë nuk e di se sa i suksesshëm isha në këtë, por... ose sa ne ishim. Nuk jam vetëm unë.

Erëmirë Krasniqi: A kishte vrasje në atë kohë? Disi, më kujtohet Komandant Drini i vrarë në shtëpi. Unë pytëm nëse keni qenë atje në atë kohë, apo nëse kjo ka ndodhur më vonë?

Mark Baskin: Jo, kjo ndodhi kur isha atje.

Erëmirë Krasniqi: Oh.

Mark Baskin: E kam njohur atë goxha mirë.

Erëmirë Krasniqi: Si e trajtuat këtë? A lejonte misioni juaj të veproni në ato situata? Si ia keni dalë?

Mark Baskin: Ata akoma nuk kanë...

Erëmirë Krasniqi: Hë?

Mark Baskin: Ka pasur nja dy procese gjyqësore për vrasjen e Ekrem Rexhës, i cili ishte Komandant Drini, por ata akoma nuk e kanë zgjidhur rastin. Dhe ai ishte dikush që punoi shumë ngushtë me ne. Ai ishte një djalë i jashtëzakonshëm, mendoj një djalë jashtëzakonisht i talentuar. Dhe nuk di çfarë të them. Po mendoj, unë di shumë për këtë. Dhe më kujtohet dita kur u qëllua. Unë isha ushtrues detyre i administratorit rajonal në atë kohë, Leonardi ishte larguar. Dhe pas mbledhjes së mëngjesit, ne kishim "lutjet e mëngjesit", siç i quanim ne. Ne kishim takime në mëngjes çdo ditë: Çfarë po ndodh, kush po

bën çfarë, bla, bla, bla. Dhe në fund të takimit të mëngjesit, erdhi përkthyesi im, erdhi përkthyesi dhe tha, “Ekremi është qëlluar. Dhe ai është në institucionin mjekësor gjerman”.

Kështu që unë shkova dhe ai kishte vdekur. Dhe ai... vëllai i tij ishte aty, i cili sapo kishte ardhur nga Sarajeva, kështu që ishte hera e parë që e takova. Ruzhdiu. Dhe pastaj shkova për të vizituar familjen. Dhe për mua, ishte një nga momentet më dëshpëruese të gjithë misionit tim në OKB, sepse ai ishte dikush, anglishtja e të cilit ishte si e jotja {bën me dorë në drejtim të Erëmirës}. Anglishtja e tij ishte pothuajse e përsosur.

A din, nëna e tij ishte nga Drenica. Babai i tij ishte mysliman sllav. Kështu ai foli, ai ishte një oficer i APJ-së nga ish [Jugosllavia]. Ai kishte shërbyer në Kroaci, kështu që ne bënim shaka, a din, duke folur, *Zagrebačka šatra*⁶⁴ e të tjera. Ne flisnim me zhargon. Dhe ai ishte shumë kreativ. Ai ishte vërtetë një tip mbresëlënës. Dhe kush e di se çfarë do të kishte ndodhur po të kishte mbetur gjallë sepse shumë gjëra kanë ndodhur.

Por unë kisha dashur... po përpiqesha ta dërgoja në Harvard për të shkuar në këtë [master] në mes të karrierës... Dua të them, ai ishte lloji i djalit që mund të kishte... a din, që do të kishte arritur shumë. Atje shkoi më vonë Shpend Ahmeti. Unë mendoj se ai do të kishte arritur shumë atje. Dhe kështu, a din, po iu shkruaja miqve të mi akademikë në Shtetet e Bashkuara për të parë se çfarë mund të bënim sepse e dija se ai kishte potencial. Pra, është një moment vërtetë i trishtë.

Erëmirë Krasniqi: A kishte më shumë nga këto?

Mark Baskin: Jo shumë. Kishte disa. Ka pasur disa raste të boshnjakëve në Tusus, në zonën e Tususit. Dhe ky është një rast tjetër i pazbardhur, më duket në janar të vitit 2000. Familja Skënderi. Unë po e shikoja përsëri këtë kohëve të fundit. U vranë tre persona. Askush nuk zbuloi se kush e ka bërë vrasjen. Dhe, a din, zona e Tususit e Prizrenit është ajo lloj zone që ishte paksa e egër ndaj ndërtimit dhe gjithë kësaj, dhe ishte e përzier etnikisht. Pra, në atë kohë, a din, ne u përpoqëm të bënim gjëra. Kur merrni një ngjarje të tillë... dhe ata erdhën dhe u takuan me mua, boshnjakët. Dhe kështu përpiqesha të krijoja një lloj policimi në lagje.

Dhe pastaj u takova me atë lloj krahu... isha ende... nuk isha ende administrator komunal, pra këtë e bëja nga rajoni. Dhe kështu u takova me djemtë nga komuna dhe ata më thanë, “A keni vullnet, a din {bashkon duart bashkë} të i bëjmë disa projekte të përbashkëta?” A din, rregullimi i shkollës, pastrimi i një parku, a din, duke u përpjekur të kemi disa gjëra ku ata do të punonin së bashku. Dhe ata thanë se do ta bënin, dhe më pas nuk jam i sigurt se çfarë ndodhi, a din, sepse isha në një pozitë mjaft të lartë. Dhe kështu unë merrja diçka dhe pastaj do t’ua jepja atyre dhe pastaj kushedi se çfarë do të ndodhte. Dhe, në fund, shumë nga këto iniciativa që mendova... nuk u realizuan plotësisht.

[Rrëfimi vazhdon në pjesën e pestë]

Pjesa e Pestë

⁶⁴ Kroatisht për “çadra e Zagrebit”.

Erëmirë Krasniqi: Si e identifikonit ju se çfarë duhet bërë? A vinin njerzit te ju, apo ju iu qaseshit atyre? Si e kuptonit qëllimin e angazhimit tuaj këtu?

Mark Baskin: Oh, s’di. Pra, e ke një agjendë. Agjenda definohej nga Prishtina, më pas janë gjërat që ti dëshiron t’i bësh, më pas janë, e din... më pas janë krizat. Pra, siç ishte vrasja e Ekremi, Komandant Drinit. Ajo ishte një krizë. Na zuri krejt papritur, dhe kështu punuam. E kishim krejt javën e planifikuar (kullet), dhe krejt papritur ai plan bie poshtë. Apo kur, e din, kur... dhe kështu kishte ndodhur. Dhe kishte shumë organizata asokohe më kujtohet, ishin këto... kishte huti.

Pra, kjo ishte hutia që kishte zënë vend: gjermanët ishin vendosur diku në Korishë, që është një fshat në afërsi, disi në rrugë për Prizren. Ata kishin krijuar një vend për të gjuajtur me armë për ushtrinë. Dhe pra... e dini, pasi që ushtria ka nevojë të vazhdojë të stërvitet dhe këtë u duhej ta bënin siç duhej, andaj dhe kishin një vend për gjuajtje. Kjo është praktikë. Ushtria bën gjëra të tilla. Dhe, papritmas një ditë Flaka Surroi ishte aty. Ajo punonte për Bankën Botërore Programin për Zhvillim të Komunitetit, dhe ishte shumë e hidhëruar, sepse siç e tha edhe vet, e dini, ne... sepse Banka Botërore, ky Programi për Zhvillim të Komunitetit, njëjtë si USAID, kishte një program për përgjigje të shpejtë, ata shkonin nëpër fshatra dhe thonin... takoheshin, kishin disa takime me njerëzit, dhe thonin, “Çfarë lloj gjërash ju nevojiten, dhe si mund të ju ndihmojmë të ndërtoni një jetë normale?”

Dhe çfarë ata do të bënin në Korishë në atë vendin ku ishin vendosur gjermanët... ku e kishin vendin për gjuajtje, donin ta bënin vend për mbeturina, dhe aty kishte nevojë të hatashme për vend mbeturinash. Kishte... më kujtohet që ajo kishte vozitur për në Prizren nga Prishtina. Aty ishte... i shihje qeset e plastikës si lundronin. Ishte me të vërtetë e pakëndshme, dhe, e dini, askush nuk ishte kujdesur për këtë gjë, posaqërisht nga 23 marsi ‘99 deri më 10 qershor⁶⁵ nuk kishte përkujdesje. Dhe më pas ne u angazhuam, ende nuk kishte asgjë, sepse nuk kishte njerëz ende, dhe na mori shumë kohë për të ndërtuar një bazë. Dhe kështu unë shkoja në shumë takime me orë të tëra për të diskutuar mbeturinat, për shembull (kullet). Dhe kështu ata dëshironin të vendosnin aty mbeturinat, por aty ishte vendi për gjuajtje, dhe kjo na mori dy apo tre javë bisedime në mes të gjermanëve dhe Bankës Botërore.

Erëmirë Krasniqi: Një aferë ndërkombëtare (qesh).

Mark Baskin: Po, njëmend ishte. Po, është...

Erëmirë Krasniqi: Ti duhej të gjeje një zgjidhje për mbeturinat. Dhe si... çfarë ke bërë më pas, apo dëshironi të qëndroni ende në këtë periudhë?

Mark Baskin: Pra, ky ishte fundi i kohës sime në OKB, dhe fundi i kohës sime këtu. Dhe këtu kemi bërë shumë gjëra. Sollëm... një ndër gjërat që Komandant Drini bëri bashkë me ne, unë kam një mik kanadez, dhe më vonë shkova të punojë për ta, për *Pearson Peacekeeping Centre* [Person Qendra Paqëruajtëse] në Nova Scotia në Kanadë, dhe ata kishin programe të mëdha, gjë që kishin programe të trajnimit të nivelit ekzekutiv dhe bënim gjëra... dhe ata mundoheshin të bënin gjëra në terren. Dhe ky miku im më thotë, “Tani do të kyçemi në DDR”. Dhe kjo ishte... programi për demilitarizim, demobilizim, dhe reintegrim, dhe po e zhvillon tërë këtë program mbi DDR. Unë thashë, “Fantastike”. Dhe ata thanë... Unë thashë, “A dëshironi të vini në Prizren?” Unë fola me miqtë e mi aty, ai tha, “Ne

⁶⁵ Periudha e bombardimeve të NATO-s në Jugosllavi.

nuk mund të paguajmë për këtë. Por, nëse vijnë në Prizren, ne do të bëjmë gjithçka për ta, do të ofrojmë mbështetje pa pagesë”.

Pra, PPC pagoi për ardhjen e tyre. I takuam në Shkup. E dini, unë... dhe ata erdhën dhe kaluan dy deri tre javë duke punuar me Komandant Drinin, apo Ekrem Rexha, për të demobilizuar ushtarët e UÇK-së dhe gjërat tjera që duhej të bëheshin. Dhe bënin gjëra të ngjashme. Kjo ishte diçka e mirë. Dhe më pas, nuk e di... por e tërë kjo punë bëhej sa për të mbajtur jetën në rend derisa këto sistemet më të zhvilluara të vendoseshin. Dhe më pas OKB-ja bëri punën e vet, diçka nga ato shumë të mira, diçka nga ato jo, pra në vende të ndryshme. Dhe...

Erëmirë Krasniqi: Kur jeni larguar? Dhe ku keni shkuar nga aty?

Mark Baskin: Unë u largova në nëntor të vitit 2000 dhe shkova në Kanada. Atëherë shkova të punojë për PPC. Sepse pasi që bëmë atë bashkëpunim, ata më ftuan të zhvilloja një lëndë mbi bashkëpunimin civilo-ushtarak, dhe kështu ligjërova atë lëndë. Dhe ata po kërkonin dikë të bëhej drejtor i hulumtimit. Unë kam prapavi akademike, kështu që përshtatesha, dhe shkova aty. Dhe më pas...

Erëmirë Krasniqi: Sa gjatë keni qëndruar aty?

Mark Baskin: Unë isha aty për dy vite. Kisha dhe mundësi tjera, dhe shpesh mendohesh nëse kam zgjedhur të duhurën. Dhe kështu, e dini, kam mundur të shkoj në Washington dhe të punoja atje. Por në atë kohë... pra, ti ke qenë atje në Dartmouth⁶⁶, apo?

Erëmirë Krasniqi: Po.

Mark Baskin: Pra, Nova Scotia është vetëm pak më lartë.

Erëmirë Krasniqi: Po.

Mark Baskin: Dhe ishte... për dikë që ka punuar në zona lufte për shumë vite, me dukej si një vend idilik që doli se... e din, do të dëshiroja të isha në qytet. Unë jam djali i qytetit, por ishte në rregull. Ishte mirë.

Erëmirë Krasniqi: A ishte ftohtë?

Mark Baskin: Jo, sepse e kanë Gulf Stream aty. Dhe thënja në Nova Scotia është, “Nëse nuk të pëlqen moti, atëherë prit dhjetë minuta”. Andaj, dimri nuk është shumë i ftohtë. Dimri, e din... edhe pse i bënim këto trajnime dhe sjellim oficerë nga Afrika dhe Amerika Latine, pranë Ekuadorit në mes të dimrit, dhe ata nuk kishin xhaketa dimri, dhe duhej të bënim gjëra të tilla.

Erëmirë Krasniqi: Familja vinte me ty apo ata ishin me bazë në SHBA?

Mark Baskin: Familja ime, ata erdhën me mua në Zagreb dhe më pas ne u bartëm në Osijek. Ata ishin me mua në Osijek dhe më pas në Sarajevë. Dhe më pas një nga arsyet që u largova është se unë me të

⁶⁶ Dartmouth College, një universitet kërkimor privat në Hanover, New Hampshire, në verilindje të Shteteve të Bashkuara.

vërtetë nuk kisha ku t'i akomodoja. Nuk ishte ende sigurtë për t'i sjellur aty, dhe Suzanne nuk dëshironte... ajo... unë do të... shumë njerëz kishin familjet e tyre në Shkup, dhe kjo nënkuptonte që çdo të premte pasdite ata udhtonin për në Shkup. Por unë jam një lloj i personit që kur punoj, punoj 14 orë në ditë. Dhe ideja ime e... dhe shpesh punoj në fundjavë.

Dhe çfarë unë bëja për një kohë të gjatë në vjeshtë të '99 është çdo të diele, një grup i joni shkonte nëpër fshatra të ndryshme, dhe takoheshim me njerëz, dhe unë i pyetja, "Si ishte për ju gjatë luftës?" Dhe ata ma përshkruanin. Më pas, unë u tregoja atyre se çfarë jemi duke bërë. E tëra ishte bisedë joformale. E bëja këtë sepse më interesonte ta bëja dhe provoja kështu ta promovoja programin e OKB-së. Thellësisht kam besuar se mund të ketë sukses përkundër të gjithave... a din, sikur martesa e dytë, thojnë që është triumfi i shpresës mbi përvojën, a din. Unë me të vërtetë kam besuar që do të ketë sukses, dhe kështu që e bëja tërë atë punë. Dhe...

Dhe kështu që nuk doja që familjen ta kisha në Shkup. Ata nuk donin të shkonin atje. Kështu që, ata ishin në Shtetet e Bashkuara. Dhe më pas kur mora punën në Kanada, ne u ribashkuam. Dhe kjo ishte... ne ishim... dhe unë kështu shkoja në Shtete të Bashkuara çdo, nuk e di, çdo gjashtë javë për dhjetë ditë.

Erëmirë Krasniqi: Çfarë ka ndodhur me ty në këtë periudhë, nga viti 2002 deri në vitin... 2013, në këtë vit thatë që jeni kthyer përsëri në Kosovë?

Mark Baskin: Po, po, pra, në fakt unë isha në Kosovë edhe ndërmjet këtyre viteve.

Erëmirë Krasniqi: Oh.

Mark Baskin: Kam bërë gjëra të ndryshme.

Erëmirë Krasniqi: Njëmend?

Mark Baskin: Po.

Erëmirë Krasniqi: A mundësh me na tregu pak më shumë rreth kësaj?

Mark Baskin: Kam bërë një raport vlerësues mbi gjyqësorin në vitin 2001. Ju kam treguar diçka nga kjo. Kam... për qeverinë kanadeze e cila u publikua në webfaqën e Bankës Botërore për Sundim të Ligjit. Bëra një për USAID... isha pjesë e ekipit që bëri raportin vlerësues mbi kthimin e pakicave në Kosovë. Dhe për këtë, sepse njerëzit me të cilët punoja... Enver Hoxhaj ishte pjesë e ekipit dhe kështu u njoha me të. Punova shumë afër me Enverin për tre javë në këtë... kjo duhet të ketë qenë në vitin 2003. Dhe më pas...

Erëmirë Krasniqi: Kishte shumë ndalje të rrymës. Si keni menaxhuar me këtë situatë deri sa ishit administrator i komunës?

Mark Baskin: Oh kishim një... po, kjo është një pikë me rëndësi. Kishte... kishim gjeneratorë. Në qendrat tona, ne kishim gjeneratorë. Nuk kisha në shtëpinë time. Po mendoj, kam jetuar... në dimrin e '99-2000, që ishte një dimër i ftohtë, nuk kishte nxemje, nuk kishte ujë të nxehtë. Bëja dush të ftohtë.

Bëja shumë dusha të ftohtë në një shtëpi pa nxemje. Kisha batanije kaq të trasha {tregon trashësinë me duar} dhe vija në shtëpi... pra vija në shtëpi vetëm për të bërë gjumin. Dhe kisha një shtëpi të bukur. Shumë herët, kisha marrë me qira një shtëpi shumë të bukur. Kisha një qiraxhi tjetër aty, a din, poashtu punonjës i OKB-së. Dhe kështu mbulohesha me batanije dhe zgjaste diku dy minuta dhe trupi më ngrohej nga temperatura e vet trupit. Zgjohesha, dhe bëja një dush çdo të dytën ditë sepse ishte me të vërtetë e dhimbshme si proces, dhe nuk është që më duhej me të vërtetë. Kështu që, ishte ftohtë. Ishte një dimër shumë i ftohtë. Dhe e tërë rryma që kishim ishte në qendër, në zyret tona. Dhe nuk kishte diçka tjetër...

Dhe njerëzit tjerë që i vizitoja, edhe ata më ftonin të qëndroja tek ta, ata kishin gjetur zgjidhje me stufa dhe ngjashëm, por unë nuk kisha vepruar njëjtë sepse nuk isha aty të bëja shtëpi. Po mendoj, shkoja në punë 7:30-8:00 të mëngjesit dhe kthehesha në 9:00-10:00 të mërkurës, dhe kjo ishte rutina ditore. Dhe më pas... i kisha këto dritat me bateri, dhe shkoja në gjumë duke u munduar të lexoja me to, por shpejtë më merrte gjumi pas një nate "Te Sylja", a din. Sylja gjithnjë më detyronte ta pija një *scotch* (qesh), dhe...

Erëmirë Krasniqi: Kishte shumë aksidente në atë kohë për shkak të reduktimeve të rrymës, a din, për shkak të tërë asaj...

Mark Baskin: Po, kishte gjëra të tilla. Kishte shumë gjëra që kishin ndodhur, dhe me kohë po harrohen. E di që i kemi pasur... a din, ishte vështirë... ishte kohë e vështirë. Herët në mision, të gjithë ishim si një familje, sepse nuk kishte shumë *expat*⁶⁷. Ne kishim një ekip të madh me vendorë. Dhe e kishim njëfarë ideje që të gjithë... ne besonim se kemi me qenë të suksesshëm dhe që... dhe i jetonim jetërat tona së bashku, por me kalimin e kohës, *expatët* dëshiruan të bënin jetërat e tyre ndaras, dhe gjatë asaj periudhe jam larguar. Unë... po, sidoqoftë, në atë kohë u largova. Nuk isha posaqërisht mbështetës i asaj, dhe unë kam besuar që nëse mund të identifikosh njerëzit e duhur për të punuar me ta... dhe nuk ka pasur shumë rëndësi... njerëzit e duhur ishin njerëzit që kishin dëshmuar që janë të interesuar të bënin punën siç duhet, që me të vërtetë mundesh të bësh gjëra të mira. Por kishte mënyra të shumta si... Prizreni ishte i vogël... ishte një vend i vogël, dhe gjërat e mëdha po vendoseshin nga Prishtina.

Erëmirë Krasniqi: A udhtoje shpesh për në Prishtinë?

Mark Baskin: Po, përjavshëm. Ne shkonim në takime të pëjavshme. Në atë kohë, ndonjëherë të merrte dy, dy orë e gjysmë sepse, e din, kaloje ka rruga e Duljes, e din, dhe rrugët janë të tmerrshme, njëmend të këqija. Dhe më pas bllokohesha nga konvojet gjermane, dhe lëvizje 10-15 kilometra në orë. Dhe kur arrije në Shtimje, kishte gropa, vërshime, lumenjë, liqej në rrugë. Suhareka kishte rrugë të tmerrshme asokohe, kështu që ishte...

Po, shkonim në Prishtinë, takoheshim me... e din... pr isha bërë prizrenali i vërtetë, e din. Miqtë e mi më thonin, e din, "Kam punuar në Prishtinë 20 vjet. Kurrë nuk kam fjetur aty", e din, gjëra të tilla. Por, unë jo, ndjehesha në shtëpi në Prizren, dhe nuk, e din, nuk e pëlqeja në veçanti Prishtinën. Dhe në Prizren, unë, gjithësecili, a din, unë e flasë vetëm serbo-kroatishtën dhe unë kurrë nuk flisja me dikë që nuk e njihja. Dhe nuk shkoja në dyqan t'u flisja në këtë gjuhë. Por, a din, kur e njofton dikë e tjerë, dhe e

⁶⁷ Migrantë të profilit profesional.

kupton që ajo është gjuha në të cilën mund të komunikoni, kaloni në atë gjuhë me lehtësi. Por nuk e bëja këtë kurrë në Prishtinë. Mendoj...

Erëmirë Krasniqi: A kishe frikë se me këtë mund ta rrezikoje dikë, madje edhe në Prizren, nëse do ju flisje në serbo-kroatisht?

Mark Baskin: U kërcënova nga disa njerëz të cilët thonin... po mendoj, “Për Zotën, je shumë i guximshëm që e flet atë gjuhë”, njerëzit ma thonin këtë ndonjëherë, njerëzit të cilët donin unë të i mendoja ata si miq të mi, apo donin... e dini, ka shumë traumë, gjë që është e kuptueshme. Dhe, siç e dini, këtë e kam kuptuar më mirë prej se që jam kthyer. E din, flet me njerëz të cilët kanë qenë të burgosur politik dhe më pas... njofton njerëz aty që ta thojnë po këtë.

Kur u ktheva takova disa njerëz këtu te “Martini” një natë, këngëtarë të folklorit, dhe ata filluan të këndonë për ne. Dhe ne po flasim, dhe mund të komunikonim në kroatisht, pra ne flisnim kroatisht, dhe kaluam natën... dhe kjo ndodhi rastësisht. Dhe ata filluan të më tregojnë se çfarë ju ka ndodhur atyre në vitet ‘90, ata do të dilnin jashtë në qytet dhe policia i shihte dhe u thoshte, “Çfarë po bëni jashtë?” “Oh, vetëm po shkoj deri këtu”. Dhe më pas siç e din do të maltretoheshin fizikisht, apo dërgoheshin në burg sepse paskan shkelur orën policore. Kishte shumë situata të ngjashme, dhe supozoj që ky rast nuk ishte i vetmi por që gjëra të tilla ndodhnin.

E dini, kam folur me dikë i cili tash ka influencë, ai më tha që kur ishte fëmijë në vitet ‘80, në ‘80-at e vona... kjo ishte edhe më herët... kishte dëmtuar një parollë, “Tito socializëm i mirë” [flet në shqip] apo diçka ngjashëm. Ishte dënuar me katër vjet burg për dëmtim. Po mendoj, a din, kjo nuk... ai do të duhej të gjobitej apo detyrohet të bëj ndonjë punë [vullnetare]. Por kështu, a din, kishte gjëra të tilla. Dhe kështu janë këto traumat. Dhe më pas dëgjon çfarë ka ndodhur në Krushë apo çka ka ndodhur në Ferizaj pas, e din... andaj janë të gjitha këto. Kështu që nuk e di, a din... Dhe unë jam kthyer, organizova vizitën e Gardës Kombëtare të Iowas [*Iowa National Guard*] në Shtetet e Bashkuara. E bëra këtë në dy vitet e fundit. Dhe vajza e Ukshin Hotit ka qenë studente e imja. Dhe kështu, e bëra këtë, deshta t’i çoja në Krushë që të takohen me... është një gjë e mrekullueshme... e din këtë tregim, që aty kanë biznese të udhëhequra nga gratë të cilat prodhojnë ajvar. Është fantastik. Është një tregim i mrekullueshëm në shumë nivele.

Unë nuk kisha qenë në Krushë qysh nga viti 2000, ‘99-2000, dhe shkova, dhe Brisilda e organizoi për mua të takohem me axhën e saj, i cili tash, dhe më pas takova këtë njeri i cili tani është në krye të fshatit. Dhe ata më drejtohen, më thonë, a din, “Z. Baskin” vazhdon, “më kujtohet kam folur me ju në vitin 1999”. Dhe, e din, m’u kujtua që kam qenë aty, dhe kjo ishte shumë herët, kur ICDI⁶⁸ ishte këtu për të investiguar rreth masakrave dhe ngjashëm. Pra... dhe, dhe njerëzve ju kujtohej kjo... pra këta njerëz që kujtojnë këtë, e kujtojnë edhe që unë kam qenë njëfarë lloj stabiliteti për ta dhe një gjë pozitive, andaj kjo ishte e mirë. Por kjo ndjenjë e traumës së madhe është aty, andaj në këtë kuptim, ishte një kohë e vështirë. Ishte kohë e vështirë, për ata dhe për ju të gjithë, në veçanti, sepse... dhe, kështu...

Erëmirë Krasniqi: Po mendoj, a ka qenë e vështirë me prezantu ide të cilat kanë qenë më gjithëpërfshirëse dhe kanë paramenduar edhe tjerët po ashtu? Tjerët, po mendoj komunitetet jo shqiptare. Apo kjo nuk është praktikuar asokohe? Vetëm merreshit me...

⁶⁸*International Child Development Initiatives* - Inicativat Ndërkombëtare për Zhvillimin e Fëmijëve, një OJQ holandeze dedikuar zhvillimit të fëmijëve duke u rritur në kushte të vështira.

Mark Baskin: Kemi provuar ta bëjmë. Po mendoj, e kam pasur një njeri... po mendoj, në komunën e Prizrenit... unë isha administrator i komunës. Unë i kisha tre zëvendës: një shqiptar, një turk, dhe kisha një boshnjak. Dhe shqiptari dhe turku njihnin njëri-tjetrin për një kohë të gjatë. Dhe që të dytë ishin pjesë aktive e... turki, e din, ai ishte i burgosur politik në vitet '90 dhe krejt kjo. Dhe ky, emri i tij ishte Shazir Shaipi. Ishte njeri i mrekullueshëm.

Dhe... dhe ne... unë duhesha... më duhej ta gjeja edhe një boshnjak. Dhe kështu e kisha... a din, i kisha edhe këto partitë politike që kundërshtoheshin. Ato e donin atë pozitë (kullet), dhe unë vendosa që nuk e dua asnjërin (kullet) sepse ne do të bëheshim apolitik. Andaj, pyeta njerëzit me të cilët punoja, u thashë, "Na duhet ta gjejmë dikë që është boshnjak dhe që kalon mirë me të gjithë. Dhe nëse e flasin gjuhën shqipe, do të ishte fantastike", dhe ata e gjetën njërin, një djal që kishte punuar në "Ballkan". Ai ishte nga Zhupa dhe ishte i mrekullueshëm. Ai ishte tepër i mirë.

Dhe kështu, e din, kështu mundoheshim të kryejmë punë. Dhe në Prizren mund ta shihje mënyrën se si Jugosllavia ka funksionuar.

Erëmirë Krasniqi: Si ashtu?

Mark Baskin: Po, unë kisha miq të cilët do të thonin... aty ishim tre vetë. Dy prej tyre shqiptarë dhe një ishte turk. Dhe të gjithë ishin të gjeneratës së njëjtë. Dhe njëri prej tyre tregonte se si ka shkuar në shkollën e mesme në gjuhën turke, njëri ka shkuar në gjuhën shqipe, dhe tjetri në gjuhën serbe. Dhe... njëri prej tyre ka vijuar universitetin në Zagreb, njëri universitetin në Beograd, mendoj...

Erëmirë Krasniqi: Në Zagreb?

Mark Baskin: Dy prej tyre kanë shkuar në Zagreb. Nuk jam i sigurt ku Vučko e ka vijuar. Vëllau i Vučkos e kishte vijuar në Beograd. Dhe e dini, po mendoj, të gjithë ishin qytetarë të atij vendi. Të gjithë ishin njerëz urbanë, dhe ishin pjesë e grupeve elitare. Dhe kishte një krenari të vërtetë qytetare. Kishte një ndjesi të vërtetë që... dhe ishin të hapur në shumë kuptime. Dhe... dhe m'u kujtua kjo. Nuk e di...

Erëmirë Krasniqi: Kur je kthyer dhe njëmend zhvendosur këtu?

Mark Baskin: Në vitin 2014.

Erëmirë Krasniqi: Dhe qysh atëherë ke qenë këtu tërë kohën?

Mark Baskin: Po mendoj, unë largohem, por po. Po, po, kam jetuar këtu qysh nga viti 2014. Dhe...

Erëmirë Krasniqi: Si ke vendosur?

Mark Baskin: U punësova.

Erëmirë Krasniqi: Okej.

Mark Baskin: Po mendoj, kam qenë në një moment në... isha... kisha kaluar... Pasi që u largova, po i kthehem shpejt biografisë sime, pasi u largova nga Kanadaja, shkova të punoja... ish bashkëshortja ime është nga veriu i New Yorkut, rrethi i Schenectady-Albany, dhe kështu blejtëm një shtëpi. Dhe unë u punësova në Universitetin Shtetëror të New Yorkut në Albany, ku punova për... nuk e di sa, deri sa u largova për të punuar në zhvillim ndërkombëtar dhe ngjashëm, dhe po ashtu ligjeroja në departamentin e shkencave politike. Dhe me universitetet shtetërore buxheti është gjithnjë sfidues (kullet). Dhe nuk e di sa gjatë kisha mundur të qëndroj aty dhe ta bëjë të njëjtën. Por unë, a din, isha... dhe puna... kështu që fillova të kërkoj punë, dhe mora këtë punë ku të njoftova ty fillimisht {bën me dorë në drejtim të Erëmirës}, dhe më pas mora punën në UAK.

Erëmirë Krasniqi: Po mendoj, kur i ligjeron këto lëndë, a janë... kjo përvojë a e informon mënyrën se si i dizajnon lëndët? Si e integron këtë përvojë në procesin mësimor?

Mark Baskin: Pra kur u ktheva... a din, unë isha akademik me orar të plotë para se të punoja për OKB-në. Dhe çfarë tash ligjeror është komplet tjetërçka. E vetmja lëndë që unë vazhdoj të ligjeroj është... dhe këtë nuk e kam ligjeruar në Albany. Nuk donin që unë të ligjeroja këtë lëndë. Kjo ishte pak, a din... ishte politikë krahasuese. Por kur isha në Albany ligjeroja një lëndë mbi rindërtimin pas konfliktit. Ligjeroja lëndë mbi paqen dhe luftën. Ligjeroja mbi konfliktet etnike, të cilat kurrë më parë nuk i kisha ligjeruar. Përderisa më parë ligjeroja lëndë mbi... sepse unë isha i përgaditur për studime sovjetike, ligjeroja lëndë mbi çështje të jashtme sovjetike... Politika të Jashtme Ruse, Raportet Ruso-Amerikane, Politikë Krahasuese, dhe, e dini...

Më pas punova edhe në këtë shkollë shumë të vogël ku mund të bëje çfarë dëshiroje, dhe aty ligjerova një lëndë... që nuk më lejonin ta ligjeroja në Albany... një lëndë mbi filmin politik, të cilën lëndë më pëlqen shumë ta ligjeroj. Andaj... dhe, siç e din... më pas, kur isha këtu ligjeroja lëndët që u duheshin mbi ekonominë politike globale, politikën krahasuese, politika publike, për të cilat lëndë i kam ligjeruar edhe në kohërat e mëhershme. Dhe po ashtu ligjeroj lëndën Historia e Ballkanit. Unë, ne, nuk funksionoi. Kisha dëshirë të të ftoja [i drejtohet Erëmirës], ndoshta këtë vit, nëse e ligjeroj prapë do të ftoj, sepse ata realizuan intervistat e historisë gojore. Ata i bën disa, unë ua dhashë si detyrë... dhe ajo detyrë pati rezultate të mira. A din, disa prej studentëve nuk kanë interesim për asgjë, por disa prej tyre me të vërtetë u kënaqën. A din, ata... kërkova nga ata të studjojnë, të intervistojnë njerëz të një moshe të caktuar rreth kujtesës së tyre mbi socializmin.

Erëmirë Krasniqi: Okej.

Mark Baskin: Dhe disa prej studentëve me të vërtetë u thelluan. Është me të vërtetë interesante se si mund të hulumtosh prapë në shoqërore të studentëve tuaj kur ua lexon detyrat, pra...

Erëmirë Krasniqi: E ke vazhduar punën në, si ishte kjo projekti me USAID që ndanit bursa studimi?

Mark Baskin: Po, ne ndanim bursa studimi. Dhe ishte në rregull. Mirë ishte, a din, në fund e braktisa atë projekt. Dhe...

Erëmirë Krasniqi: Ishte mjaft i hapur si program sa e mbaj në mend. Nuk kishte vetëm...

Mark Baskin: Ishte. Por problemi ishte në tanësinë e saj... dhe kjo na shpie në një bisedë krejt tjetër mbi natyrën e zhvillimit dhe natyrën e ndihmesës në procesin e zhvillimit. Dhe, “Ne u kemi dhënë shumë bilionë dollarë” dhe ti mendon rreth bilionëve që BE-ja dhe agjenci tjera shtetërore kanë dhënë, dhe sa shumë prej atyre fondeve shpenzohen në rrogat e njerëzve si unë? Sa nga ato fonde shkojnë në programe? Dhe siç duket... po mendoj, kam punuar për projektet e USAID për shumë vite... siç duket 10-20 përqind shpenzohen në projekte apo programe. Pjesa tjetër shpenzohet në gjithçka tjetër. Dhe ti thua në rregull, është mirë, por a është njëmend?

Dhe (kullet), ky program përfundoi duke të dërguar ty... dhe ti je një shembull shumë i mirë {bën me gisht drejt Erëmirës} sepse ti shkove dhe tani e bën këtë, po bën diçka vërtetë të mrekullueshme dhe të dobishme dhe të rëndësishme për këtu. Dhe kjo do të duhej në njëfarë forme... në ndonjë shtet tjetër [Iniciativa për Histori Gojore] do të mund të ishte pjesë e Universitetit të Prishtinës. Po mendoj, varësisht nga... ndoshta ende varet nga se si gjërat do të zhvillohen në kuptim që, sepse... a din, janë gjithë këto çështje... a din, dhe jam e sigurtë që e din për këtë në Shtetet e Bashkuara: *National Public Radio* [Radio Kombëtare Publike]⁶⁹ ka arkivë të ndryshme. Njerëzit tregojnë historitë e tyre. Po mendoj, është e ngjashme, mirëpo është një burim i mrekullueshëm.

Por shumë njerëz vijnë, ata... ne i dërgojmë njerëzit jashtë. Ky program është supozuar të jetë praktik, dhe ne dërguam njerëz të studiojnë gjëra që jomedomos janë praktike. Dhe njerëzit shkojnë dhe studiojnë një gjë dhe kthehen dhe nuk bëjnë mjaftueshëm... kështu që është shumë vështirë të kuptosh... në anën tjetër, mendoj që gjithnjë është ide e mirë që njerëzit të mund të studiojnë... mendoj që programet në të cilat i kemi dërguar njerëzit kanë qenë mjaft të mira, dhe studentët ia dolën mbanë, andaj është mirë që kapacitetet njerëzore janë zhvilluar. Po mendoj, për shembull, dikush si... dhe, a din, po mendoj për dikë që ka qenë në kohortin tënd i cili shkoi të punojë për Ministrinë e Jashtme, Besarti.

Erëmirë Krasniqi: Ah.

Mark Baskin: Po, por ai nuk është i vetmi i cili shkoi të punojë. A din, ai bëri magjistraturën në Denver, që është një shkollë e mrekullueshme, dhe tani ai... ai po punon privat. Apo, ai tani nuk po punon për qeverinë, dhe kjo është fatkeqësi, dikush me atë kapacitet. Ky është vetëm një rast. Dhe kështu... për shkak se unë e njoh atë pak. Dhe kështu e di këtë rreth tij. Por mundohesh të kthesh kontributin. Dhe, meqë ra fjala, programin të cilin ne e drejtonim është i ngjashëm... të gjitha universitetet. E kam dërguar sivjet një student, i cili tash është në Bruksel, është duke magjistruar në Leuven. Dhe kur ai kthehet, atij do të i duhet të punojë, a din... po supozoj, ai do të punojë për qeverinë për dy ose tre vite.

Erëmirë Krasniqi: Tre vite, tre vite të tëra, po, e di atë program. Atë skemën e bursave, e din.

Chester Eng: *Young Cell Scheme.*

Erëmirë Krasniqi: Po, po.

Mark Baskin: Ajo është një skemë e mirë. Edhe pse, në rastin e tij, duam ta dërgojmë në Shtetet e Bashkuara të bëj doktoraturën në histori, sepse ai do të dëshironte, por të shofim. Ai është ende i ri.

⁶⁹ NPR, një rrjet radiofonik në SHBA i financuar publikisht dhe privatisht.

Erëmirë Krasniqi: Si... si i jepni kuptim jetës suaj në këtë kaptinën e fundit?

Mark Baskin: Pra, për mua është çështje personale, është, a din, rastësia më solli këtu në Ballkan në vitin 1975. Dhe unë kurrë... unë nuk kam ditur shumë mbi Jugosllavinë në atë kohë ose diçka ngjashëm. Dhe megjithatë jam bërë disi... unë ndjehem shumë lokal në një mënyrë, edhe pse nuk jam. E di që nuk jam. Dhe unë... pra, për mua, ndjehem që... nuk mund të imagjinoj të bëj diçka tjetër që është po aq përmbushëse personalisht sesa çfarë jam duke bërë tani, të dyja ligjerimi dhe konsulenca të cilën e ofroj, puna që e bëj. Kështu që...

Dhe mendoj që ky nuk është vendi i vetëm që ka qenë i rrënuar dhe i shkatërruar nga lufta dhe konflikti dhe tërë kjo. Ka shumë vende në botë... ku gjërat shkojnë tmerrsisht keq, dhe kështu... por ky duket të jetë vendi, dhe unë e kam dëshirën për të provuar, a din, të tentoj t'i bëj gjërat më mirë në botën në të cilën jetoj. Dhe ky është vendi ku jam tani, dhe po mundohem të jap kontributin tim sado të vogël... po mendoj, është mjaft i vogël (kullet)...

Erëmirë Krasniqi: Si është puna me studentë këtu? Diçka e veçantë rreth punës me ta? A është shumë më ndryshe se në Shtetet e Bashkuara?

Mark Baskin: Po. Dikur thoja jo, por është ndryshe. Po mendoj, duke filluar nga, sepse ne ligjerojmë në gjuhën angleze, dhe njerëzit këtu janë të varfër, dhe unë fëmijëve të mi u jap qindra dollarë për semester për të blerë libra. Po mendoj, ti mundësh të shpenzosh 200 dollarë në libra për një lëndë në Shtete të Bashkuara. Andaj, mund të shpenzosh 700-800 dollarë për një lëndë. Këtë nuk mund ta bëjmë këtu. Dhe kështu, natyrisht, nuk është trend... nuk kam ligjeruar në Shtete të Bashkuara tash e shumë vite... por njerëzit nuk lexojnë shumë. Andaj, t'i bësh studentët... dhe, në fund të ditës, është me rëndësi të lexosh. Po mendoj, ka mënyra të ndryshme për të marrur informacion, dhe leximi është një mënyrë efektive e mësimit. Andaj kjo është një sfidë e vështirë.

Dhe unë i kam disa studentë të cilët janë të mirë, janë ndër studentët më të mirë të cilëve u kam ligjeruar që nga vitet 1980. Është e vërtetë. Nuk po e them vetëm ashtu. Por më pas u ligjeroj studentëve të magistraturës të cilët nuk janë ndër më të mirët që u kam ligjeruar. Kështu që e ke edhe këtë anë. Dhe... por, mbi të gjitha, po mendoj... më pas i vëren gjërat, vërej gjëra këtu që, siç po duket në Shtetet e Bashkuara e kemi njëjtë sikur në UAK, e sheh që ke miq. Ka grupe të djemve që i marrim të njëjtat lëndë së bashku apo grup vajzash që i marrim të njëjtat lëndë së bashku dhe gjëra të tilla. A din, dhe më pas është ky... dimension i shoqëror, që një antropolog i mirë, një etnograf me të vërtetë do të mund ta analizonte më mirë. Dhe kështu... po.

Erëmirë Krasniqi: Si do ta pëshkruanit ndoshta... jo prapavënë sepse nuk është diçka që mund t'i biem shkurt. Por çfarë kuptimi do t'i jipnit viteve 2000 deri 2020 tash? A ka kuptim ku jeni tani, nga pikëpamja juaj? Në këtë kohë në të cilën jetojmë, dhe ku jeni tani...

Mark Baskin: Pra, në vitin 2000, kur erdha këtu kisha shpresë. Gjithësecili, përveç... po, secili kishte shpresë. Atëherë nuk punoja me komunitetin serb, por ata nuk kishin shpresë do të thoja në vitin 2000. Por me të gjithë tjerët që unë kisha punë kishin shpresë dhe besonin që gjërat do të bëheshin shumë më mirë. Dhe tani, nuk do të thoja që secili ka shpresë, por ende ka të tillë... ka të tillë që kanë shpresë. Sasia e shpresës ka rënë dhe njerëzit janë më të lodhur.

Dhe do ta thoja këtë, dhe do ta thoja për shkak se, do të ishte gabim të presim që Kosova të jetë e zhvilluar në nivelin maksimal të potencialit të saj, sepse asnjë vend nuk ia arrin dot. Shiko evolucionin e shoqërive evropiane, apo Amerika, apo Shtetet e Bashkuara, u ka marrë kohë me qindra vjet për t'u bërë vend demokratik. Dhe nuk ishte pse ne nuk kuptuam çfarë duhet bërë, por është çështje që me gjenerata... merr kohë, ndonjëherë një gjeneratë të tërë që njerëzit të ndryshojnë mënyrat se si i bëjnë gjërat, dhe ka të bëjë me ndryshimin e kulturës. Dhe kjo merr kohë. Andaj nuk shoh arsye pse duhet pritur nga secili që të jetë më i mirë se vetja jonë (kullet), dhe kjo është çfarë po presim nga ju kur e themi këtë.

Dhe kur shikoj... a din, dhe unë njoh shumë njerëz këtu, dhe njerëzit që janë në të gjitha partitë politike dhe në qeveri të ndryshme dhe ngjashëm, dhe disa njerëz ndjehen që janë më të mirë se tjerët, që ata janë kriminel dhe ne nuk jemi. Dhe mendoj që kjo... kur i shikoj Shtetet e Bashkuara, dhe shikoj çfarë lloj legjislacioni ka kaluar në vitin 1780-90. Dhe shikon skandalet e ndryshme financiare në Shtetet e Bashkuara përgjatë historisë sonë, më pas shikon se si Rockefeller Brothers, çfarë organizate e mirë. Si i kanë bërë Rockefeller paratë e tyre? Ata njiheshin si *robber barons*⁷⁰. Pse do të duhej ne të presim nga njerëzit të jenë... të i shmangën gabimeve që të tjerët i kanë bërë? Andaj për mua, unë... kështu që, në një kuptim më të gjërë të fjalës, unë mbetem jashtëzakonisht optimist.

Dhe unë mendoj që në çdo moment ne duhet të veprojmë. Dhe këtu ka tradita të cilat jomedomos janë të favorshme për zhvillimin e demokracisë liberale në stilin Britanezo-Amerikan. Po mendoj, kjo pjesë e Perandorisë Osmane, a din, e tjerë. Kur e shikon... jam kthyer dhe kam lexuar historinë e mesjetës kur fillova të ligjeroj lëndën në Studime Ballkanike. Dhe më pas shfletoj Bizantët, shikon njësitë administrative që të shpiejnë nga periudha Bizantine e deri tek ajo e sotmja, dhe e sheh që shumë pak ka ndryshuar. Ua ke ndryshuar emrat, por, a din, i kishin ata këto gjëra, a din, vilajetet kanë evoluar nga një formë bizantine e organizimit shoqëror. Pse gjërat do të duhej të ishin shumë më ndryshe tani?

Kështu që, deri në një masë unë besoj që demokracia, demokracia liberale, nëse funksionon është një sistem shumë i mirë, sepse ua mundëson individëve të ngriten dhe bien, dhe ne kemi... por, a din, kur i shohim sfidat që i ka vendi im tani, është e vështirë t'i mirëmbash këto organizata, a din, këto institucione, dhe ato mënyra. Andaj, gjersa i shikoj rezultatet, është e lehtë... ka një lojë e fajësimit që po ndodh, që njerëzit këtu fajësojnë BE-në, dhe OKB-në për të gjitha gjërat e tmerrshme. Por OKB-ja dhe BE-ja kanë pasur një sukses të jashtëzakonshëm. Dhe është e lehtë të bëhet me gisht ka gjërat që kanë shkuar keq. Është e lehtë të bëjmë me gisht ka raportet të cilat i krijuam por të cilat kanë mundur të mos ishin fare. Por, siç e dini, e mira nuk është medomos e mirë. Robespierre⁷¹, ai vepronte duke u nisur nga e mira, andaj është me rëndësi, nuk dëshirojmë të vrasim gjithësecilin (qesh).

Por mendoj se gjërat këtu janë okej. Mendoj, në planin afatgjatë, mendoj se gjërat, dua të them, mendoj se, dhe shumë nga ajo se çfarë do të ndodhë këtu do të varet nga forca që janë krejtësisht jashtë kontrollit të njerëzve këtu: Eurozona, çfarë raporte do të keni me Kinën, Rusinë, SHBA-në, gjithë ato gjëra të caktuara që janë më të gjëra dhe që kërkojnë një kontekst të caktuar, dhe mendoj se...

⁷⁰ Eng. baronë hajdutë, term nënçmues për biznesmenët amerikanë të shekullit XIX-të të cilët akuzoheshin për përdorimin e metodave të pamoralshme dhe të padrejta për të siguruar, apo shtuar, pasurinë e tyre.

⁷¹ Maximilien Robespierre, një avokat Francez dhe politikan i respektuar i cili ishte më së shumti i njohur për rolin e tij gjatë Sundimit të Terrorit [*Reign of Terror*] të Revolucionit Francez, gjatë të cilit ai mbikqyrte arrestimet dhe ekzekutimet e kundërshtarëve të shumtë politikë.

shpresoj se... që do të vazhdojë të ecë përpara dhe se qeveria e re do të bëjë disa... do të ketë njëfarë suksesi...

[Video intervista është prerë këtu]

Po, pra çfarë ndodhi ishte, ne jemi atje diku nga fundi i verës së vitit '99, një burrë që ka punuar me Komitetin e Përbashkët të Shpërndarjes Hebraike Amerikane... oh, kam harruar emrin e tij tani. Dreçin. Më kujtohet dhe ju tregoj... ai erdhi në Prizren, dhe ata donin të festonin, ata donin ta kenë një darkë *Rosh Hashanah*. Dhe ai e ka ditur disi se une isha Hebre, dhe ai e ka njohur [Votim Demirin](#) i cili tani është presidenti i komunitetit hebre në Kosovë. Dhe, a din, personaliteti i shquar i Votimit në Prizren edhe më parë.

Dhe... Eli Eliezri ishte emri i tij. Ai ishte një Izraelit, Eli Eliezri. Dhe pra Eli tha, "Eja pra". Ai ishte një nga ata lloj Izraelitësh vërtetë optimistë, a din, përplot energji. Dhe në e patëm një darkë ku ne kishim Votimin dhe mendoj që edhe familjen e Votimit dhe disa të tjerë. Dhe doli se kishte dy-tre familje më të mëdha hebreje në Prizren. Dhe kishte disa që kishin bërë *aliyah*⁷² ne vitet '47-'48 nga Prizreni, kështu që kishte një lloj *kibbutz*⁷³ apo diçka. Atje ishin hebrenjtë boshnjakë në Izrael dhe mendoj që kishte disa hebrenjë kosovarë gjithashtu. Dhe unë i njoh disa hebrenjë kroatë përmes një miku që më tregoi, një mik shumë i mirë. Pra...

Dhe pastaj ne patëm një darkë, dhe për mua ishte krejtishtë e çuditshme. Dhe papritmas, ai thërret, Eli thërret një burrë që kishte qenë një Ministër i Arsimit i Izraelit i cili ishte përfshirë në diçka, mendoj se një proces i Konventës së Gjenevës apo diçka e tillë. Dhe ai thotë, "Kështu, duhet të flasësh me të!" Dhe ne po flasim, po flasim për Kosovën dhe gjitha këto. Dhe pra, dhe pastaj Eli po më tregonte që ai mendoi se ishte e rëndësishme që ata donin të ishin aty, dhe ata donin të ishin aty pjesërisht për të treguar, a din... sepse ishte një komunitet i hebrenjëve... dhe se ata donin t'i jipnin përkrahje. Por ata gjithshashtu donin të punonin... një nga shumë gjërat që bëri Komiteti Amerikan i Shpërndarjes Hebreje, diçka... ata janë kudo... është se ata po vendosnin kompjuterë në shkolla.

Dhe pastaj ai më tregoi se ata po ndihmonin me rindërtimin e një xhamie, ose ata deshën të bënin këtë. Dhe idea ishte se ne donin të krijojmë një lloj gjëje multietnike, a din, atë lloj gjëje që ne donim... dhe pra... dhe ai e bëri për arsye të qarta politike. Ishte idea se në vende të tilla një pakicë ishte e mbrojtur. Dhe ajo ishte disi e mirë. Dhe pastaj për Passover vitin e ardhshëm. A keni qenë ndonjëherë në një Passover Seder [i drejtohet Erëmirës]?

Erëmirë Krasniqi: Mendoj që po.

Mark Baskin: Kjo është e mrekullueshme sepse në vitin vijues ata gjithnjë përfundojnë në Jerusalem. Dhe Passover Seder, e cila tregon historinë e hebrenjëve, a din, ikja nga Egjipti. Andaj, për Passover kemi një festë më të madhe. Dhe prapë, të gjithë miqtë tanë, a din, të gjithë njerëzit me të cilët isha miq i ftonim, dhe Eli gjithnjë i ftonte të gjithë *expatët* hebrej që të vijnë në këto festa (kullet). Dhe kështu këtë e organizuam edhe në një restaurant në Prizren. Dhe ai kishte edhe disa shqiptaro-hebrej, një grua hebreje nga Shqipëria e cila ishte zhvendosur në Izrael, dhe kështu që së bashku organizuam një Seder. Dhe më pas ajo tregoi se si ishte të jesh hebreje në Shqipëri, e tjera, e tjera. Dhe kështu që

⁷² Gjuhë hebraike: *aliyah*, ngjitja ose ngritja, imigrimi i hebrenjve në Izrael.

⁷³ Gjuhë hebraike: *kibbutz*, tubim, një vendbanim kolektiv komunitar, i organizuar zakonisht rreth bujqësisë.

këtë e bëmë në fund. Dhe e di që Eli shumë... po ashtu edhe Votimi e kuptoi këtë, në fund, që kjo do të ishte mënyra e tij, dhe e vazhës së tij, siç e din ajo punon në Konzullin e Kosovës në New York, dhe tani është mjaft aktive. Pra, para një viti a më shumë, isha në "Liburnia" dhe Ines erdhi së bashku me Teuta Sahatqijinë dhe hebrejnë tjerë nga New York dhe Izraeli, dhe kështu që arritëm të rilidheshim (qesh). Dhe...

Dhe e di që duan të ndërtojnë një qendër të hebrejnëve në Prizren. Dhe, në një mënyrë, mendoj që... kanë mbetur shumë pak hebrejnë në Kosovë. Dhe mendoj që e kam përmendur këtë herën e kaluar, unë shkoj në lexime të Toras kur jam në Shtete të Bashkuara. Dhe mendoja që... kur shkoj në... e kisha përfunduar këtë ceremoni [Dita Ndërkombëtare Përkujtimore e Holokaustit e mbajtur në Prizren më 27 janar, 2020] dhe doja të propozoja, "Duhet të kemi lexime të Toras". A din, është një angazhim i vërtetë intelektual. Dhe... por nuk mendoj që ka shumë interesim për këtë.

Krijimi i një qendre të komunitetit hebraik këtu është që do të përkujtonte një komunitet që ka ekzistuar dikur këtu, dhe do të demonstronte që Kosova është shtëpi e të gjitha komuniteteve. Dhe më pas i kemi varrezat, e din, këtu në Taukbaççe apo aty dikun afër. Dhe... mendoj që qendra e komunitetit të hebrejnëve mund të jetë një vend ku mund të ketë... a din, mund të jetë një tempull i tolerancës. Por, kush e di se çfarë do të ndodhë me të vërtetë.

E di që në vendet si Zagrebi... dikur shkoja t'i përcjellja këto të Rosh Hashanah dhe tjerat në Zagreb. Dhe komuniteti hebraik i Zagrebit dhe komuniteti hebraik i Beogradit janë ndarë (kullet). A din, është ajo thënja, "I ke dy hebrej, tre parti politike" (kulllet), a din, andaj tash... Por unë mendoj që... mendoj që do të ishte... është ide e mirë, dhe kjo të jetë në Prizren dhe jo në Prishtinë është ide e mirë sepse i sjellë njerëzit aty. Dhe përkon me identitetin e Prizrenit, si një vend i shënjuar nga komunitete të shumta etnike dhe e gjithë ajo, andaj mendoj që kjo...

Erëmirë Krasniqi: A ke detaje më të hollësishme se si arritën ta kultivojnë këtë identitet hebraik? Si ranë në kontakt me këtë trashëgimi?

Mark Baskin: Mendoj që ka pasur financim nga një organizatë ndërkombëtare hebraike për të pasur... e di që kur isha në Shtete të Bashkuara, dhe nuk mund të udhëtoja, ata patën një ngjarje të madhe dhe më ftuan por kurrë nuk shkova. Ishte një konferencë tre-ditore. Dhe tani janë duke e riorganizuar. Sepse, siç e din, të jesh hebre është çështje matriliniale. Dhe unë njoh shumë njerëz që janë aktivë në komunitetin hebraik të Zagrebit, etërit e të cilëve ishin hebrejnë dhe nënat nuk i kishin, por megjithatë ishin aktivë. Dhe rabini ortodoks në Izrael nuk i njihte, por ne... mbiemri i tyre Sternberg tregonte që ata ishin hebrejnë dhe e tërë ajo. Dhe kështu, nuk e di.

Nëse do të bëhej një komunitet vital, mendoj që do të nevojitej të bëhej pak... a din, në Sarajevë, ne shkonim në predikime religjioze ku me të vërtetë kishte Rosh Hashanah, kishte edhe Seder, dhe bëhej ceremonia siç duhej, a din, të paktën rituali realizohej. A din që ka mënyra të shumta se si një ritual realizohet për secilën nga këto ceremoni, dhe duhet të bëhen në mënyrë të duhur. Në fakt, unë do të vazhdojë të mbes në kontakt me Votimin. Ka të bëjë... sepse Passover do të jetë edhe një muaj, andaj do shohim. Do të bëjmë Seder së bashku (qesh).

Erëmirë Krasniqi: Mark, po mendoj që mundemi këtu me përmbyllë.

Mark Baskin: Faleminderit që erdhët.

Erëmirë Krasniqi: Faleminderit ty, faleminderit për kohën.

Mark Baskin: Po, ishte kënaqësi, ishte mirë që arritëm të kontaktojmë sërish.